



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në

“Inxhinieri e Burimeve Minerare”

ofruar nga

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Assoc. Mirjam Ndini Bogdani

Dr. Gazmend ZENELI

Shkurt / 2025

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bachelor në "Inxhinieri e Burimeve Minerare"**

1	IAL aplikues:	Universiteti Politeknik i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Inxhinierisë së Burimeve Minerare
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në "Inxhinieri e Burimeve Minerare"
4	Urdhëri/VKM i liçensimit:	Shkresë MASR Nr.6883/1, datë 31.08.2018.
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Shkresë e MAS me Nr. Prot. 6883/2, datë 21.09.2018
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër i QSHA-së Nr. 153, datë 16.04.2021
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditim për herë të parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	12 PAE / 2 PAK
18	Numri i studentëve:	2021-2022 12 studentë 2022-2023 13 studentë 2023-2024 5 studentë
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Tradita e UPT-së fillon në vitin 1951, me ngritjen e Institutit të Lartë Politeknik në Tiranë, i cili përmbante disa degë inxhinierike. Në vitin 1957, me Dekret të Presidiumit të Kuvendit Popullor të Republikës Popullore të Shqipërisë, Nr. 2476, dt. 03.06.1957, "Mbi krijimin e Universitetit Shtetëror të Tiranës", nga bashkimi i gjashtë instituteve formohet Universiteti Shtetëror i Tiranës. Ky universitet kishte në përbërjen e tij Fakultetin e Inxhinierisë i përbërë ndër të tjerë dhe nga Dega e Gjeologjisë, në të cilën diplomoheshin inxhinierë të përgjithshëm, në fushën përkatëse. Pranë universitetit u themelua edhe Biblioteka Shkencore. Inaugurimi i Universitetit Shtetëror u bë në 16 Shtator 1957.

Universiteti Politeknik i Tiranës, i krijuar me VKM Nr. 215, dt. 15.07.1991.

Programi aktual i studimit Bachelor në "Inxhinieri e Burimeve Minerare" është fryt i bashkëpunimit dhe menaxhimit midis katër departamenteve të FGJM: DBE, DSHT, DGJZGJ dhe DIBM. Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri e Burimeve Minerare" ofrohet si i tillë që prej Tetorit 2005 si rezultat i reformës që pësoi arsimit i lartë në Shqipëri duke implementuar sistemin e Bolonjës, me emërtimin dhe statusin aktual me shkresë të MAS me Nr. Prot. 6883/2, datë 21.09.2018, pasi ka kaluar të gjitha fazat e propozimeve dhe miratimit brenda Universitetit.

Në versionin aktual të tij, ky program studimi është riorganizuar në përputhje të plotë me VKM. Nr. 41, datë 24.1.2018" Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", të ndryshuar.

Programi i studimit është hartuar dhe përditësohet në vazhdimësi, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe nevojat e tregut rajonal për specialistë në fushën e Inxhinierisë së Burimeve Minerare.

Programi i studimit synon të formojë inxhinierin me njohuri e aftësi profesionale në:

Shfrytëzimin e vëndburimeve të mineraleve të dobishme; Menaxhim burimesh, nxjerrja dhe përpunimi i materialeve të ndërtimit, matje gjeomatike në objekte minerare dhe gjeologjike, përpunimi i lëndëve të para, trajtimi i depozitimeve sterile mbi dhe nëntokë, mbrojtja e rrjetit hidrografik natyror dhe të ndërtuar nga ndikimet minerare në sipërfaqe dhe nëntokë, rigjenerimi i objekteve të infrastrukturës, etj.

Ky program realizohet me 180 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike (6 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet Diplomë Bachelor në "Inxhinieri e Burimeve Minerare" nga Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave, të Universitetit Politeknik të Tiranës, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri e Burimeve Minerare” ofrohet nga Fakulteti Gjeologjisë dhe Minierave, Universiteti Politeknik i Tiranës, përkatësisht Departamenti i Inxhinierisë së Burimeve Minerare.

Grupi i Ekspertëve të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) përbëhet nga dy anëtarë: Prof. Asoc. Dr. Miriam Ndini (Bogdani) dhe Dr. Gazmend Zeneli, me mbështetjen e Koordinatorit Teknik të ASCAL, MSc. Abri Ndreka.

Procesi i akreditimit ka filluar me Kërkesën e Rektorit të UPT-së drejtuar me shkresë Nr. 968/9 Prot., datë 16.05.2023 drejtuar ASCAL-it e cila nga ana e saj ka konfirmuar aplikimin me shkresë Nr. 38/4., datë 04.03.2024 dhe duke përcjellë Agjendën e veprimtarive që parashikonte fillimin e Vlerësimit të Brendshëm në datën 20.03.2024.

Vlerësimi i jashtëm ka filluar në muajin Maj 2024, mbas dorëzimit nga ana e Universitetit Politeknik të Tiranës të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB), si dhe dosjes së vetëvlerësimit (DVV) me dokumentacionin mbështetës.

Ekspertët u njohën me RVB dhe DVV nëpërmjet sistemit të menaxhimit elektronik AMS të ASCAL.

Mbi bazën e agjendës së sipërcituar, të përcaktuar nga ASCAL, në bashkëpunim me UPT, në datat 26 dhe 28 Qershor 2024, GVJ vizitoi institucionin dhe realizoi një sërë takimesh dhe intervistash me Dekanin e Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave, Përgjegjësin e Departamentit të Inxhinierisë së Burimeve Minerare, me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, me stafin akademik të angazhuar në programin e studimit, me përfaqësues të Drejtorisë së Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë, me përfaqësues të Sektorit të Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit, të Sektorit të Burimeve Njerëzore, të Sektorit të Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve dhe me studentët e programit të studimit. Gjithashtu, GVJ, zhvilloi vizita në Sekretarinë Mësimore, në Bibliotekë, si dhe u njoh me mjediset e zhvillimit të procesit mësimor.

Raporti i përgatitur përmbledh rezultatet e shqyrtimit të dokumentacionit të DVV, si dhe të informacionit të mbledhur gjatë vizitës në Institucion.

Më datë 20.01.2025, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr.30/1 Prot., datë 20.01.2025 dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes sistemit AMS, më datë 31.01.2025 dhe me shkresë zyrtare Nr.221/2 Prot., datë 31.01.2025, ka dërguar komente mbi draft raportin.

GVJ, pasi u njoh me komentet e Universitetit Politeknik të Tiranës, për secilin prej standardeve, sqaron si më poshtë:

- **Komentet për Standardin I.1 & IV.2-3** në lidhje me “Laboratorët, Pajisjet laboratorike & Rikonstruksionin e papërfunduar”, GVJ konstaton faktin se, (citoj): “*Laboratorët si Infrastrukturë e departamentit mbështesin zhvillimin e programit. Për arsye rikonstruktimi të godinës, vizita në këto ambiente nuk ishte e mundur të kryhej plotësisht. Për pjesën e*

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

laboratorëve u prezantuar vetëm me disa pajisje të grumbullura në një dhomë. Siç e theksuam ky është një konstatim i vizitës sonë që na ishte ngarkuar ta kryenim dhe që nga ana jonë duhej të pasqyrohej realiteti.

Komenti merret parasysh por RVJ nuk ndryshon.

- **Komentet per Standardin II.1&III-1: Praktikë profesionale**

Në planin mësimor të programit të studimit BA në "Inxhinieri e Burimeve Minerare", Praktika Profesionale figuron e integruar në formën e praktikës lëndore/mësimore në modulet përkatëse, ndërsa gjatë bashkëbisedimit me stafin na u tha se praktika mësimore kryhet më vete si një sasi ditësh të grumbulluara në fund të vitit.

Komenti merret parasysh por RVJ nuk ndryshon.

- **Komentet për Standardin II.4: Literatura bazë**

Kjo ishte një pike shumë e dobët e pothuajse të gjitha syllabuseve, Literaturë e vjetër, mungesë e literaturës bashkokohore, mungesë e literaturës dhe e zëvendësuar vetëm me shënime të lektorëve që u shpërndahen studentëve, etj. Këmbëngulim në faktin që kjo pjesë në syllabuset duhet të jetë në vëmendje imediate nga lektorët në veçanti dhe nga Departamenti. Ky fakt është pranuar dhe zotohen që ta përmirësojnë në të ardhmen e afërt.

Komenti merret parasysh por RVJ nuk ndryshon.

- **Komentet për Standardin II.5 & III-1-2-3 & V-4: Pjesëmarrja në vlerësimin e programit**

Në përgjigjen e tij, GVB, pranon vërejtjen e GVJ mbi përfshirjen dhe kontributin e studentëve në përmirësimin e programit dhe të mësimdhënies dhe angazhohet të përmirësojë këtë bashkëpunim duke propozuar forma dhe metoda për tërheqjen e mendimit të studentëve.

Komenti merret parasysh por RVJ nuk ndryshon.

- **Komentet për Standardin III-5: Kriteret e Mbrojtjes Së punimit të Diplomimit**

GVJ nuk ka bërë asnjë koment/vërejtje në lidhje me këtë çështje në këtë standard (?)

- **Komentet për Standardin IV.I: Mbingarkesa e stafit akademik**

Edhe për këtë pikë Departamenti angazhohet të punojë për të rekrutuar staf të ri në mbështetje të realizimit të planit mësimor.

Komenti merret parasysh por RVJ nuk ndryshon.

- **Komentet për Standardi V.4 - Sekretaria mësimore**

GVJ në konkluzionet e tij për Standardin V.4 vëren se është raporti që nuk pasqyron të dhëna të plota, jo sekretaria mësimore: *“të tregohet më kujdes në të dhënat që paraqiten në raportimet e Departamentit të Inxhinierisë së Burimeve Minerare, pasi të dhënat janë të paplota”*.

Komenti merret parasysh por RVJ nuk ndryshon.

- **Komentet për Standardi V.6 - Zyra e karrierës**

GVJ në vizitën e tij dhe në diskutimet me stafin përkatës, konstatoi se Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave ka filluar punën për gjurmimin e studentëve të tij të diplomuar dhe ka në proces hartimin e një baze të dhënash me të diplomuarit në programet e studimit që ofron FGJM. Në përgjigjet e GVB na konfirmohet se zyra e karrierës do të punojë për ngritjen e shoqatës Alumnae të Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave.

Komenti merret parasysh por RVJ nuk ndryshon.

Si konkluzion, GVJ gjen një reagim pozitiv dhe konstruktiv në përgjigjet e dhëna nga GVB për programin Bachelor në "Inxhinieri e Burimeve Minerare".

Sugjerimet/rekomandimet tona janë pranuar dhe mbi to janë bërë reflektime konstruktive për të përmirësuar cilësinë akademike të programit.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Inxhinieri e Burimeve Minerare”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	UPT ofron programe studimi në fushat inxhinierike në të tre ciklet e studimit në përputhje me Kornizën Shqiptare të Kualifikimit. Politikat dhe programet e ofruara nga Universiteti Politeknik i Tiranës, janë hartuar në përputhje me politikat kombëtare të përcaktuara në Strategjinë e Arsimit të Lartë të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe njëherësh mbështesin vlerat kulturore të vendit dhe interesat prioritarë strategjike të zhvillimit. UPT, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave ndër programet e tjera ofron edhe programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri e Burimeve Minerare” i cilësuar nga qeveria si program prioritar. Misioni i Universitetit Politeknik është: <i>Të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë dijet me anën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve, si edhe të formojë specialistë të lartë dhe të përgatitë shkencëtarë të rinj;</i> b) <i>të ofrojë mundësi për të përfutur nga arsimi i lartë gjatë gjithë jetës në fushat e tij të ekspertizës;</i> c) <i>të ndihmojë zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar dhe rajonal;</i> ç) <i>të kontribuojë në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e të rinjve për një shoqëri të tillë.</i> Veprimtaria akademike e UPT zhvillohet në përputhje me parimet dhe standardet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë (HEAL), duke reflektuar parimet dhe objektivat e Procesit të Bolonjës. Nga vizita në institucion dhe dokumentacioni mbështetës (<i>Rregullorja e programit</i>) dhe (<i>Statuti i Universitetit Politeknik</i>), u konstatua se Programi Bachelor në “Inxhinieri e Burimeve Minerare”, është hartuar në përputhje me Statusin e Universitetit Politeknik, <i>neni 3</i>, misionin dhe qëllimet e institucionit.



	Bazuar në Misionin dhe Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit Politeknik hartimi i programit të studimit Bachelor në Inxhinieri e Burimeve Minerare, është realizuar sipas nevojave të tregut. Departamenti i Inxhinierisë së Burimeve Minerare mban komunikim të ngushtë me kompanitë që operojnë në treg, në këtë fushë, përmes një konsultimi të vazhdueshëm me to në lidhje me nevojat e tyre, mundësitë e reja dhe bashkëpunimin me to. Institucioni ka krijuar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe të saj jashtë vendit si dhe me kompani vendase ose të huaja në të mirë të programit të studimit. Studimi i tregut dhe kuptimi i nevojave aktuale, janë përcaktues të kërkesave për prurje profesionale të fushave të Inxhinierisë së Burimeve Minerare, ndërsa IAL ofron kuadër profesional të fushave përkatëse të cilët mund t'i shërbejnë kërkesave të tregut të punës. Departamenti dhe Dekani i Fakultetit GJM, krijojnë marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbështetjen e praktikës së studentëve. <i>Referenca:</i> <i>Ref 001: Statuti I UPT</i> <i>Ref 002 Plani strategjik I UPT</i> <i>Ref 010 Rregullore e PS BSc ne Inxhinieri e Burimeve Minerare</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e Institutionit. Programi është pjesë integrale e strategjisë së zhvillimit të Universitetit, është hartuar dhe përditësohet vazhdimisht në bazë të nevojave të tregut të punës dhe zhvillimit ekonomik të vendit. Ndër të tjera misioni i UPT është të ndihmoj zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar dhe rajonal. Programi i studimit është i mbështetur në një eksperiencë dhe traditë 60 vjeçare të këtij Institucioni në fushën e Industrisë së shfrytëzimit dhe nxjerrjes dhe përpunimit të lëndëve të para Minerare në vendin tonë. Në objektivat del qartë se ku dhe në cilat procese mund të punojë specialisti në "Inxhinieri e Burimeve Minerare" <i>Referenca:</i> <i>Ref 001 Statuti I UPT.</i> <i>Ref 010 Rregullores e PS BSc ne Inxhinieri e Burimeve Minerare</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe	Programet e studimit në UPT mbështeten në zbatimin e strategjisë zhvillimore, Statuti dhe Rregullores së Universitetit Politeknik.

në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri e Burimeve Minerare" është zbatim i Planit strategjik të FGJM 2018-2023, Statutit të UPT -2018, Rregullores së brendshme të departamentit të Burimeve Minerare në FGJM- 2020. Hartimi i programit të studimit nga Institucioni, mbështetet në nevojat e tregut, në përvojën e vete institucionit si dhe në përvojat e universiteteve homologe në Europe e me gjerë. Bazuar në mendimin e Dekanit dhe Shefes së Departamentit, ky program është menduar të jetë në harmoni me nevojat e tregut të punës të cilat përgjatë dhjetëvjeçarit të fundit kanë evoluuar, sikurse edhe me ndryshimet më të fundit teknologjike, duke synuar që t'u mundësohet specialistëve të rinj bërja lehtësisht pjesë e këtij tregu. Programi i studimit përveç paisjes të studentëve me njohuritë e nevojshme shkencore teorike që lidhen me fushën e tyre të studimit, formon edhe shprehinë e nevojshme tekniko-praktike, duke i aftësuar të përballen e zgjidhin problematika të ndryshme inxhinierike, në funksion të plotë të zhvillimit ekonomik lokal dhe kombëtar. <i>Referenca:</i> <i>Ref 001 Statuti i UPT</i> <i>Ref 008 Rregullore e brendshme e departamentit ne FGJM</i> <i>Ref 007 Plani Strategjik i FGJM 2018-2023</i>
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Institucionit, nëpërmjet Statutit të tij, rregulloreve të programit të studimit, demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura akademike dhe infrastrukturore për ofrimin e këtij programi studimi. Njësia kryesore, FGJM së bashku me njësinë bazë, Departamentin e Inxhinierisë së Burimeve Minerare, mban përgjegjësinë për përmbushjen e detyrimeve ligjore për strukturën akademike dhe organizimin e programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri e Burimeve Minerare". Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri e Burimeve Minerare" ofrohet nga Departamenti i Inxhinierisë së Burimeve Minerare, si pjesë e njësive kryesore të Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minerave (FGJM). Fakulteti Gjeologji Miniera ka gjithashtu në përbërjen e tij Departamentin e Shkencave të Tokës, Departamentin e Gjeologjisë së Zbatuar dhe Gjeoinformatikës, Departamentin e Burimeve të Energjisë, duke demonstruar kapacitete të nevojshme për ofrimin e programit.

	Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit ka përvojën dhe kualifikimin e duhur për ofrimin e tij. GVJ për këtë kriter është referuar tabelës 2 te aneks tabelat për vitin 2023-2024. Stafi akademik i departamentit që mbështet këtë program studimi, është 13 PAE dhe 6 PAK, me këtë raport: Profesor: 3/1 Prof.Asoc. Dr: 2/1 Dr.: 7/3 Msc: 1/1 Gjithashtu departamenti mbështetet edhe nga 3 personel ndihmes akademik. Gjithashtu IAL ofron edhe burimet e infrastrukturës në shërbim të programit të studimit. Burimet e infrastrukturës përfshijnë ambiente për studentë (Auditori/Klasë për leksione dhe seminare, Laborator për praktikë dhe orët laboratorike, Laboratorë Informatikë, Bibliotekë, Ambiente për fotokopje/librari, Zyra e Informimit të Studentëve, Zona Sociale dhe Sportive); Ambientet për personelin (Zyrat, Sallat e Takimeve, Ambientet për personelin e shërbimit, Ambientet e rekreacionit). Pjesë integrale e infrastrukturës është gjithashtu shërbimi ICTC ku IAL ofron një sërë programesh. Laboratorët si Infrastrukturë e departamentit mbështesin zhvillimin e programit. Për arsye rikonstruktimi të godinës, vizita në këto ambiente nuk ishte e mundur të kryhej plotësisht. Për pjesën e laboratorëve u prezantuam vetëm me disa paisje të grumbullura në një dhomë. Në raport, sipas references 054 info mbi laboratorët, nuk paraqiten foto të të gjithë laboratorëve si psh Mekanikës së Shkëmbit dhe ndërtimit të punimeve. <i>GVJ është i mendimit se vlerësimi i këtij kriteri duhej të pasurohej edhe me infrastruktura të tjera mbështetëse si biblioteka, etj.</i> <i>Referimet:</i> Ref 001 statuti I UPT Ref 010 Rregullore e PS BSc ne Inxhinieri e Burimeve Minerare. Ref 054 Informacion Lab DIBM Ref 081 Model Programi mesimor BSc Inxhinieri e Burimeve Minerare.
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe	Programi i studimit ofrohet nga njëسيا bazë, Departamenti me të njëjtin emërim "Inxhinieri e Burimeve Minerare" që është

specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	pjesë e Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave dhe është formuluar dhe miratuar në përputhje me misionin gjithëpërfshirës të UPT. Programi është i organizuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për përmbushjen e misionit të tij. Fakulteti është njësia kryesore akademike e UPT, për të koordinuar mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor në fushat përkatëse të kërkimit mësimor. Departamenti si njësia bazë ka kryer procesin e Kodifikimeve sipas fushës së gjerë dhe specifike të klasifikuar në VKM Nr. 310, date 11.05.2022 dhe Urdhër të MAS Nr. 31 datë 15.11.2022.
Konkluzione	<i>IAL është organizuar në përputhje të plotë me aktet ligjore dhe nënligjore me qëllim përmbushjen e misionit të tij.</i> <i>Institucioni ofron program studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij. Gjatë vizitës por dhe shqyrtimit të dokumentacionit u konstatua se Programi në Bachelor "Inxhinieri e Burimeve Minerare", përputhet plotësisht me misionin dhe objektivat e Institucionit.</i> <i>GVJ konfirmon se Universiteti Politeknik, Departamenti i Inxhinierisë së Burimeve Minerare, ka një strategji të zhvillimit për periudhën 2018-2024, e hartuar me profesionalizëm duke përfshirë çdo fushë e cila ka të bëjë me zhvillimin akademik shkencor, mësimdhënies, nxënies, dhe rritjes së cilësisë së produktit.</i> <i>Programi në fjalë është hartuar në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe akteve nënligjore të tij, si dhe me Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit Politeknik të Tiranës.</i> <i>Standardi për numrin e personelit akademik të rregullt plotësohet dhe është i rregulluar me kontrata të rregullta pune duke respektuar të gjitha ligjet dhe normat ligjore në vend.</i> <i>Gjatë vizitës në institucion është vërejtur përkushtimi maksimal i stafit Akademik të rregullt për përmbushjen e misionit dhe objektivave për këtë program studimi "Inxhinieri e Burimeve Minerare".</i> <i>Në raport ka gabime duke ju referuar programit jo me emërtimin e tij Bachelor në Inxhinieri Minerare por si Gjeoinformatike.</i> <i>Ka mospërputhje të tabelave në raport me tabelat e ofruara në anekse.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Departamenti është njësi bazë që ofron programin e studimit dhe Fakulteti si njësi kryesore e UPT, në zbatimin e programit të studimit në Inxhinierinë e Burimeve Minerare, siguron një bashkëpunim si me departamentet brenda këtij fakulteti por edhe me fakultetet e tjera jashtë tij dhe departamente të tjera që nuk varen nga vetë ai. Njësitë bazë e këtij institucioni, ndër to edhe Departamenti i Inxhinierisë së Burime Minerare, organizojnë veprimtari mësimore dhe kërkimore shkencore në koordinim të plotë me njësitë kryesore (fakultetet). Ky bashkëpunim mbështetet edhe në aktet ligjore siç është edhe Rregullore e zhvillimit kurikular dhe mësimdhënies në UPT. Për mbështetjen e këtij programi studimi i cili zhvillohet në tre vite akademike, angazhohen personel akademik nga 5 fakultete të tjera të UPT, Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike (FIMIF), Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike (FIE), Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit (FIN), Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike (FIM) dhe Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit (FTI) dhe 11 departamente; Kështu nga 37 lëndë të këtij programi, 18 lëndë mbulohen nga stafi akademik jashtë FGJM. Ky fakt është tregues i një bashkëpunimi shumë të mirë ndërmjet njësive të UPT. Në rastin konkret GVJ u informua për një sërë aktiviteteve me pjesëmarrje të studentëve e pedagogëve të njësive bazë të fakultetit. Bashkëpunimi është i njehsueshëm në aktivitetet e promovimit të institucionit, në koordinimin e trajnimeve, objektivat për rritjen e cilësisë së botimeve shkencore si dhe në përdorimin e ambienteve të përbashkëta. GVJ konstaton që ky bashkëpunim është i qëndrueshëm dhe efikas. Bashkëpunimi nuk është vetëm në nivel fakulteti por edhe në nivel universiteti. Ky element është i mirë sqaruar edhe në statutin e IAL ku çdo njësi ka detyra dhe objektiva të mirë përcaktuara. <i>Referenca:</i>



	<i>Ref 010 Rregullore e PS BSc ne Inxhinieri te Burimeve Minerare</i> <i>Ref 104 Komunikim me fakultetet e tjera per stafin e angazhuar ne FGJMI.</i> <i>Ref 004 Rregullore e zhvillimit kurikular dhe mesimdhënies ne UPT</i> <i>Ref: 024 CV e stafit akademik</i> <i>Ref 048 Raporti I Analizes Mesimore DIBM.</i> <i>Ref 081 raport mbi anketimin studentor cilesia e mesimdhënies 21-22</i> <i>Ref: 006 Rregullore brendshme FGJM.</i> <i>Ref 047 Praktika e parashikimit te ngarkeses mesimore FGJM.</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Referuar materialeve bashkangjitur në raport, si dhe takimeve me zyrat përkatëse rezultoi se Universiteti Politeknik i Tiranës ka marrëveshje me 34 institucione të huaja në kuadër të ERASMUS+. Gjithashtu UPT-ja ka nënshkruar/firmosur disa marrëveshje bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit, me biznese vendase si dhe me sipërmarrje të ndryshme industriale në funksion të realizimit të objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve. Këto marrëveshje shërbejnë për lehtësimin e kryerjes së praktikave të studentëve, por edhe për të forcuar bashkëpunimin në fushën e ekspertizës dhe kërkimit shkencor të stafit të FGJM. Lidhur me bashkëpunimin e institucionit me institucione homologe, brenda e jashtë vendit, si dhe aktorët e biznesit, vendas e të huaj, në realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, GVJ u informua konkretisht edhe gjatë takimit me përfaqësuesit e zyrës së projekteve, ku mësoi se kjo zyrë ka funksion koordinues për projektet, duke u fokusuar si në projektet e brendshme ashtu edhe në ato të jashtme. <i>Referenca:</i> <i>Ref 049 Marrëveshjet Institucionale UPT.</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike,	Universiteti Politeknik ka marrëveshje bashkëpunimi me rreth 70 kompani të sektorit privat dhe institucione /kompani shtetërore. Studentët përfitojnë nga këto bashkëpunime, të mbështetura në marrëveshje, duke realizuar praktikat e tyre mësimore pranë kompanive të ndryshme, në realizimin e mobiliteteve të tyre drejt universiteteve europiane, si dhe punësimin.

praktikave të punës apo stazhit etj.	Stafi akademik i fakultetit përfiton nga keto marrëveshje duke kryer studime shkencore në bashkëpunim. FGJM realizon kontrata me kompanitë përkatëse për kryerjen e praktikave mësimore nga ana e studentëve. Pedagogu përgjegjës për praktikën mësimore mbikqyr dhe vlerëson aktivitetin e studentit gjatë praktikës profesionale. <i>Referime:</i> <i>Ref 045 Marrëveshjet Instrucionale UPT</i> <i>Ref 047 Marrëveshjet me industrinë dhe institucione</i> <i>Ref 052 Model kontrate për praktiken FGJM</i> <i>Ref 053 Procedura e organizimit të praktikës mësimore FGJM/DIBM</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Në takim me stafin akademik të departamentit u mësua se FGJM dhe departamentet përgjegjëse analizojnë rezultatet e marrëveshjeve të bashkëpunimit me fokus realizimin e programit të studimit. <i>Referime;</i> <i>Ref 048 Raporti i Analizës Mësimore DBM</i> <i>Ref 050 Rendi i dështësive të mbledhjes APA</i>
Konkluzione	<i>Departamenti i Inxhinierisë së Burime Minerare mban komunikimi të ngushtë me kompanitë që operojnë në treg, përmes një konsultimi të vazhdueshëm me to në lidhje me nevojat e tyre, mundësitë e reja dhe bashkëpunimin me to.</i> <i>Institucioni ka krijuar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe të saj jashtë vendit si dhe me kompani vendase ose të huaja në të mirë të programit të studimit.</i> <i>Studimi i tregut dhe kuptimi i nevojave aktuale, janë përcaktues të kërkesave për prurje profesionale të fushave të Inxhinierisë së Burime Minerare, ndërsa IAL ofron kuadër profesional të fushave përkatëse të cilët mund t'i shërbejnë kërkesave të tregut të punës.</i> <i>Departamenti krijon marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbështetjen e praktikës profesionale të studentëve të Inxhinierisë së Burimeve Minerare.</i> <i>Departamenti gjithashtu mbështet marrëdhëniet me kompanitë dhe punëdhënësit me anë të marrëveshjeve të ndërsjella. Kjo bazuar në statutin e institucionit dhe në rregulloren e programit të studimit</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
I				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Nga vizita në IAL dhe nga dokumentat e vënë në dispozicion GVJ konstaton se organizimi i programit vepron mbi bazën e një game të plotë rregullash e procedurash të përcaktuara në rregulloren e studimeve dhe provimeve të programit të ciklit të parë Bachelor. Lloji i studimit të programit Bachelor në Inxhinierinë e Burimeve Minerare është i riformatuar dhe ofrohet me kohë të plotë. Programi përbëhet nga 35 lëndë, të vlerësuara me kredite. Lëndët në përbërjen e tyre përfshijnë edhe praktikën profesionale, e cila nuk është lëndë me vetë. Është respektuar sasia e krediteve 60 ECTS/vit. Lëndët kanë ECTS të ndryshme. Orët për studentin në auditor variojnë nga 26 deri në 28 orë totale në javë. Referenca: Ref 010 Rregullorë e PS BSc në Inxhinieri e Burimeve Minerare; Ref 023: Syllabuset e Lëndëve në PS BSc Inxhinieri e Burimeve Minerare
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të	Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri e Burimeve Minerare" është Niveli 6 në Kornizën shqiptare të Kualifikimeve dhe ai i përmbush të gjitha kriteret e këtij niveli. Bazuar në planin mësimor, si edhe në programet e lëndëve mund të arrihet në përfundimin se programi i studimit në Bachelor Inxhinieri e Burimeve Minerare, jep njohuri të përparura në fushën e inxhinierisë së minierave, Gjeomatikës dhe përpunimit të lëndëve të para Minerare.

kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Qëllimi i programit në paisjen e studentëve me njohuritë e nevojshme për formimin e tyre si specialistë realizohet nëpërmjet njohurive që marrin gjatë këtyre tre viteve të studimeve bachelor. Në total syllabuset e hartuara synojnë të rrisin aftësinë e studentëve të kuptojnë parimet e inxhinierisë në fushën e burimeve minerare. Studentët e diplomuar në këtë program studimi dalin inxhinierë, të cilët kanë njohuri në fushën inxhinierike dhe aftësi menaxheriale. Programi ofrohet me një kurikul të pasur dhe kjo i ndihmon studentët që ta gjejnë veten në tregun e punës dhe kanë mundësi të punësohen në treg në një gamë të gjere profilesh në përshtatje me edukimin e tyre në këtë program. Shfrytëzimin e vendburimeve të mineraleve të dobishme; Menaxhim burimesh; Nxjerrja dhe përpunimi i materialeve të ndërtimit; Matje gjeomatike në objekte minerare dhe gjeologjike; Përpunimi i lëndëve të para; Trajtimi i depozitimeve sterile mbi dhe nëntokë në zonat minerare dhe industriale; Mbrojtja e rrjetit hidrografik natyror dhe të ndërtuar nga ndikimet minerare në sipërfaqe dhe në nëntokë; Rigjenerimi i objekteve të infrastrukturës në zonat minerare të dëmtuara; Studime dhe vërtetime të karakterit të levizjës së truallit nga ndikimi mineral dhe sizmik etj. (RVB) <i>Referenca:</i> <i>Ref 001 Statuti UPT</i> <i>Ref 010 Rregullore e PS BSc në Inxhinieri e Burimeve Minerare</i> <i>Ref 011 Plani Mësimor i PS BSc në Inxhinieri e Burimeve Minerare</i> <i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i>
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	GVJ konstaton se program i studimit Bachelor në Inxhinieri e Burimeve Minerare është i organizuar sipas sistemit evropian të transferimit dhe grumbullimit të krediteve ECTS. Ky program ka të përcaktuara veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët apo modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. Programi realizohet në 3 (tre) vite akademik, me 60 kredite ECTS në vit. Lëndët e parashikuara të zhvillohen në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri e Burimeve Minerare janë të larmishme. Fillohet në vit të parë me lëndë formuese si: B- 101 Analizë matematikore 1 B- 102 Gjeologji e përgjithshme

B- 103 Fizikë 1
 B-104 Gjuhë e Huaj
 B-105 Vizatim Teknik +CAD
 B- 106 Etikë komunikimi e prezantimi
 B-107 Analizë matematikore 2
 B-108 Informatikë
 B-109 Algjebër Gjeometri
 B-110 Kimi
 B-111 Fizikë 2
 B- 112 Hyrje në Inxhinierinë e Burimeve Minerare
 Në vit të dytë vazhdohet me:
 B-213 Statistikë dhe Probabilitet
 B- 214 Kimi e Mjedisit
 B-215 Ekologji e zbatuar
 B-216 Fizikë Teknike
 B-217 Ekonomiks, administrim Biznesi
 B- 218 Shkenca e konstruksioneve 1
 B- 219 Topografi
 B-220 Shkenca e konstruksioneve 2
 B-221 Elektroteknike dhe impiante
 B-222 Hidraulike
 B-223 Mekanike e Zbatuar
 B-224 Bazat e gjeofizikës
 Në vitin e tretë zhvillohen kryesisht lëndë specifike më të lidhura me profesionin, sic janë:
 B- 325 Gjeoteknikë
 B- 326 Përpunim i matjeve topografike
 B- 327 Mineralogji petrografi
 B- 328 Teknologji gjermimi
 B- 329 Hapje punimesh nëntokësore
 B- 330 Përpunim mineralesh
 B- 331 Teknologji nxjerrje
 B- 332 Matje në miniera
 B- 333 Mbrojtje mjedisi dhe siguria në punë
 B- 334 Zbatime të teknologjisë së informacionit
 B- 335/6 Si dhe një lëndë me zgjedhje
 B- 337 Provimi përfundimtar

Në planin mësimor është bërë ndarja e lëndëve sipas kategorive përkatëse:

Kategoria A- lëndët bazë të formimit të përgjithshëm

Kategoria B-lëndët karakterizuese të lidhura me vecantitë e programit të cilat japin formim specifik

	Kategoria C- lëndë ndërdisiplinore dhe grup lëndë me zgjedhje. Kategoria D- lëndë plotësuese dhe praktikat profesionale Kategoria E- detyrime përmbyllëse si teza a diplomës ose provimi përfundimtar. <table><tr><th>Kategoria</th><th>Kriteri Bachelor (VKM 41 datë 24.1.2018)</th><th>% ECTS</th></tr><tr><td>A (8 lëndë)</td><td>15-20%</td><td>21.6</td></tr><tr><td>B (19 lëndë)</td><td>50-55%</td><td>51.4</td></tr><tr><td>C (5 lëndë)</td><td>12-15%</td><td>13.5</td></tr><tr><td>D (4 lëndë)</td><td>10.15%</td><td>10.8</td></tr><tr><td>E (1 lëndë)</td><td>3-5%</td><td>2.7</td></tr><tr><td></td><td></td><td></td></tr></table> Referenca: Ref 010 Rregullore e PS BSc ne Inxhinieri e Burimeve Minerare Ref 011 Plani mesimor i PS BSc ne Inxhinieri e Burimeve Minerare.	Kategoria	Kriteri Bachelor (VKM 41 datë 24.1.2018)	% ECTS	A (8 lëndë)	15-20%	21.6	B (19 lëndë)	50-55%	51.4	C (5 lëndë)	12-15%	13.5	D (4 lëndë)	10.15%	10.8	E (1 lëndë)	3-5%	2.7			
Kategoria	Kriteri Bachelor (VKM 41 datë 24.1.2018)	% ECTS																				
A (8 lëndë)	15-20%	21.6																				
B (19 lëndë)	50-55%	51.4																				
C (5 lëndë)	12-15%	13.5																				
D (4 lëndë)	10.15%	10.8																				
E (1 lëndë)	3-5%	2.7																				
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Nga konsultimi me materialet e vëna në dispozicion nuk u gjet asnjë ngarkesë e veçantë për praktikën profesionale. Praktika profesionale nuk zhvillohet si lëndë më vete por si modul i përfshirë në disa lëndë. Referenca: Ref 011 Plani mësimor i PS BSc në Inxhinieri e Burimeve Minerare.																					
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Zyra e Burimeve Njerëzore është instanca e parë me të cilën një kandidat përballlet. Nëse ai pranohet duhet të plotësojë dosjen me dokumentacionin përkatës. Pranohen të regjistrohen në programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri e Burimeve Minerare”, shtetas shqiptarë dhe të huaj që plotësojnë kushtet e vendosura nga IAL. Pranimi i studentëve bëhet bazuar në Statutin e Universitetit dhe Rregulloren e programit të studimit në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe aktet nënligjore në fuqi. Referenca: Ref 001 Statuti UPT Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies ne UPT Ref 010 Rregullore PS BSc ne Inxhinieri e Burimeve minerare																					

Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	GVJ konstaton se ky program studimi nuk ofrohet nga ndonjë IAL me të njëjtin fushë studimi apo me të njëjtin emërtesë. Por sipas raportit të brendshëm si dhe sipas bashkëbisedimit me stafin e departamentin, konstatohet se kurrikula e këtij programi është hartuar duke u bazuar në kurikulat apo eksperiencat e Universiteteve jashtë të cilat ofrojnë programe të ngjashme studimi.
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	GVJ konstatoi se në zbatim të VKM Nr. 310, datë 11.05.2022 dhe Urdhër të MAS Nr. 31 datë 15.11.2022, Kodifikimi i lëndëve, është kryer. Universiteti Politeknik i Tiranës ka përfunduar procesin e kodifikimit të të gjitha programeve që ofron aktualisht <i>Referime:</i> <i>Ref 023 Syllabuset e lendeve ne PS BSc Inxhinieri e Burimeve Minerare</i>
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri e Burimeve Minerare" ofrohet vetëm nga UPT, Fakulteti Gjeologji Miniera.
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri e Burimeve Minerare është i projektuar në mënyrë që të sigurojë një student të përgatitur në aspektin teorik dhe cilësi profesionale për tregun e punës në vend dhe Europë.</i> <i>Përmbajtja e programit të studimit shkon për shtat me kërkesat aktuale të tregut të punës.</i> <i>Programi Bachelor në Inxhinieri e Burimeve Minerare i ofruar nga Departamenti i Inxhinierisë së Burimeve Minerare ka për qëllim të zgjerojë dijet dhe u jep studentëve aftësi të përgjithshme dhe profesionale që duhet të realizohen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij si dhe në ciklin e dytë e të tretë.</i> <i>Programi është hartuar në përputhje me politikat kombëtare të përcaktuara në planin strategjik për arsimin e lartë të Ministrisë së Arsimit, i ofruar në përputhje me nivelin e studimeve dhe me qëllim që të arrihen dimensione ndërkombëtare, duke përfshirë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor, duke marrë në konsideratë nevojat e tregut të punës.</i>

	<i>Praktika profesionale nuk zhvillohet si lëndë më vete por si modul i përfshirë në disa lëndë.</i> <i>Institucioni ka kryer procesin e kodifikimit të lëndëve sipas VKM Nr. 310, datë 11.05.2022 dhe Urdhër të MAS Nr. 31 datë 15.11.2022</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.			
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve		
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Departamenti i Inxhinierisë së Burimeve Minerare është pjesë përbërëse e Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave. Ai ka në përbërjen e tij dy Grupe Kërkimore Mësimore: 1. Inxhinieri Miniere dhe Përpunim Mineralesh dhe mbetjesh; 2. Gjeomatike. Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Institucioni, rezulton se njësia kryesore dhe ajo bazë, përgjegjëse për programin e studimit, përmbushin detyrimet ligjore. Departamenti plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 25, të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë të Republikës së Shqipërisë”. Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave si Njësia Kryesore për programin e studimit për vitin akademik 2022-2023 ka gjithsej katër njësi bazë: 1. Departamenti i Shkencave të Tokës; 2. Departamenti i Inxhinierisë së Burimeve Minerare; 3. Departamenti i Inxhinierisë së Burimeve të Energjisë; 4. Departamenti Gjeologji e Zbatuar dhe Gjeoinformatikë; Çdo njësi bazë është e përbërë nga një numër, të paktën 11 staf akademik, ku të paktën 1 prej tyre është me gradë shkencore PhD. Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave në vitin akademik 2023-2024 është i përbërë nga Personel Akademik Efektiv prej 48 pedagoge (PAE) dhe 30 Personel Akademik me kontratë (PAK) dhe 13 Personel ndihmës akademik, sipas kesaj tablele: <table border="1"> <tr> <td>Kualifikimi stafit</td><td>Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave</td></tr> </table>	Kualifikimi stafit	Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave
Kualifikimi stafit	Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave		

	PAE	PAK
Prof. Dr.	12	3
Prof. Asoc.Dr.	8	4
Dr/PhD	20	6
Dr. Proc.	1	-
Msc	7	17
Gjithsej	48	30
	78	

Për programin Bachelor në Inxhinieri e Burimeve Minerare, Departamenti, si njësi bazë përgjegjëse, angazhon një staf të brendshëm efektiv i cili ndihmohet edhe nga stafi me kontrate.

Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri e Burimeve Minerare”, Departamenti i Inxhinierisë së Burimeve Minerare përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik. Për vitin 2023-2024 janë 19 staf akademik, nga të cilët 13 janë personel akademik efektiv (PAE) dhe 6 personel akademik me kontratë (PAK), me kualifikimin që paraqiten si më poshtë për vitet akademike:

Tituj/Grada	2021-2022		2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof. Dr	3	-	3	0	3	1
Prof.Asoc	2	4	5	3	2	1
Dr/PhD	7	1	4	2	7	3
Msc	1	5	1	1	1	1
Gjithsej	13	10	13	6	13	6

Referenca:

Ref: 015 Organigrama e FGJM

Aneks RVB. Tabela 1

Aneks RVB. Tabela 2

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik	Njësia kryesore e Fakultetit të Gjeologji Miniera, së bashku me njësinë bazë DIBM, mban përgjegjësinë për përmbushjen e detyrimeve ligjore për strukturën akademike dhe organizimin e programit studimor duke përdorur udhëzimet e parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar.
--	--

/administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Departamenti i Inxhinierisë së Burimeve Minerare, në kuadër të praktikave profesionale dhe laboratorëve, angazhon staf akademik dhe ndihmës akademik me kualifikimet përkatëse për realizimin korrekt të tyre. Në tre vitet e fundit personeli ndihmës Akademik është 3 vetë me përshkrimin laborant. <i>Referenca:</i> <i>Anex RVB Tabela 1.2)</i> <i>Ref 106, Vendim i VKM 41 me date 24.01.2018].</i>			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinators të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Programi i ciklit të parë të Studimit Bachelor në " Inxhinieri e Burimeve Minerare" organizohet dhe menaxhohet nga Këshilli i Programit të Studimit (KPS), i cili përbëhet nga 5 anëtarë. Anëtarët e KPS propozohen nga departamentet që bashkëpunojnë për këtë program studimi dhe miratohen në Dekanatin e FGJM. Drejtuesi i KPS është koordinatori i programit të studimit i cili është J. Th. <i>Referenca:</i> <i>Ref 020 Vendimi i DIBM për ngritjen e KPS].</i> <i>Ref 010 Rregullore PS BSc në Inxhinierinë e Burimeve Minerare</i>			
Konkluzione	<i>Në raport ka mospërputhje në tabelat që referohen për numrin e stafit me tabelat e shpërndara në anekse.</i> <i>GVJ konstaton se njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3 Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën	Departamenti i IBM zotëron informacionet e nevojshme për organizimin dhe përmbajtjen e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri e Burimeve Minerare. Si pjesë të këtij informacioni mund të përmendim: plani strategjik i Departamentit, programi i studimit, plani strategjik i universitetit, statuti i universitetit UPT, rregullorja e universitetit, rregullorja e fakultetit, rregullorja e diplomimit për të vijuar me rregullorja e programit të studimit; Rregullorja

dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, rregulloret e sekretarisë dhe zyrës së burimeve njerëzore. Të gjitha informacionet janë të publikuara në faqen e internetit të universitetit dhe të aksesueshme nga të gjithë. Departamenti dhe çdo anëtar i personelit akademik/administrative ka akses të plotë tek dokumentat e sipërpërmendura. Çdo fillim semestri studentëve u vihen në dispozicion syllabuset dhe materialet e leximit. <i>Referenca:</i> <i>Ref 001 Statuti i UPTI</i> <i>Ref 006 Rregullore e Brendshme FGJM</i> <i>Ref 015 Organigrama e FGJM</i> <i>Ref 010 Rregullore e PS BSc në Inxhinieri e Burimeve Minerare</i> <i>Ref 011 Plan Mesimor i PS BSc në Inxhinieri e Burimeve Minerare,</i> <i>Ref 044 Praktika e Miratimit të Planëve Mesimore</i> <i>Ref: 023 .Syllabuset e Lendëve në PS BSc Inxhinierisë e Burimeve Minerare</i> <i>Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies në UPT</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri e Burimeve Minerare është organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi zhvillohet në përputhje me programin e licencuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri e Burimeve Minerare është i strukturuar në 3 vite akademike dhe 6 semestra. Zhvillohen gjithsej 37 lëndë ku përfshihen edhe provimi përfundimtar ose punim diplome, të ndara sipas 3 viteve akademike. Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 879, datë 18.12.2019) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E). Bazuar në kreditet përkatëse lëndët e kategorive të ndryshme kanë këtë shpërndarje: - A - Lëndë Bazë 8 lëndë me 42 ECTS gjithsej; - B- Lëndë Karakterizuese 19 lëndë totali 92 ECTS; - C -Lëndë Ndërdisciplinore/Integruese 20 ECTS; - D- Lëndë Plotësuese 4 lëndë totali 20 ECTS; - E - Detyrime Përmblyëse 6 ECTS.

	Orët që studenti shpenzon në auditor variojnë nga 26 deri në 28 orë totale në javë. <i>Referenca:</i> <i>Ref 011 Plani Mesimor i PS BSc në Inxhinieri e Burimeve Minerare.</i> <i>Ref 044 Praktika e Miratimit të Planeve Mesimore</i> <i>Ref 023 Syllabuset e lendeve në PS bachelor në inxhinieri e burimeve Minerare</i> <i>Ref 010 Rregullore PS BSc Inxhinieri e Burimeve Minerare</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Institucioni, nëpërmjet Rregulloreve të brendshme të tij i jep studentëve informacion lidhur me kriteret e pranimit. Të gjithë kandidatët që dëshirojnë të regjistrohen në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri e Burimeve Minerare duhet të plotësojnë përkatësisht kriteret e pranimit, të përcaktuara nga Departamenti e të aprovuara nga Dekanati dhe Senati Akademik në përputhje me VKM përkatëse. Kriteret publikohen në portalin U-Albania dhe në faqen zyrtare të Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave të cilat janë të aksesueshme nga të gjithë të intersuarit. <i>Referenca:</i> <i>Neni 19. Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies në UPT</i> <i>Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies në UPT</i> <i>Neni 09. Ref 011 Rregullore e PS BSc në Inxhinieri e Burimeve Minerare</i> <i>Ref 045 Praktike transferim studimesh FGJM</i> <i>Ref 025 Guida studentore</i> <i>Ref 026 Praktika e miratimit të kuotave të pranimit në FGJM</i> <i>Ref 027 Praktika e miratimit të kriterëve të pranimit në FGJM</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri e Burimeve Minerare" përmban të gjithë informacionet e nevojshme për njësinë përgjegjëse, viti akademik, njësia përgjegjëse, struktura e lëndës, emri i titullarit të lëndës. Njohuritë paraprake që duhet të ketë paraprakisht studenti, rezultatet e të nxënies të lëndës, njohuritë dhe aftësitë që përfton studenti nga përvetësimi i lëndës, konceptet dhe termet bazë mbi të cilat nderohet lënda. Përmbajtja e lëndës e ndarë në leksione e seminare/detyra e projekte, etj., ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit. Syllabuset e çdo lënde japin informacion të detajuar për leksionet, seminarin, praktikën ose laboratorin.

	Mënyra e vlerësimit të dijeve tregohet në rregulloren e PS. Mënyra e vlerësimit është e përcaktuar edhe në syllabus. <i>Referenca:</i> <i>Ref 011 Plani Mesimor i PS BSc ne Inxhinieri e Burimeve Minerare</i> <i>Ref 023 Syllabuset e Lendeve ne PS Bachelor ne Inxhinieri e Burimeve Minerare</i> <i>Tabela 14 -Aneket</i>			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Stafi akademik propozon ndryshime për programin e studimit çdo viti akademik sipas rregullores së FGJM. Këto propozime miratohen nga Departamenti, nga dekanati dhe pasi kalon edhe nga Drejtoria e Kurrikulave miratohet përfundimisht nga Senati para fillimit të vitit përkatës akademik. <i>Referenca:</i> <i>Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe mesimdhënies ne UPT</i> <i>Ref 044 Praktikat e Miratimit te Planeve Mesimore</i>			
Konkluzione	<i>GVJ duke ju referuar raportit, dokumentave bashkëngjitur dhe nga kontaktet gjatë vizitës në IAL, konstaton se programi i studimit është i strukturuar dhe organizuar në përputhje me objektivat formuese të programit të ciklit të parë.</i> <i>Syllabuset përmbajnë informacione të nevojshme për secilën lëndë.</i> <i>Studentët gjejnë të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</i> <i>Programi i studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe	Programi i studimit ofrohet nga FGJM dhe emërtimi i tij Bachelor në "Inxhinieri e Burimeve Minerare" është i pandryshuar që prej krijimit të këtij programi.

praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve. Sa më sipër është në përputhje me L.A.L. 80/2015 si dhe rregulloret institucionit. Ndërthurja e njohurive teorike (leksione, etj.) me ato praktike (ushtrime, laboratore, praktika mësimore, etj.) i jep të diplomuarit në Inxhinieri e Burimeve Minerare kompetenca profesionale të mjaftueshme për tu punësuar në ndërmarrjet vendase të prodhimit, shërbimeve dhe në sektore të ndryshëm industrial në fushën e minierave dhe më gjerë. Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri e Burimeve Minerare" zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve në fushën e Inxhinierisë Minerare. <i>Referenca;</i> <i>Ref 010 Rregullore e PS BSc ne Inxhinieri e Burimeve Minerare</i> <i>Ref 011 Plani Mesimor i PS BSc ne Inxhinieri e Burimeve Minerare</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Programi i studimit, plani mësimor, disiplinat dhe veprimtaritë formuese që ofrohen, mundësojnë arritjen e objektivave formues të programit Bachelor në Inxhinieri e Burimeve Minerare. Shpërndarja e lëndëve në semestra është bërë në përputhje me rregulloren e programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri e Burimeve Minerare". Studimet në këtë cikël janë 180 ECTS të ndara në 6 semestra. Kjo ndarje mundëson arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënit. Kreditet janë ndarë sipas aktiviteteve formuese duke ruajtur një raport proporcional ndërmjet aktiviteteve. Kështu gjatë vitit të parë studentët marrin lëndë formuese bazë (kategoria A, me 5 kredite kryesisht), ndërsa në vazhdim, dy vitet pasardhëse, marrin lëndë të formimit inxhinierik (kategoria B), me 4, 5 dhe 7 kredite si dhe lëndë ndërdisiplinore (kategoria C dhe D) që i shërbejnë studentit për formim në një fushë më të gjerë inxhinierike si dhe aftësi të tjera të nevojshme për një inxhinier. Gjithashtu kontrolli i vazhdueshëm i dijeve, praktika dhe seminarët rrisin mundësinë për të arritur objektivat formuese të studentit. Në pjesën më të madhe të lëndëve inxhinierike aplikohen detyra kursi, laboratore, të cilat synojnë të zhvillojnë

	aftësitë komunikuese të studentëve dhe në përvetësimin e aftësive të tyre të pritshme. <i>Referencë:</i> <i>Neni 7, Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhenies ne UPT</i> <i>Ref 010 Rregullore e PS BSc ne Inxhinieri e Burimeve Minerare</i> <i>Ref 011 Plani Mesimor i PS BSc ne Inxhinieri e Burimeve Minerare</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Struktura e programit është krijuar duke u bazuar në përvojën e stafit, brenda dhe jashtë vendit dhe është e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare si psh, mbështetur në modelin e Universitetit Politeknik të Torinos. Strukturua e programit, lëndët emërtimet e tyre ngarkesa në kredite, raporti teori - praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit. Lëndët që përfshijnë aspekte teorike (leksione) dhe aspekte praktike (seminare, ushtrime laboratore) janë në raporte të përshtatshme. Pjesa më e madhe e lëndëve është organizuar si ngarkesë javore prej 3 leksione dhe 2 seminare. Në përmbajtjen e lëndëve profesionale përfshihen edhe praktikatat mësimore. <i>Referenca:</i> <i>Ref 011 Plani mesimor i PS BSc ne Inxhinieri e Burimeve Minerare</i> <i>Ret 023 Syllabuset e lendeve ne PS BSc Inxhinieri e Burimeve Minerare</i> <i>Ref 048 Raporti I Analizes Mesimore Staf Departament FGJM</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri e Burimeve Minerare është organizuar në lëndë e module të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Kjo gjë ju mundëson studentëve transferimin e studimeve në institucione të tjera. <i>Referenca:</i> <i>Ref 011 Plani Mesimor i PS BSc ne Inxhinieri e Burimeve Minerare</i> <i>Ref 023 Syllabuset e Lendeve ne PS BSc ne Inxhinieri e Burimeve Minerare</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen	Departamenti përpiqet të përditësojë lëndët dhe modulet në mënyrë të vazhdueshme. Litaratura e rekomanduar është bazuar kryesisht në tekset klasike dhe që datojnë herët në kohë.

në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Pas shqyrtimit të syllabuseve të lëndëve, GVJ, vërejti se disa nga to nuk pasqyrojnë literaturë bazë bashkëkohore, të viteve të fundit. Në lëndë të vecanta si: • <i>Gjeologji e përgjithshme, B-102, asnjë nuk ka asnjë literature, vetëm leksione;</i> • <i>Hyrje në inxhinierinë e burimeve natyrorë -leksione dhe botime të vitit 1988!!!;</i> • <i>Në lëndën e Anglishtes- literatura është shumë e vjetër;</i> • <i>Shkenca e konstruksioneve- literaturë bazë është e vitit 1974;</i> • <i>Topografi-literaturat bazë janë vetëm leksione të shkruara që datojnë vitin 2002 dhe vetëm nga autorë shqiptarë;</i> • <i>Elektroteknikë dhe impiante- Leksione të shkruara për Elektroteknikën e përgjithshme;</i> • <i>Etj.</i> <i>Literaurat bazë janë leksione të shkruara dhe jo literature e 5 viteve të fundit dhe bashkëkohore.</i> <i>GVJ nuk arriti të shikojë titujt e librave që ka biblioteka e Fakultetit, pasi e gjithë godina e fakultetit ishte në rikonstruksion dhe ishin lëvizur transportuar diku tjetër.</i> <i>Referenca:</i> <i>Ref 023 Syllabuset e Lendeve ne PS BSc Inxhinieri e Burirneve Minerare</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri e Burimeve Minerare" i ofron studentëve njohuri dhe dije specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje me nivelin e ciklit të parë të studimeve, duke tentuar të krijojë bazat e duhura për një studim më të thelluar dhe të përparuar. Krahas njohurive shkencore teorike synohet aftësimi praktik i studentëve nëpërmjet praktikave. Duke ju referuar syllabuseve të lëndëve, zëri "Rezultatet e të nxënit" është hartuar duke ju referuar tre shtyllave bazë që janë: përftimi i njohurive, aftësive dhe kompetencave që synon programi dhe niveli bachelor. Përmbajtja e programit u mundëson dhe u garanton studentëve përftimin e dijeve, fitimin e aftësive dhe kompetencave profesionale, të cilat përbëjnë edhe synimet kryesore të këtij programi të përcaktuara edhe në Rregulloren e studimeve të programit. <i>Referenca:</i>

	<i>Ref 023 Syllabuset e Lendeve ne PS BSc Inxhinieri e Burimeve Minerare</i> <i>Ref 010 Rregullore e PS BSc ne Inxhinieri e Burimeve Minerare</i>			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Përmbajtja dhe struktura e organizimit të këtij programi studimi Bachelor në Inxhinieri e Burimeve Minerare përputhet me nivelin përkatës si të kuadrit kombëtar ashtu edhe atij evropian të kualifikimit dhe kjo mundëson plotësisht vijimin e mëtejshëm të studimeve në ciklin e dytë, Master. Ky stad studimi si dhe rezultatet e pritshme, janë të mjaftueshme për tregun e punës në fushën e burimeve minerare vendase të prodhimit dhe shërbimeve në sektorë të tjerë. <i>Referenca:</i> <i>Ref 010 Rregullore e PS BSc ne Inxhinieri e Burimeve Minerare.</i> <i>Ref 031 Sondazhe mbi tregun e punes</i> <i>Ref 032 Studim per industrine Minerare.</i>			
Konkluzione	<i>Pas shqyrtimit të syllabuseve të lëndëve GVJ vërejtë se disa nga to nuk pasqyrojnë literaure bazë bashkekohore të viteve të fundit. Në disa lëndë, Litaratura bazë janë leksionet e shkruajtura nga pedagogu i lëndës dhe literaturat nuk janë të viteve të fundit. Mesimdhënia duhet të pasurohet edhe me literature të huaj.</i> <i>GVJ nuk arriti të shikojë titujt e librave që ka biblioteka e Fakultetit.</i> <i>Për përmirësimin e programit të studimit dhe përditësimin e tij, është e domosdoshme përditësimi i literaturës bazë dhe ndihmëse me më shumë tituj si dhe literaturë të kohëve të fundit.</i> <i>GVJ konstaton që struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</i> <i>Duke ju referuar syllabuseve të lëndëve, zëri " Rezultatet e të nxënit" është hartuar duke ju referuar tre shtyllave bazë që janë: përfshirja e njohurive, aftësive dhe kompetencave që synon programi dhe niveli bachelor. Disa lëndë si p.sh Analiza Matematike I, Gjeologji, etj nuk i kanë të shprehura mirë aftësitë që përfiton studenti.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Stafi i departamentit organizon takime në terren me administratorë dhe drejtues të sipërmarrjeve në fushat inxhinierike nëpërmjet të cilave marrin propozime dhe idera për të përmirësuar përmbajtjen e programit të studimit në mënyrë që të përshtatet me tregun e punës. Njësitë përgjegjëse nuk kanë kontaktet me studentët alumni. <i>Referenca:</i> <i>Tabelat përmbledhëse: Tabela 5 institucionet dhe organizatat bashkëpunuese</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Sipas raportit të brendshëm, përfshirja e studentëve në përmirësimin e programit të studimit kryhen në disa drejtime: 1. Përfaqësues të studentëve marrin pjesë në mbledhjet e KPS-ve të Departamentit; 2. Përfshirja në senatin akademik, organin më të lartë vendimmarrës, të kryetarit të këshillit studentor, përcaktuar në Statutin e Institucionit; 3. Përfshirja në Njësine e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë; 4. Përfshirja e studentëve në Komisionin e Përhershëm të Garantimit të Cilësisë. <i>GVJ pas takimeve me stafin e departamentit dhe studentët konstatoi se lidhjet dhe kontributi i studentëve nuk është aktiv në përmirësimin e programit të studimit.</i> <i>Konsultimet me studentët dhe të diplomuarit nuk kryhen. Mendimi dhe opinioni i tyre nuk reflektohet në përmirësimin e programit të studimit.</i> <i>Anketimi i studentëve nuk kryhet me korrektesi dhe sipas programit.</i> <i>Referenca</i> <i>Vizita në Institucion</i> <i>RVB</i>

Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Departamenti i Inxhinierisë së Burimeve Minerare, si njësia përgjegjëse e programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri e Burimeve Minerare", është i gatshëm për përditësimin e programit për t'ia përshtatur zhvillimeve të fundit. Nga takimet dhe bashkëpunimet me ortakët dhe palët e interesuara, merren në konsiderate propozimet e tyre për përmirësimin dhe përshtatjen e programit. Departamenti organizon mbledhje me stafin akademik të departamentit për diskutimin në lidhje me syllabuset, me qëllim përmirësimin e programit. <i>Referenca:</i> Tabelat përmbledhëse: Tabela 5 Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese			
Konkluzione	GVJ pas takimeve me stafin e departamentit dhe studentët konstatoi se lidhjet e departamentit me studentët dhe kontributi i studentëve nuk është aktiv në përmirësimin e programit të studimit. Njësitë përgjegjëse nuk kanë kontaktet me studentët Alumnai. Konsultimet me studentët dhe ato të diplomuarit nuk kryhen dhe mendimi dhe opinioni i tyre nuk reflektohet në përmirësimin e programit të studimit. Anketimi i studentëve nuk kryhet me korrektesi dhe sipas programit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Format e mësimdhënies të përdorura në programin e studimit Bachelor në " Inxhinieri e Burimeve Minerare" janë: Leksione, Seminare, Laboratore, Seanca praktike profesionale të zhvilluara në auditor, Praktika Profesionale në terren, Prezantime në baza javore për lëndët me projekt, Detyra javore, Leksionet të hapura, të organizuara në formën e ëorkshop-eve dhe seminarëve apo trajnimeve nga profesionistë të fushës. Në raport shkruhet se është edhe një aktivitet si "Praktika Profesionale, e parashikuar si lëndë e detyrueshme në semestrin e gjashtë". Por në Planin mësimor dhe gjatë takimit me stafin, na u konfirmua se Praktika mësimore nuk zhvillohet si lëndë më vete por si pjesë e integruar e disa lëndëve. Ndarja e formave të mësimdhënies sipas 3 viteve në Programin e Studimit është si më poshtë • leksione 1140.0 (420+372+335) orë mësimore sipas tabelës së planit mësimor janë 1125 orë! • seminare (784.5 orë), • ushtrime/laboratore (210.0 orë), • forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale të zhvilluara në auditor (107.5 orë), • praktikë profesionale (14.5 orë) • dhe udhëheqje teze diplome/konsultime për provimin përfundimtar të formimit (30 orë), • gjithsej 2286 orë mësimi sipas raportit, 2260 në planin mësimor. Çdo vit akademik është i organizuar në 60 kredite në një total 180 kredite. Studentët vlerësohen me kontroll të vazhdueshëm dhe mënyrat e vlerësimit janë të formave si provim, vlerësim projekti/detyra kursi, vlerësim i punëve laboratorike, provim përfundimtar. Pësia e secilës mënyrë vlerësimi është e përcaktuar në syllabuset e lëndëve përkatëse. <i>Referenca:</i> <i>Ref 011 Planit mesimor i PS BSc ne inxhinieri e burimeve minerare</i> <i>Aneks R/VB. Tabela 13</i>

	<i>Ref. 023 Sylabuset e lenedevë në PS BSc në Inxhinieri e Burimeve Minerare</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Procesi i mësimdhënies në programin e studimit, është kombinim i njohurive teorike dhe praktikës profesionale. Stafi akademik ofron forma dhe metoda alternative të mësimdhënies. Disa nga këto metoda janë zhvillimi i mësimin "e-Learning" e cila është aplikuar për dhënien e njohurive, mësimdhënies. Me këto metoda, personeli akademik ka synuar të lehtësojë të kuptuarit e përdoren mjetet audio vizive të teknologjisë për realizimin e orëve mësimore. Gjithashtu synohet që materialet e shtypura nga disa profesore zëvendësohen me versione elektronike si dokumente, linke, ëbsite, materiale të bashkëngjitura, prezantime poër-point, audio, video, teste, forume, animacione, etj. Pjesa më e madhe e moduleve të programit, sidomos ato profesionale, përmbajnë detyrime për përgatitjen e detyrave të kursit në grup, të cilat i aftësojnë studentët për përthithjen dhe zbatimin e informacionit teorik si dhe aftësinë e të punuarit në grup. Gjithashtu, mbështetur edhe në marrëveshjet me industrinë, studentët kryejnë praktikën e tyre profesionale pranë ku studentët punojnë në kushte reale që i ndihmon për të përballuar aktivitetin e tyre profesional. Departamenti IBM përgjegjës për këtë program studimi ka punësuar edhe staf akademik ndihmës i cili ndihmon studentët dhe është në funksion të mirëmbajtjes dhe zhvillimit të laboratorëve. <i>Referenca:</i> <i>Ref 023 Sylabuset e lenedevë në PS BSc në Inxhinieri e Burimeve Minerare</i> <i>Ref 051 Marrëveshje me Industrinë dhe Institucionet</i> <i>Ref 053 Procedure e organizimit të praktikës mësimore FGJM/DIBM</i> <i>Ref 062 Model faqe ëbsite pedagogu</i> <i>Ref 068 Shembull klase virtuale në platformën Google Classroom</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënës.	Institucioni mbështet stafin e tij akademik për të përmirësuar kompetencat didaktike, si dhe inkurajon e motivon stafin akademik për të përmirësuar më tej mësimdhënien duke organizuar aktivitete të ndryshme trajnimit, leksione të hapura dhe Workshope me profesorë të ftuar nga universitete të ndryshme.

	Kjo mbështetje demonstron përmes vendosjes së marrëveshjeve të shumta të bashkëpunimit me institucionet homologe jashtë dhe brenda vendit. Fokusi kryesor i këtyre marrëveshjeve përfshin disa fusha si shkëmbimin e stafit akademik me qëllim të aktiviteteve mësimore dhe kërkimore. Përveç kësaj, këto marrëveshje gjithashtu lehtësojnë promovimin dhe realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore, si dhe organizimin e konferencave, trajnimeve, seminareve, shkëmbimit të materialeve akademike dhe literaturës shkencore. Mundësi të tjera janë programi Erasmus + për shkëmbimin e stafit ku stafi akademik mund të përfitojë nga mundësitë që këto përvoja japin për të përmirësuar kompetencat e tyre didaktike. Nga takimi me stafin e departamentit të Inxhinierisë Minerare na u konfirmua pjesëmarrja në projekte të AKKSHI, ku për vitin 2024, projektet të fituara janë nga FGJM (41%). Stafi i departamentit është aktiv në pjesëmarrje në projekte. Gjithashtu në dispozicion të stafit akademik dhe studentëve janë edhe laboratorët e shumtë që disponon FGJM dhe fakultetet e tjera të UPT por që GVJ nuk arriti ti vizitonte për shkak të rikonstruksionit në këtë Fakultet. <i>Referenca:</i> <i>Ref 049 Marrëveshjet Institucionale UPT</i> <i>Ref 054 Informacion mbi Labororet DIBM</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mesimdhënie në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mesimdhënieve interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te studenti mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	GVJ konstaton se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit, është kompetent në fushën e tij, në transmetimin e dijeve dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme mesimdhënie sipas profilit të secilit. Të gjithë profesorët japin lëndë të cilat janë ngushtësisht të lidhura me fushat e tyre të ekspertizës. Pedagoget kanë eksperiencë akademike dhe kualifikime të shumta. Titullarët e lëndëve kanë kualifikime dhe janë me shumë eksperiencë të gjatë dhe ndër specialistët më të mirë në vend në fushat përkatëse. <i>Referenca:</i> <i>Tabelat 1, 2 & 6 Anekset</i> <i>Ref 024 CV e stafit akademik</i> <i>Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënieve ne UPT - Neni: 26.</i> <i>Ref 056 Procedura e punesimit te personelit PAE ne UPT</i> <i>Ref 057 Procedura e Punesimit te personclit PAK ne UPT</i> <i>Ref 069 Praktike punesimi per staf akademik FGJM.</i>

Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	Njësia përgjegjëse për programin e studimit, në përfundim të procesit mësimor, tërheq mendimet nëpërmjet stafit të saj në lidhje me zhvillimin e lëndës, si dhe propozime apo ndryshime në programin e lëndës. Kështu në fund të çdo viti akademik stafi akademik efektiv bën raportin e punës së tij mësimore ku analizon nder të tjera format e mësimdhënies dhe propozon përmirësimet e mundshme. Nga takimi me stafin dhe studentët na u konfirmua se në fillim dhe në fund të çdo viti akademik studentët plotësojnë një pyetësor vlerësimi duke dhënë vlerësimet dhe mendimet e tyre për mësimdhënien dhe pedagogët. GVJ konstatoi disa mospërputhje në deklaratat e stafit dhe të studentëve në lidhje me zhvillimin e këtij pyetësori. U kërkuar të kemi në dispozicion një model pyetësori por nuk na është shpërndarë. Referenca Ref 065 Anketimi studentor-Pyetësori dhe Raporti është një raport që jep informacion për mbarevajtjen e pyetësorit të kryer për vitin 2021-2022. <i>Referenca:</i> <i>Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurikular dhe Mesimdhënies në UPT</i> <i>Ref 048 Raporti i Analizes Mesimore UPT.</i> <i>Ref 065 Anketimi studentor-Pyetësori dhe Raporti</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të	Në përputhje me Legjislacionin e Arsimit të Lartë, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e cila është përgjegjëse për përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies në nivel institucional. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në DIBM përbëhet nga 2 anëtarë, të cilët miratohen nga Stafi akademik i departamentit me propozim të përgjegjësit të Departamentit. Një anëtar është nga stafi akademik i DIBM (PAK) dhe një përfaqësues student në programin e studimit. Kjo strukturë promovon përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinon dhe bashkërendon aktivitetet me njësinë kryesore dhe njësinë bazë në shërbim të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Në nivel institucional janë hartuar udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies në bazë të fushave të ndryshme të studimit dhe lëndëve specifike. NJSBC së bashku me Zyrën e Kërkimeve dhe Projekteve, Zyrën e Burimeve Njerëzore, Fakultetet përkatëse si dhe anëtarët e tjerë kryejnë trajnime të rregullta për zhvillimit

mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	profesional të stafit mësimdhënës bazuar në nevojat e Strategjisë Institucionale dhe Planin e Veprimit. Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Drejtoria e Kurrikulave janë përgjegjëse për standardet e përgatitjes së planeve mësimore syllabuseve të lëndëve si dhe të gjithë dokumentacionit të programeve të studimit, si dhe në përmirësimin e cilësisë së stafit akademik, përmirësimin e infrastrukturës laboratorike e të mësimdhënies dhe persosjen e metodave të mësimdhënies. <i>GVJ konstatoi se Drejtoria e kurrikulave nuk bën dhe nuk i është bërë asnjë trajnim në lidhje me kurikulat. Nuk ka një format për plotësimin e kriterëve për stafin që rekrutohet. Stafi me kontratë nuk është rivlerësuar si stafi efektiv.</i> <i>Referenca:</i> <i>Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurikular dhe Mësimdhënies ne UPT</i>			
Konkluzione	<i>UPT me anë të strukturave të tij garanton procesin e mësimdhënies. Institucioni i ka të organizuara strukturat në nivel institucional me detyrë promovimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies.</i> <i>Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, duhet të përmirësojë format dhe metodat e tërheqjes së mendimit të studentëve për mësimdhënien në mënyrë periodike dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre. GVJ konstatoi se pyetësi i studentëve nuk kryhet në mënyrë korrekte.</i> <i>Drejtoria e kurrikulave nuk bën dhe nuk i është bërë asnjë trajnim në lidhje me kurikulat.</i> <i>Nuk ka një formular model për plotësimin e kriterëve për stafin që rekrutohet.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive	Në FGJM, përcaktimi i rregullave dhe mënyrës së realizimit të kontrollit të dijeve bazohet në Procedurën e Kontrollit dhe Vlerësimit të Dijeve në FGJM.

profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Në këtë dokument përcaktohen kriteret dhe mënyrën e testimit të vlerësimit të njohurive. Gjithçka i bëhet e qartë studentit në fillim të procesit mësimor nga pedagogët e lëndëve. <i>Referenca;</i> <i>Ref 041 Procedura e Kontrollit dhe Vlerësimit të Dijeve në FGJM</i> <i>Ref 004 Rregullore e Zhvillimit kurikular dhe mësimdhënies në UPT, kreu V</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në fillimin e semestrit akademik studentët njihen me programin e lëndës, përmbajtjen e saj, si edhe formën e vlerësimit nga vetë pedagogu i lëndës. Në çdo syllabus, përcaktohet edhe mënyra vlerësimit të studentëve. Me syllabusin studentët njihen nga lektori i lëndës. Kriteret e vlerësimit përcaktohen nga titullari i lëndës dhe pasqyrohen në programin e lëndës. <i>Referenca:</i> <i>Ref 041 Procedura për Vlerësimin e Dijeve në FGJM.</i> <i>Ref 023 Syllabuset e Lendëve në PS BSc në Inxhinieri e Burimeve Minerare</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Në orën e fundit të mësimin, Pedagogu i lëndës i komunikon studentit për të drejtën ose jo të futjes në provim; nivelin e pikëve të fituara në forma të tjera të kontrollit gjatë vitit si dhe kriteret e vlerësimit përfundimtar. Duke iu referuar syllabuseve të lëndëve si dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, rezulton se për të gjitha lëndët vlerësimi është gjithë-semestral dhe përfshin forma të ndryshme vlerësimi. Kjo realizohet përmes këtyre kriterëve të ndryshme që janë: (1) detyrat e kursit, (2) provime të ndërmjetme, (3) projekte kurse, (4) kontroll i relacioneve të punëve laborator, (5) kontroll i relacioneve të praktikave mësimore (6) provim përfundimtar. Provimi përfundimtar mund të jetë me shkrim, me gojë ose i kombinuar me shkrim e me gojë, duke u mbështetur në programin mësimor. <i>Referenca</i> <i>Ref 010 Rregullore PS BSC në DIBM</i> <i>Ref 023 Syllabuset e Lendëve në PS BSc në Inxhinieri e Burimeve Minerare</i>
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e	Titullari i lëndës dhe stafi mësimdhënës, në përfundim të procesit mësimor, japin mendime në lidhje me zhvillimin e lëndës, si dhe propozojnë ndryshime në programin e lëndës.

mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, duhet të përmirësoj formatet dhe metodat e tërheqjes së mendimit të studentëve për mësimdhënien në mënyrë periodike dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre. <i>GVJ konstatoi se pyetësori i studentëve faktikisht nuk kryhet.</i> <i>Referenca:</i> <i>Neni 13. Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies ne UPT</i>			
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Stafi akademik përdor mjete bashkëkohore të mësimdhënies siç janë mjetet audio-vizive. Gjithashtu në dispozicion të stafit akademik dhe studentëve janë dhe laboratorët që disponon FGJM dhe fakultetet e tjera të UPT. Futja në programet e lëndëve mësimore të detyrave të kursit e projekteve, sjell një angazhim më të madh të studentëve në procesin mësimor. Përdorimi i rasteve studimore ndihmon në rritjen e interesit të studentëve dhe në rritjen e nivelit të aplikueshmërisë së informacioneve të marra në praktikë. Në mësimdhënien e programit të studimit, aplikohet prezantimi i detyrave të kursit si dhe diskutimet në grup, paraqitja dhe interpretimi i problemit. <i>Referenca:</i> <i>Ref 054 Informacion laboratore DIBM.</i> <i>Ref 023 Syllabuset e lendeve ne PS BSc ne Inxhinieri e Burimeve Minerare.</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni ka rregullore dhe procedura të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</i> <i>GVJ konstatoi se për përmirësimin e formave dhe metodave të mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre, gje e cila nuk kryhet faktikisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Sipas syllabuseve të programit të studimit, përcaktohen kriteret dhe mënyrën e testimit të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale. Gjithçka i bëhet e qartë studentit në fillim të semestrit nga pedagogët e lëndëve. Duke iu referuar edhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, rezultojnë se për të gjitha lëndët vlerësimi përfshin forma të ndryshme, si projekte, detyra kursi, laboratore, quize provime ndërmjetëse dhe provim përfundimtar etj. <i>Referenca:</i> <i>Ref 011 Plani Mesimor PS BSc në Inxhinieri e Burimeve Minerare</i> <i>Ref 041 Procedura për Vlerësimin e Dijeve në FGJM</i> <i>Ref 023 Syllabuset e lendeve në PS BSc Inxhinieri e Burimeve Minerare,</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Pas takimit me stafin akademik dhe studentët u konstatua se testimi i studentëve kryhet me metoda klasike, në formatin “kopje fizike”. Provimet janë anonime dhe për këtë ka një procedurë të përcaktuar: studentët vendosin një kod të personalizuar të cilin e di vetëm studenti dhe koordinatori i departamentit, me qëllim që të ruhet anonimiteti dhe të shmangen forma të ndryshme abuzimi. <i>Referenca:</i> <i>Ref 094 Model Fletore provimi</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive kryhet me shkrim dhe nga pedagogu i lëndës. Të gjitha modalitetet si forma e provimit, temat e përfshira, përcaktohen në syllabus. <i>Referenca:</i> <i>Ref 023 Syllabuset e lendeve në PS BSc Inxhinieri e Burimeve Minerare,</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Studentët konfirmojnë se kanë të drejtë të shikojnë personalisht provimin në prani të personelit akademik të lëndës, për të marrë sqarimet e duhura. Në raste kontestimi, pedagogu i lëndës është i gatshëm për të bërë sqarimet e nevojshme. <i>Ref.</i> <i>Vizita në Institucion.</i>

Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Studentët vlerësohen në provimin e lëndës nga një komision i vlerësimit me jo më pak se dy pedagogë: lektori i lëndës dhe pedagogë të tjerë të përfshirë në mësimdhënien e lëndës. Komisionet e provimit të lëndës ngrihen nga Drejtuesi i Departamentit dhe i dërgohen Dekanatit për informim, jo më vonë se një javë nga fillimi i sezonit të provimeve. Personeli akademik është përgjegjës për kontrollin dhe shmangien e plagjiaturës dhe kopjeve në provim. Provimet organizohen në salla të mëdha me të paktën dy vëzhgues. <i>GVJ konstatoi se studentët nuk e njohnin mirë procedurën e thyerjes së rregullave në provim.</i> <i>Referenca:</i> <i>Ref 004 Rregullore Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i> <i>Ref 041 Procedura per Vleresimin e Dijeve në FGJM</i> <i>Ref 105 Praktika te Propozimit të Komisioneve te Provimit</i> <i>Neni 6 & 9. Ref 003 Kodi i Etikës i UPT</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Stafi akademik konfirmoi se në të gjitha format e organizimit të provimit, studenti merr vlerësimin përkatës nga komisioni jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga data e dhënies së provimit. Provimet e studentëve ruhen në departament nga lektori për një periudhë, të paktën deri në sesionin pasardhës të provimeve. <i>Ref.</i> <i>Vizita në Institucion.</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Sipas rregulloreve të institucionit, studenti ka të drejtë të ankimohet, në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat procedurale gjatë zhvillimit të provimit ose nuk është dakord me vlerësimin e bërë. Por studentët nuk ishin të qartë për mënyrën dhe procedurat e ankesës që kanë të drejtë të bëjnë. <i>Referenca:</i> <i>Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies ne UPT.</i> <i>Ref 041 Procedura per Vleresimin e Dijeve ne FGJM.</i>
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e	Në rast se studenti ka ankesë, Komisioni i vlerësimit është i detyruar të sqaroj studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara të studentit me tezën e zgjidhur. Çdo ankesë nga studentët për vlerësimin në provime shqyrtohet nga Dekani dhe Zv. Dekani për veprimtarinë mësimore, të cilët

përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	mund të thërrasin për sqarime drejtuesin e departamentit, komisionin e vlerësimit dhe vetë studentin. <i>Referenca:</i> <i>Ref 041 Procedura për Vlerësimin e Dijeve në FGJM.</i>			
Konkluzione	Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë edhe procesin e ankimimit. Departamenti dhe stafi akademik duhet të sigurojë që studentët duhet të jenë të informuar për të gjitha hapat e procedurës së provimit dhe të ankesës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri e Burimeve Minerare i ofron studentëve njohuri shkencore themelore, dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje edhe me nivelin e ciklit të studimeve. Krahas njohurive teorike, programi synon mbi të gjitha aftësimin praktik të studentëve në mënyrë që atyre tu ofrohen perspektiva më të mira për përshtatjen në tregun e punës dhe mundësitë që të vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklin e dytë Master. GVJ shqyrtoi kurrikulën e këtij program dhe konstaton që ajo është e ngjashme me programe të tjera të këtij karakteri jashtë vendit. Bazuar në të gjitha këto GVJ vlerëson plotësimin e këtij kriteri. <i>Referenca:</i> <i>Ref 010 Rregullore e PS BSc në Inxhinieri e Burimeve Minerare</i> <i>Ref 011 Plani Mësimor i PS BSc në Inxhinieri e Burimeve Minerare</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e	Program i studimit siguron njohuri bazike në fushat e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit pasi në kurrikulën e tij përfshihen lëndë të tilla si Informatikë, Zbatime të Teknologjisë së Informacionit,

teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Modelim, vendburimesh dhe GIS, Etike komunikimi e prezantimi, Gjuhë e Huaj, CAD. <i>Referenca:</i> <i>Ref 011 Plani Mësimor i PS BSc në Inxhinieri e Burimeve Minerare</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen në përfundim të semestrit akademik. Pedagogët japin mendimin e tyre për përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe të përmbajtjes së lëndëve. Pedagogu i raporton këto në analizën e tij të punës mësimore, diskutohen në mbledhjet e departamentit ku prezantohen raportet e analizës mësimore të vitit akademik. <i>Referenca:</i> <i>Ref 048 Raporti i Analizës Mësimore DIBM</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Forma kryesore mësimore është mësimi teorik dhe praktik si leksione, seminare, ushtrime, punë laborator, praktikat profesionale, detyrat e kursit, projektet e kursit, etj dhe format e kontrollit të dijeve si mbrojtje detyrash/projekte kursi dhe raporte të punëve laboratorike, mbrojtje praktikash profesionale, provime të lëndës, provime formimi, etj. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash, të cilat janë të mirëpërcaktuara në programet lëndore. Studentët e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri e Burimeve Minerare kanë në dispozicion infrastrukturën e nevojshme dhe e përdorin atë për të zhvilluar njohuritë e marra në laboratorët, si dhe në praktikat profesionale. <i>Referenca:</i> <i>Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i> <i>Ref 011 Plani Mësimor i PS BSc në Inxhinieri e Burimeve Minerare</i> <i>Ref 023 Syllabuset e Lëndëve në PS BSc Inxhinieri e Burimeve Minerare</i>
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me	Në varësi të zhvillimeve të reja të shkencës së Inxhinierisë Minerare si dhe teknologjive inovative në këtë fushë, jashtë

kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	strukturës së programit të studimit janë organizuar nga personeli akademik i brendshëm, orë të hapura, seminare e workshope në lidhje me zhvillimet e shkencës dhe të Teknologjisë në fushën e Industrisë Minerare. <i>GVJ konstatoi se Leksioni i hapur/Seminar informues i fundit është mbajtur në vitin 2022.</i> <i>Referenca:</i> <i>Ref 078 Poster Workshop studentor ne FGJM</i> <i>Ref 079 Program Eorkshop studentor ne FGJM</i>			
Konkluzione	<i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që programi i studimit Bachelor në Inxhinieri e Burimeve Minerare, garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synon zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale tek ato.</i> <i>Rekomandohet që Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, të jetë me aktiv në realizimin e orëve dhe leksioneve të hapura si dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Provimi i formimit si dhe mbrojtja e diplomës në programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri e Burimeve Minerare" organizohet sipas Rregullores së brendshme të FGJM dhe dokumentit "Procedura e Konceptimi e Provimit Përfundimtar" ku përcaktohen kushtet për mënyrën e zhvillimit të provimit përfundimtar. Gjatë vizitës të grupit të punës GVJ konstatoi se procedura e formulimit dhe mbrojtjes të Punimit të Diplomës, në programet e ciklin të parë të studimeve (Bachelor) nuk del shumë e qartë nga dokumentat. Faktikisht është një student që punon në mbrojtjen e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit nuk përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.

	<i>Referenca:</i> <i>Ref 060 Procedura Konceptimi i provimit Perfundimtar</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Sipas raportit të brendshëm, nëse studenti/a e ka mesataren e ponderuar të notave ndërmjet 6.5 dhe 10.0 atëherë ai/a mund të zgjedhë që të zhvilloj lëndën e Projektit të Diplomimit. Këtë na i konfirmuan edhe pedagogët e departamentit gjatë vizitës tonë atje. Aktualisht me tezë diplome po punonte një student i këtij programi. Në dokumentat që referohen në raport, nuk gjetëm kriteret e sipërpërmendura. Procedura e konceptimi dhe mbrojtja e diplomës bachelor Ref 060 nuk i referohet diplomës por provimit përfundimtar. Gjithashtu materiali i referuar me nr 011 Manualin e përgatitjes së tezës së diplomës dhe kriteret e vlerësimit të tezës për studentët e ciklit të parë nuk i referohet këtij dokumenti. <i>Referenca:</i> <i>Ref 060 Procedura Konceptimi i provimit Perfundimtar</i> <i>Ref 006 Rregullore e Brendshme FGJM</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Procedura e provimit Përfundimtar/Mbrojtjes së Diplomës Pika 10 dhe 11, jep detaje të vlerësimit të provimit përfundimtar ose mbrojtjes së diplomës nga komisioni përkatës. Provimi ose punimi i tezës bazohet në testimin e njohurive që studenti ka marrë gjatë gjithë viteve të studimit. <i>Ref 060 Procedura Konceptimi provimit Perfundimtar</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orientojnë dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar.	GVJ gjatë vizitës së tij dy ditore në institucion, pati mundësinë të takoj një student i cili po punonte me tezën e diplomës së tij. Siç doli gjatë komunikimit tonë me të dhe me stafin akademik, por edhe referuar dokumentacionit u konstatua se: Çdo student në vitin e tretë të programit të studimit Bachelor në FGJM ka të drejtën e marrjes së një teme diplome, e cila ofrohet nga Departamenti që mbulon atë program studimi. Studenti e zhvillon punimin e diplomës nën drejtimin e një udhëheqësi i propozuar nga Departamenti dhe i miratuar nga Dekani i FGJM. Udhëheqësi i punimit të diplomës asiston në të gjitha fazat e kërkimit dhe garanton cilësinë e punimit. Ai



Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	firmos relacionin përkatës duke lejuar kështu, që punimi të paraqitet para komisionit të vlerësimit. <i>Referenca:</i> <i>Ref 060 Procedura Konceptimi i Provimit Perfundimtar</i>
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Njësia bazë përmes udhëheqësit të miratuar të temës së diplomës, asiston studentët në të gjitha nevojat që ato kanë për të përdorur infrastrukturën e institucionit si laboratorët, kompjuterat, bibliotekën si dhe shërbime të tjera për të cilat studenti ka nevojë. <i>Referenca:</i> <i>Ref 054 informacion laboratorct DIBM</i> <i>Neni 49, Ref 006 Rregullore e brendshme FGJM</i> <i>Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurikular dhe Mesimdhenies ne UPT.</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Provimi përfundimtar dhe punimi i diplomës, vlerësohen me notë, e cila është mesatare e vlerësimit që ka dhënë çdo anëtar i komisionit. <i>Referenca:</i> <i>Pika 1.1. Ref 060 Proccdura konceptimit e provimit Perfundimtar.</i> <i>Ref 080 Shembull Proces Verballi provim Përfundimtar FGJM.</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës (Shqip dhe anglisht), si dhe kopjen e plotë të programit të studimit. Diploma lëshohet nga Universiteti Politeknik i Tiranës deri gjashtë muaj pas përfundimit të studimeve. Deri në paisjen me diplomë të diplomantëve, universiteti lëshon një vërtetim për diplomën e fituar, të shoqëruar me fletën e notave. <i>Referenca:</i> <i>Ref 012 Forma e Regjistruar e Diplomes BSc në Inxhinieri e Burimeve Minerare.</i> <i>Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurikular dhe Mesimdhenies ne UPT- Neni 61.</i> <i>Ref 055 Modeli i Suplementit te diplomes BSc në Inxhinieri e Burimeve Minerare.</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione	GVJ nga vizita e kryer konstaton se të dhënat e studentëve si dhe rezultatet e tyre ruhen në sekretarinë mësimore. Institucioni ka një bazë të dhënash të plotë fizike dhe elektronike për të gjithë procesin mësimor. Gjatë vizitës në Sekretarinë Mësimore, GVJ u njoh me punën që kryhet për vlerësimin e lëndëve për periudhën e studimit,

për studentin nëse kërkohen.	numrin e matikulimit, rezultatet në hyrje dhe dalje për të gjithë studentët. Regjistri themeltar ishte i plotësuar me shkrim dhe pa korrigjime. Të dhënat e studentëve ruhen përgjithnjë dhe paraqiten sipas kërkesës së të interesuarve. <i>Referenca:</i> <i>Ref 006 Rregullore e Brendshme FGJM. (Neni 35 & 36)</i> <i>Ref 030 Modeli i regjistrave ne SM</i> <i>Ref 089 Rregullore e Sekretarise Mesimore</i>			
Konkluzione	<i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Universiteti ndjek një politikë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në PS.</i> <i>Në përfundim të studimeve studenti pajiset me diplomë dhe suplementin e diplomës si dhe kopjen e plotë të programit të studimit të kryer në gjuhën shqip dhe anglisht.</i> <i>Institucioni ka arkivën e plotë për të gjithë procesin mësimor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1 Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.																											
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																										
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e	Në programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri e Burimeve Minerare", gjatë tre viteve akademike janë angazhuar në mësimdhënie stafi akademik si më poshtë: <table border="1"> <thead> <tr> <th></th><th colspan="2">2021-2022</th><th colspan="2">2022-2023</th><th colspan="2">2023-2024</th></tr> <tr> <th></th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr</td><td>3</td><td></td><td>3</td><td></td><td>3</td><td></td></tr> </tbody> </table>							2021-2022		2022-2023		2023-2024			PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof. Dr	3		3		3	
	2021-2022		2022-2023		2023-2024																						
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																					
Prof. Dr	3		3		3																						

programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Prof.	2	2	2	2	
	Asoc.					
	Dr.	6		6	2	6
	MSc	1		1		1
	TOTAL	12	2	12	2	12
GVJ vëren që niveli i kualifikimit dhe fusha kërkimore-shkencore e personelit akademik të angazhuar, është në përputhje me specifikat e këtij programi studimi dhe lëndëve të zhvilluara nga ta. GVJ vlerëson që personeli akademik i angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri e Burimeve Minerare”, gjatë tre viteve akademike të fundit, ka kualifikimet dhe aftësinë për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore si edhe zotëron eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.						
<i>Referenca:</i> <i>Ref 024 CV e stafit akademik</i> <i>Ref 048 Raporti Analizës Mësimore DIBM</i> <i>Anekset: Tabela Permbledhese –Tabela 4</i>						
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Bazuar në RVB dhe në evidencat mbështetëse, GVJ vëren se ngarkesa mësimore e mbuluar nga personeli akademik efektiv për programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri e Burimeve Minerare”, për vitin akademik 2022 -2023 është 96% . Të njëjtat vlera janë edhe për vitin akademik 2021 -2022 dhe po aq ka qënë edhe parashikimi për vitin akademik 2023 -2024, çka është në përputhje me kornizën ligjore në fuqi (VKM Nr. 418, datë 10.05.2017) ku citohet: “Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për çdo program studimi”. Në evidencën (Ref 048 Raporti Analizës Mësimore DIBM) ku jepet “Informacion për ngarkesën mësimore të realizuar nga stafi akademik në v.a.2022-2023, të ndara sipas cikleve të studimit” konstatohet që: • Mbingarkesa mesatare e personelit akademik të departamentit është 80,39 orë dhe mbingarkesa maksimale e realizuar në department është 307 orë; • Ngarkesa e realizuar nga personeli akademik i ftuar në një program studimi është 338,8 orë dhe personelin akademik efektiv është 3883,5 orë;					

	• Numri mesatar i moduleve që mban një pedagog efektiv është 4, 07 module dhe numri maksimal i evidentuar në department është 8 module. Pak a shumë, ngarkesë e ngjashme ka qënë edhe në vitin akademik 2021-2022, ku shihet që: • Mbingarkesa mesatare e personelit akademik të departamentit është 179,72 orë dhe mbingarkesa maksimale e realizuar në department është 324 orë; • Ngarkesa e realizuar nga personeli akademik i ftuar në një program studimi është 328,3 orë dhe personelin akademik efektiv është 3086,5 orë; • Numri mesatar i moduleve që mban një pedagog efektiv është 4,69 module dhe numri maksimal i evidentuar në department është 7 module. Shifrat e lart-përmendura tregojnë për një mbingarkesë të stafit akademik të DIBM. <i>GVJ rekomandon që për përballimin e ngarkesës mësimore të programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri e Burimeve Minerare", Departamenti të rekrutojë staf akademik PAK, por gjithmonë në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</i> <i>Referenca:</i> <i>Ref 048 Raporti Analizës Mësimore DIBM</i> <i>Ref 056 Procedura e Punësimit të Personelit PAE në UPT</i> <i>Ref 057 Procedura e Punësimit të Personelit PAK në UPT</i> <i>Anekset: Tabela Permbledhese-Tabela 12</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	GVJ konstaton se institucioni ka lidhur kontrata të punësimit të personelit akademik efektiv dhe me kontratë në përputhje me aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi, në të cilat parashikohet mbulimi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Nga të dhënat e vëna në dispozicion në DVV vihet re një qëndrueshmëri e personelit akademik dhe ndihmës akademik ndër vite (asnjë ndryshim në PAE dhe vetëm 2 ndryshime në PAK). <i>Referenca:</i> <i>Ref 001 Statuti i UPT</i> <i>Ref 056 Procedura e Punësimit të Personelit PAE në UPT</i> <i>Ref 057 Procedura e Punësimit të Personelit PAK në UPT</i> <i>Ref 069 Praktikë punësimi staf akademik FGJM</i> <i>Anekset: Tabela Permbledhese-Tabela 4</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi,	GVJ konstaton se UPT ka një procedurë të qartë dhe transparente të rekrutimit dhe të vlerësimit, të mbështetur në kritere të përgjithshme, në përputhje me kërkesat ligjore dhe

mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	kritere specifike sipas nevojave të Departamenteve dhe programeve të studimit që ofron, duke garantuar përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën e programeve të studimit. Punësimi i personelit akademik dhe ndihmës akademik bëhet në përputhje me statutin e UPT. Gjithashtu UPT ka hartuar procedura të veçanta për rekrutimin e stafit akademik me kohë të plotë dhe të stafit akademik me kontratë. Departamenti në fillim të çdo viti akademik analizon nevojat dhe kërkesat për stafin akademik për mbulimin e lëndëve të ofruara në programin e studimit duke përpiluar një dokument të planit të ngarkesave. Pasi përcakton nevojën për staf, Përgjegjësi i departamentit ja përcjell Dekanit të FGJM numrin e vendeve të lira dhe kriteret për personel akademik me kohë të pjesshëm, në zbatim të rregullores përkatëse. Numri i vendeve vakante, së bashku me kriteret e nevojshme, bëhen publike në faqet web të FGJM dhe UPT si dhe afishohen në ambientet e FGJM. (http://upt.al/images/stories/punesim/Shpallje_fgjm_Karriera.pdf). Pasi një periudhë kohore 10-ditore kalendarike, kërkesat që kanë ardhur në përmbushje të thirrjes shqyrtohen nga një komision i përbërë nga pjesë përgjegjësi i departamentit, përgjegjës të sektorëve apo titullarë të lëndëve përkatëse. Ky komision shqyrton dosjet dhe përcakton fituesit sipas kriterëve të aplikimit. Lista me fituesit dërgohet tek njësia kryesore e cila e bën publike duke i shpall emrat fitues në faqen web të UPT [http://upt.al/images/stories/punesim/Fituesit_fgjm_Ndihmësakademik.pdf]. Kandidatët jo fitues kanë 3-ditë kalendarike kohë për tu ankimuar. Në rast ankesash, komisioni është i detyruar të kthejë përgjigje të shkruar për çdo person të interesuar, brenda 5-ditëve kalendarike. Pasi përmbyllet procedura e mësipërme dhe pas miratimit në dekanat, drejtuesi i njësisë qëndrore i dërgon Rektorit listën me emrat fitues së bashku me kontratat përkatëse për firmë. <i>Referenca:</i> <i>Ref 001 Statuti i UPT</i> <i>Ref 056 Procedura e Punësimit të Personelit PAE në UPT</i> <i>Ref 057 Procedura e Punësimit të Personelit PAK në UPT</i> <i>Ref 069 Praktikë punësimi staf akademik FGJM</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të	GVJ konstaton që FGJM dhe DIBM garantojnë angazhimin e stafit ndihmës akademik për realizimin korrekt të orëve laboratorike të parashikuara në programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri e Burimeve Minerare", si dhe mirëmbajtjen e

përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	ambjenteve dhe pajisjeve laboratorike përkatëse. Numri i personelit ndihmës akademik për DIBM ka qenë konstant (3-tre) përgjate tre viteve të fundit akademike. Mesatarisht, për çdo katër persona staf akademik, është një staf ndihmës akademik. <i>Referenca:</i> <i>Anekset: Tabela Permbledhese -Tabela 1</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	UPT përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit akademik dhe ndihmës akademik të angazhuar në programet e studimit që ofron. UPT në strukturën e vet organizative të tij ka miratuar Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Juridike. Kjo drejtori është përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore, çështjet juridike si dhe sektorin e protokollit dhe arkivës institucionale [http://upt.al/burimetnjerëzore]. UPT ka përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë sipas funksioneve, duke i pasqyruar në kontratën personale të punës. Bashkangjitur me kontratën është edhe përshkrimi i punës. Përgjegjësitë dhe funksionet për çdo pozicion parashikohen në Rregulloren e Brendshme FGJM e të DBM, si dhe në Statutin e UPT. Një dosje të plotë, për secilin prej anëtarëve akademik të brendshëm dhe personelit ndihmës dhe administrativ, mirëmbahet në Sektorin e BNJ me të dhëna që përditësohen prej vetë stafit akademik duke plotësuar në lidhje karrierën apo titujt e fituar në kohë. [Tabelat 1 & 2, Anekset]. <i>Referenca:</i> <i>Ref 001 Statuti i UPT.</i> <i>Ref 005 Organigrama e UPT</i> <i>Ref 006 Rregulloren e Brendshme e FGJM</i> <i>Ref 008 Rregulloren e Brendshme DIBM</i> <i>Ref 024 CV e stafit akademik</i> <i>Ref 044 Praktika e parashikimit të ngarkesës mësimore FGJM</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për	Në kuadër të zhvillimit të praktikave profesionale, Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me ente, të cilat zhvillojnë aktivitetin e tyre në drejtim të burimeve minerare. Këto institucione vënë në dispozicion të studentëve, personeli të kualifikuar për mbikëqyrjen e praktikës profesionale, i cili mbështet studentët në hartimin e raportit përfundimtar të praktikës dhe merr pjesë në procesin e vlerësimit të tyre. Praktikave profesionale me studentët e FGJM kryhen pranë subjekteve private e shtetërore sipas fushës së studimeve të

instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	studentit. Kjo është bërë e mundur falë marrëveshjeve që UPT dhe FGJM kanë me këto subjekte sikurse janë marrëveshjet me: - Ministrinë e Infrastruktura dhe Energji - Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) - Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të Shqipërisë; - Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit; - Autoriteti Shtetëror për Informacinin gjeohapësinor (ASIG); - Akademia e Shkencave të Shqipërisë; - Lufthansa Industry Solutions; - Albpetrol; - Bankers Petroleum Albania; - Deloitte; - Gjeo Vjosa - Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore - Shërbimi Gjeologjik Shqiptar etj. Një element i rëndësishëm i koordinuar në kuadrin e praktikave profesionale është angazhimi në drejtimin e tyre të stafit më të ri akademik të DIBM, stafit ndihmës akademik si dhe ish studentët e diplomuar në programet e studimit; Bachelor, Master Shkencor dhe Master Profesional të ofruara nga DIBM të cilët punojnë në profesion. Ky kombinim ka rezultuar shumë sinjifikativ në drejtim të motivimit, njohjes së terrenit si edhe për një punësim të mundshëm në keto kompani. <i>Referenca:</i> <i>Ref 051 Marrëveshjet me industrinë dhe institucione</i>
Konkluzione	<i>GVJ gjykon se personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush në përgjithësi standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</i> <i>GVJ konstaton se plotësohet kërkesa e pikës 4 të nenit 25 të Ligjit Nr. 80/2025 ku përcaktohet se: Departamenti ka në përbërje të tij të paktën shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, nga të cilët të paktën tre me grada shkencore ose tituj akademikë. Departamenti ka në përbërje dhe personel ndihmës akademik.</i> <i>Nisur nga mbingarkesa e stafit akademik të DIBM, GVJ rekomandon që për përballimin e ngarkesës mësimore të programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri e Burimeve Minerare", në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, Departamenti të rekrutojë staf akademik PAK,</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV dhe pjesërisht nga vizita në Institucion, vërehet që Institucioni ka mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave ka në përdorim sipërfaqen prej 7481 m². Mësimdhënia në FGJM realizohet në dy godina: godina e re me sipërfaqe 2678 m² dhe godina e vjetër me sipërfaqe 4803 m². Mjediset në përdorim nga FGJM janë si në vijim. ▪ 12 salla leksionesh me një sipërfaqe totale prej 853 m². ▪ 21 salla seminaresh me sipërfaqe totale prej 896 m². ▪ 1 sallë për veprimtari promovuese me sipërfaqe 117 m². ▪ 24 laboratorë për lëndë të ndryshme ▪ 1 laborator informatike, në total 1080m². FGJM zotëron një laborator informatike me sipërfaqe 50.23 m². ▪ 24 mjedise të hapsirës së përbashkët me sipërfaqe 2638 m². ▪ 1199 m² për stafin akademik. Numri total i studentëve aktivë në FGJM për vitin akademik 2023 - 2024 është 1570. Raporti i sipërfaqes m²/student në mjediset e dy godinave është 4.7 m²/student. Sipas legjislacionit në fuqi, normativa e përcaktuar për IAL e profileve inxhinierike është 5 m²/studentë. Duke marrë në konsideratë pjesën proporcionale të ambienteve në përdorim në nivel institucioni siç janë Biblioteka Shkencore me sipërfaqe 1587 m² dhe IGJEO (Instituti i Gjeoshkencave) me sipërfaqe 2329 m², në funksion të FGJM në këto dy godina janë 575.32 m² duke e bërë sipërfaqen totale që përdoret nga FGJM në nivel institucioni të barabartë me 7653.78 m², që i korrespondon raporti 5.08 m²/student. Duhet theksuar së për shkak të rikonstruksionit të godinës historike, GVJ e pati të pamundur të vizitonte disa nga laboratorët dhe në formulimin e shkallës së plotësimit të këtij kriteri, jemi bazuar kryesisht në raportin e RVB.

	<i>Referenca:</i> <i>Ref 070 Relacion për infrastrukturën e FGJM</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Disa nga klasat e leksioneve janë të pajisura me videoprojektorë fiks në mur si dhe burime të shumëfishta të furnizimit me energji elektrike dhe lidhje me kabëll për internetin. Gjithashtu FGJM ka në përdorim disa mjedise laboratorike që i shërbejnë procesit mësimor po edhe atij kërkimor-shkencor. Sipas DVV, FGJM ka në dispozicion 24 laboratorë për lëndë të ndryshme dhe 1 laborator informatike me sipërfaqe 50.23 m². <i>Por për shkak të rikonstruksionit të godinës historike, GVJ e pati të pamundur të vizitonte shumicën e laboratorëve dhe në formulimin e shkallës së plotësimit të këtij kriteri, jemi bazuar kryesisht në raportin e GVB.</i> <i>GVJ rekomandon pajisjen e mjediseve të mësimit me kompjutera dhe projektorë për një mësimdhënie në nivelet bashkëkohore në përdorimin e mjeteve audiovizive dhe të IT.</i> <i>Referenca:</i> <i>Ref 054 Informacion laboratorët DIBM</i> <i>Ref 070 Relacion për infrastrukturën e FGJM</i> <i>Ref 100 Leje e ndërtimit për rikonstruksionin e FGJM</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Nisur nga natyra e IAL-së që është e orientuar drejt studimeve inxhinierike dhe zhvillimeve teknologjike, në UPT operojnë 88 laboratore specifike sipas moduleve dhe 12 laboratorë për Teknologjinë e Informacionit. Nga këto laboratorë, FGJM përdor 24 laboratorë. Këta laboratorë përdoren për të zhvilluar praktikën nga studentët por janë në dispozicion edhe për kërkime shkencore nga stafi akademik. <i>Për shkak të rikonstruksionit të godinës historike, GVJ e pati të pamundur të vizitonte shumicën e laboratorëve dhe në formulimin e shkallës së plotësimit të këtij kriteri, jemi bazuar kryesisht në raportin e GVB.</i> <i>Referenca:</i> <i>Ref 054 Informacion laboratorët DIBM</i> <i>Ref 070 Relacion për infrastrukturën e FGJM</i> <i>Ref 072 Evidenca mbi laboratorët në UPT.pdf</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur	Sikurse u theksua më lart, për vetë natyrën e tij të orientuar drejt teknologjisë së nxjerrjes dhe përpunimit të burimeve minerare, shkencave të mjedisit dhe gjeomatikës, përgjatë viteve në Institucion, janë bërë përpjekje për ngritjen dhe pasurimin e laboratorëve të teknologjisë së informacionit në

me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	tërësinë e mjediseve të tij. Çdo laborator dhe sallë informatike (pajisje Komjuterike) është e pajisur me hapësirën e nevojshme për zhvillimin normal të leksioneve/seminareve. Lëndët e Teknologjisë së Informacionit si p.sh informatika bazë apo gjuhët e programimit, mbahen nga personel që vijnë nga Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, i cili ka në dispozicion 7 laboratorë modern dhe të pajisur me programe profesionale (gjuhët C, C++, Java, Python, Sinjalet, Rrjetat, Sistemet elektronike etj.). Nga vizita në Institucion, GVJ vëren se laboratori i teknologjisë së informacionit që FGJM zotëron është funksional dhe i pajisur me programe profesionale në përputhje me natyrën e programit të studimit. <i>Referenca:</i> <i>Ref 054 Informacion laboratorët DIBM</i>			
Konkluzione	FGJM ka në dispozicion ambiente me pajisjet e nevojshme për realizimin e objektivave mësimore të programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri e Burimeve Minerare", duke mundësuar realizimin e procesit mësimor teorik dhe praktik përmes përdorimit të metodave bashkëkohore të mësimdhënies. Në përgjithësi infrastruktura mësimore është efektive, por për shkak të rikonstruksionit të godinës kryesore, GVJ e pati të pamundur të vizitonte një pjesë të laboratorëve. GVJ mendon se ka akoma hapësira për përmirësim në përputhje me standardet bashkëkohore në mjetet didaktike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.3	
IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Universiteti Politeknik i Tiranës ka në dispozicion një bibliotekë shkencore qendrore për studentët e tij. Kjo bibliotekë ofron 65570 tituj dhe 75 vende leximi. Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave ka gjithashtu një bibliotekë të vetën të pajisur me afro 116 tituj dhe 45 poste leximi/konsultimi. Kjo bibliotekë, ndryshe nga biblioteka qendrore, vihet në dispozicion vetëm për studentët dhe stafin e FGJM. Mund të thuhet se do ishte një ndihmesë shumë e vyer që ky fakultet të kishte në dispozicion një ambient të përshtatshëm, komod dhe modern për bibliotekën e fakultetit.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	Mjediset e saj mund të shërbejnë edhe si salla leximi apo studimi individual të studentëve, duke mundësuar kushte studimi optimale, etj. <i>Në takimin që GVJ zhvilloi me punonjës së bibliotekës së FGJM, u pohua se kjo bibliotekë nuk ka sistem online për bibliotekë digjitale. Ashtu si në rastin e laboratorëve, për shkak të rikonstruksionit të ndërtesës kryesore, GVJ nuk pati mundësi të shikonte bibliotekën e këtij fakulteti.</i> <i>Referenca:</i> <i>Ref 074 Informacion mbi Bibliotekat në UPT</i> <i>Ref 075 Biblioteka digjitale</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Biblioteka qendrore është e pajisur me një literature të pasur Shqiptare dhe të huaj. Biblioteka përmban tituj për fusha të ndryshme studimi dhe kjo i vjen në ndihmë studentëve të cilët kanë lëndë të ndërvarura nga fakultete të tjera. Studenti i “Inxhinierisë së Burimeve Minerare” mund të konsultojë tekste të cilët janë në dispozicion të fakulteteve të tjerë, pjesë e UPT. Ndërsa për literaturën specifike shfrytëzohet kryesisht biblioteka e FGJM. Kjo bibliotekë, bazuar në kërkesat e departamentit, bën edhe përditësime të nevojshme të fondit të librave. <i>Referenca:</i> <i>Ref 074 Informacion mbi Bibliotekat në UPT</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Biblioteka shkencore qendrore është në dispozicion të studentëve dhe të stafit akademik nëpërmjet infrastrukturës së saj, ajo zbaton orare efektive për studentët. Praktikisht, oraret e bibliotekës pasqyrojnë dhe në kushte normale edhe tejkalojnë, oraret e zakonshme të mësimdhënies në auditor. Gjatë vizitës që GVJ realizoi në mjediset e FGJM, u vërejt që për shkak të rikonstruksionit të godinës së fakultetit, biblioteka e Fakultetit nuk ishte funksionale. <i>Referenca</i> <i>Ref 074 Informacion mbi Bibliotekat në UPT</i> <i>Ref 103 Rregullore e Bibliotekës Shkencore</i> <i>GVJ gjykon se rikonstruksioni i Bibliotekës së fakultetit që është në vijim, do të rrisë dukshëm standardet e shfrytëzimit të literaturës fizike dhe dixhitale nga studentët dhe stafi akademik.</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me	Ndër vite, biblioteka qendrore e UPT ka akumuluar dhe sot është e pajisur me një fond fizik, si: tekste mësimore bazë,

fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.	literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, që i kalon 65000 tituj. Kjo literaturë është e mjaftueshme për mbulimin e të gjitha moduleve, por sidomos kjo i vjen në ndihmë studentëve të cilët kanë lëndë të integruara, të ofruara nga fakultete të tjera. Për module më specifike, studentët mund ti drejtohen bibliotekës së FGJM, e cila po ashtu është e pasur me një fond fizik prej më shumë se 116 titujsh. <i>Referenca:</i> <i>Ref 074 Informacion mbi Bibliotekat në UPT</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Biblioteka Shkencore Qendrore, e pozicionuar pranë UPT-së, ka pjesë përbërëse të strukturës së saj: Bibliotekën e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit (BFIN), Bibliotekën e Fakultetit Gjeologji Miniera (BFGJM), si dhe Bibliotekën e Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Fizike (BFIM&IF), të cilat funksionojnë si degë të saj. Në bibliotekën mësimore të FGJM vihen në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik të programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri e Burimeve Minerare", në format fizik dhe elektronik pa pagesë, literaturë bazë dhe ndihmëse, të cilat garantojnë marrjen e njohurive të parashikuara në programin e studimit. <i>Referenca:</i> <i>Raporti i GVB</i> <i>Ref 074 Informacion mbi Bibliotekat në UPT</i> <i>Ref 075 Biblioteka digjitale</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka qendrore ofron lidhjen me internetin me kabëll ose edhe wireless, për të mundësuar që studentët të shfrytëzojnë katalogët on-line apo bibliotekat on-line. <i>GVJ sugjeron vënien në dispozicion të studentëve të një numri më të mjaftueshëm kompjuterash për të punuar dhe informuar.</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të	Biblioteka shkencore zbaton këto orare: e Hënë - e Premte 8.00-16.00. Praktikisht oraret e bibliotekës janë hapur në kushte normale edhe tejkalojnë oraret zyrtare. <i>Referenca:</i> <i>Ref 074 Informacion mbi Bibliotekat në UPT</i> <i>Ref 103 Rregullore e Bibliotekës Shkencore</i>

nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.				
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	GVJ konstaton se UPT ka hartuar dhe zbaton një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës dhe përditësimin e fondit ekzistues në përputhje me nevojat e programeve të studimit, si dhe analizon vazhdimisht shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe atij online nga personeli akademik dhe studentët duke marrë masa në funksion të saj. <i>Referenca:</i> Ref 073 Pasurimi i koleksionit të Bibliotekës Shkencore 2021-2024 Ref 074 Informacion mbi Bibliotekat në UPT Ref 106 Praktikë mbi hartimin e Buxhetit në nivel njësie kryesore - bazë			
Konkluzione	<i>Biblioteka Shkencore Qendrore e UPT-së, ka pjesë përbërëse të strukturës së saj: Bibliotekën e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit (BFIN), Bibliotekën e Fakultetit Gjeologji Miniera (BFGJM), si dhe Bibliotekën e Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Fizike (BFIM&IF), të cilat funksionojnë si degë të saj.</i> <i>Në bibliotekat shkencore dhe mësimore të UPT dhe atë të FGJM vihen në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik të programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri e Burimeve Minerare", në format fizik dhe elektronik pa pagesë, literaturë bazë dhe ndihmëse, në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Në zbatim të ligjit Nr. 80/2015 “per Arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë” neni 101, Njësitë kryesore të UPT mbajnë në formë të shkruar: - Regjistrin themeltar të studentëve, - Regjistrin e arritjeve akademike ku hyn dhe proces-verbali i çdo provimi apo detyrimi tjetër akademik, - Regjistri i lëshimit të diplomave dhe çertifikatave. Detyrat dhe organizimin e punës së Sekretarisë Mësimore i ka të specifikuar qartë Rregullorja e Brendshme e Fakultetit të Gjeologjisë dhe të Minierave. Sekretaritë mësimore të fakulteteve i plotësojnë këto tre regjistra në formë fizike dhe elektronike. Në to disponohen baza e të dhënave, që përmban informacion mbi studentët të tilla, si: gjeneralitetet, datëlindja, programi i studimit që ndjekin, viti i studimit, shkolla e mesme nga kanë ardhur, notat e fituara përgjatë ciklit të studimeve, kontaktet, datën e regjistrimit në universitet, datë çrregjistrimi dhe transferimi (për ata që ndërpresin studimet ose që transferohen nga IAL të tjera), datën e diplomimit etj. Këtë bazë të dhënash e plotësojnë, përditësojnë dhe e disponojnë sekretaritë mësimore të secilit Fakultet dhe Sektori i IT dhe e vënë në dispozicion të organeve drejtuese me kërkesë të tyre. Sistemi i menaxhimit informatik BIT ALBANIA përdoret nga FGJM për këto qëllime. <i>Referenca:</i> <i>Ref 006 Rregullore e brendshme FGJM</i> <i>Ref 030 - Modeli i Regjistrave</i> <i>Ref 043 Manual përdorimi platforma Sekretarisë Mësimore BIT-ALBANIA</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	UPT dhe FGJM përmes sistemit të brendshëm të menaxhimit administrojnë të dhënat jo vetëm për studentët e tij, por edhe për stafin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. Referuar Organigramës së Universitetit Politeknik të Tiranës, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Juridike është përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore. Sektori i Burimeve Njerëzore, si pjesë e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore është përgjegjës për përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programin e studimit. GVJ konstaton se UPT ka përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë për çdo punonjës, sipas funksioneve, duke i përcaktuar dhe në kontratën individuale të punës. Bashkëlidhur me kontratën gjenden dhe përshkrimet e punës për secilin. Përgjegjësitë për

	çdo funksion janë të përcaktuara në rregulloren e FGJM dhe departamenteve si dhe në Statutin dhe Rregulloren e UPT. Specialisti i Zyrës së Burimeve Njerëzore është përgjegjës për menaxhimin e dokumentacionit personal të punonjësve dhe bazuar në ligjin për “Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe Akteve të tjera nënligjore plotëson regjistrin themeltar. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, dokumentacioni i njësisë bazë (departamentit) dhe dokumentacioni i stafit akademik që lidhen me procesin mësimor dhe administrativ, ruhet dhe administrohet nga Sekretaria e dekanit të FGJM-së. Të gjitha veprimtaritë e tjera që lidhen me funksionimin administrativ të departamentit dhe të procesit mësimor si plotësimi dhe nënshkrimi për realizimin e ngarkesës mësimore të anëtarëve të departamentit, miratimi i planeve mësimore kalendarike, miratimi i tezave të provimeve, organizimi i aktivitete të ndryshme shkencore, etj., menaxhohen nga Përgjegjësi i departamentit. <i>Referenca:</i> <i>Ref 005 Organigrama e UPT</i> <i>Ref 006 Rregullore e Brendshme e FGJM</i> <i>Ref 008 Rregullore e Brendshme DIBM</i> <i>Ref 043 Manual përdorimi platforma Sekretarisë Mësimore BIT-ALBANIA</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Referuar raportit të GVB dhe dokumentacionit të paraqitur në DVV vërehet që UPT disponon platformën BIT ALBANIA, përmes të cilës administrohet të dhënat e studentëve, stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. Përdoruesit, pasi u jepet një llogari (<i>user name</i>) dhe një fjalëkalim fillestar (Password) kanë mundësinë që të menaxhojnë në mënyrë të pavarur llogarinë e tyre. Në këtë mënyrë, i gjithë personeli akademik, personeli ndihmës-akademik si edhe studentët sigurojnë akses të dedikuar në informacione dhe dokumente <i>Referenca:</i> <i>Ref 043 Manual përdorimi platforma Sekretarisë Mësimore BIT-ALBANIA</i> <i>Ref 089 Rregullore Sekretarise Mësimore FGJM</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit	GVJ vëren që strukturat përbërëse të FGJM përdorin BIT-ALBANIA, një sistem menaxhimi modular. Ky sistem është i llojit pasiv dhe nuk krijon interaktivitet. Sistemi përdoret nga pedagogët (për plotësimin e detyrimeve të studentëve), nga sekretaria mësimore (për të nxjerrë të dhëna sipas kërkesës,

interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	kontrolluar historinë e studentit) si edhe nga studentët (për të bërë regjistrimin për pjesëmarrjen në provime, për plotësimin e pyetësorëve, anketave, etj). Në mungesë të një sistemi interaktiv, FGJM ka përdorur platformën Google Classroom e cila është pa pagesë dhe siguron një lloj interaktiviteti. <i>Referenca:</i> <i>Ref 043 Manual përdorimi platforma Sekretarisë Mësimore BIT-ALBANIA</i> <i>Ref 068 Shembull klase virtuale në platformën Google Classroom</i>
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. Sistemi informatik BIT ALBANIA i FGJM mund të garantojë monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ. Pedagogu mund të mbajë një regjistër frekuentimi javor të studentëve, i cili mund të kontrollohet në kohë reale nga sekretaria apo titullarët e institucionit. <i>Referenca:</i> <i>Ref 043 Manual përdorimi platforma Sekretarisë Mësimore BIT-ALBANIA</i>
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	UPT dhe FGJM disponon një faqe web në dy gjuhë: shqip dhe anglisht. Në web publikohet çdo informacion i mundshëm mbi institucionin, informacion mbi organizimin akademik dhe administrativ, informacion mbi fakultetet, ciklet e studimit, programet e studimit dhe stafin akademik për çdo njësi, informacion mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore, programet e shkëmbimeve studentore Erasmus+, aktivitetet e ndryshme dhe të shumta që zhvillohen në UPT përgjatë gjithë vitit, si dhe shërbimet e ofruara për studentët (https://www.upt.al/fakultete-dhe-institute) dhe (https://FGJM.edu.al/info/bachelor)
Konkluzione	<i>UPT disponon platformën BIT ALBANIA, përmes të cilës administron të dhënat e studentëve, stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ.</i> Sistemi i menaxhimit i përdorur nga FGJM garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. Duhet theksuar që ky sistem është i llojit pasiv dhe nuk krijon interaktivitet. <i>UPT disponon një faqe web-i në dy gjuhë: shqip dhe anglisht. Në web publikohet çdo informacion i mundshëm mbi institucionin.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	UPT harton raporte financiare, që përmbajnë një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera. Bazuar në organigramën e Institucionit, Administratori është autoriteti përgjegjës për menaxhimin në nivel institucioni ndërsa përgjegjësia për menaxhimin financiar në nivelin e njësisë kryesore (fakultetit) i takon administratorëve përkatës të këtyre njësive. Tjetër përgjegjësi e Administratorit të Institucionit është përgatitja në mënyrë periodike e raportit financiar të institucionit. Ky raport financiar i cili paraqitet për miratim si pjesë e raportit vjetor pranë Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit, përpos të tjerave paraqet edhe kostot financiare mesatare për student në nivel universiteti. Si rregull, në fund të çdo viti akademik, Institucioni, nëpërmjet këtyre strukturave, bën edhe planifikimin e buxhetit për çdo vit pasardhës dhe njëkohësisht harton buxhetin afat mesëm. Ky buxhet afat-mesëm mbulon një periudhë tre vjeçare, çka jep mundësinë për një plan mbështetjeje financiare për të paktën një cikël të plotë studimi. <i>Referenca:</i> <i>Ref 005 Organigrama e UPT</i> <i>Ref 099 Projekt Buxheti Afatmesëm 2021-2023</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse	GVJ vëren se në përputhje me strategjinë e institucionit, FGJM ka hartuar dhe aprovuar Planin e tij Strategjik i cili është pjesë planit strategjik të UPT. Në planin strategjik të FGJM bëhet një analizë e gjendjes aktuale dhe asaj strategjike. Nisur nga gjendja aktuale, bëhet edhe një planifikim afatshkurtër dhe një planifikim afatgjatë. Në raportin e GVB, theksohet që “Universiteti Politeknik i Tiranës nuk harton një plan financiar të dedikuar një programi studimi specifik, por ky plan vjen si pjesë integrale e planit financiar të njësisë kryesore”. Referuar GVB, financimi i burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit të

të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	studimit Bachelor në “Inxhinieri e Burimeve Minerare” është pjesë e planit strategjik të FGJM. Përpos të tjerave ky plan përmban, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e fondit ekzistues, aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, etc., në funksion të realizimit të programit të studimit. Pjesë e planit strategjik është edhe mbështetja që Institucioni i jep stafit akademik në ngritjen e tyre profesionale. Kjo mbështetje ka konsistuar suportin financiar për pjesëmarrjet e tyre në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare apo në lidhje të marrëveshjeve bashkëpunimi me universitete të tjera ndërkombëtare. <i>Referenca:</i> <i>Ref 002 Plani Strategjik UPT 2019-2024</i> <i>Ref 007 Plani Strategjik FGJM 2019-2024</i> <i>Ref 009 Plani Strategjik i DIBM 2019-2024</i> <i>Ref 106 Praktikë mbi hartimin e Buxhetit në nivel njësie kryesore – bazë</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	GVJ vëren se në zbatim dhe në përputhje me përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 114/2015 “Për auditin e brendshëm në sektorin publik” dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, UPT i nënshtrohet çdo vit një auditimi të brendshëm, të kryer nga njësia e auditimit të brendshëm dhe të drejtuar nga Bordi i Administrimit. Gjatë këtij auditimi periodik, Institucioni vlerëson gjendjen financiare dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti i përgatitur mbi bazën e auditimit financiar i prezantohet Senatit Akademik dhe miratohet nga ana e Bordit të Administrimit. Ky raport publikohet çdo vit dhe është i aksesueshëm nga publiku përmes programit të transparencës në website të UPT [https://upt.edu.al/legjislacioni/programi-i-transparences] <i>Referenca:</i> <i>Ref 001 Statuti i UPT.</i> <i>Ref 005 Organigrama e UPT</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Nisur nga dokumentacioni i vënë në dispozicion në DVV, GVJ vlerëson se Institucioni raporton mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës deri në njësinë kryesore dhe njësinë bazë përgjegjëse për programin e studimit. <i>Referenca:</i> <i>Ref 099 Projekt Buxheti Afatmesëm 2021-2023</i>

Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	Nisur nga dokumentacioni i vënë në dispozicion në DVV dhe takimet në Institucion, GVJ vlerëson se Institucioni dëshmon qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e programit të studimit dhe kapacitete financiare të mjaftueshme për gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme për vijueshmërinë e tij në të ardhmen. Menaxhimi i burimeve financiare dhe analiza e treguesve të zbatimit të politikave financiare në UPT bëhet përmes Drejtorisë Ekonomike. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të GVJ-së, shikohet që dy janë burimet e të ardhurave: 1. Të ardhurat nga buxheti i shtetit që zënë mesatarisht rreth 66% e të ardhurave. 2. Të ardhurat që gjenerohen prej UPT që zënë rreth 34% të të ardhurave. Në të ardhurat që vetë UPT gjeneron, 53% burojnë nga tarifa e shkollimit. Nga të ardhurat që gjenerohen nga Institucioni, një pjesë e mirë vijnë nga ekspertizat ose oponencat që realizon personeli akademik i Departamentit. Ekspertizat mund të jenë të lidhura me planifikimin e territorit, projektimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, ndërsa oponenca teknike janë realizuar për projektet e veprave të ndërtimit, analiza inxhinierike dhe laboratorike, etj. Duhet theksuar që buxheti vjetor i UPT ka pësuar rritje të vazhdueshme me 8-10 % në vit gjatë viteve të fundit. <i>Referenca:</i> <i>Ref 086 Lista e stafit Akademik me licenca profesionale për shërbimet ndaj të tretëve</i> <i>Ref 100 Tabela e të ardhurave dhe investimeve 2021-2023</i>			
Konkluzione	<i>UPT dëshmon qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e programit të studimit dhe kapacitete financiare të mjaftueshme për gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme për vijueshmërinë e tij në të ardhmen. Mund të bëhet akoma më shumë për thithje fondesh për infrastrukturën nga projektet.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Nga shqyrtimi i evidencave të depozituara konstatohet se UPT, në përbërje të të cilit bëjnë pjesë FGJM dhe DIBM, kanë miratuar akte normative dhe rregullatore, si dhe kanë zbatuar procedura përmes të cilëve mbulohet e dispijnuohet i gjithë cikli i studimeve të plotë të cikleve të studimit që ndjekin studentët. Ato janë hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë dhe aktet e tjera normative në zbatim të tyre. Ndër kryesorët: - Në nivel Universiteti ▪ “Plani Strategjik i UPT 2019-2024”; ▪ “Statuti UPT”, Kreu V dhe VI; ▪ “Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT” - Në nivel Fakulteti e departamenti ▪ Plani Strategjik FGJM 2020-2024 ▪ Planet Strategjike të Departamenteve në FGJM; ▪ Rregullore e Brendshme e FGJM; ▪ Rregullore e brendshme e DIBM; ▪ Rregullorja e programit të studimit. Për procesin mësimor në FGJM janë hartuar dhe zbatohen një sërë procedurash. Gjithashtu në UPT dhe FGJM janë ngritur dhe funksionojnë struktura të veçanta të cilat kanë për detyrë kontrollin dhe zbatimin e rregulloreve dhe procedurave të mësipërme, si: Drejtoria e Kurrikulave, Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit, Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. <i>Referenca:</i> <i>Ref 001 Statuti i UPT.</i> <i>Ref 002 Plani Strategjik i UPT 2019-2024</i> <i>Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i> <i>Ref 005 Organigrama e UPT</i> <i>Ref 006 Rregullore e Brendshme e FGJM</i> <i>Ref 007 Plani Strategjik FGJM 2020-2024</i> <i>Ref 008 Rregullore e Brendshme DIBM</i> <i>Ref 009 Plani Strategjik i FGJM 2019-2024</i> <i>Ref 010 Rregullore e PS BSc në DIBM</i>

	<i>Ref 015 Organigrama e FGJM</i> <i>Ref 041 Procedura për Vlerësimin e Dijeve në FGJM</i> <i>Ref 060 Procedura Konceptimit e provimit përfundimtar</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Referuar Rregullores së programit të studimit BSc në “Inxhinieri e Burimeve Minerare”, neni 11 dhe neni 13 i saj, regjistrimet në këtë program bëhen në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në vend. Në këtë program studimi kanë të drejtë të regjistrohen shtetas shqiptarë ose të huaj. GVJ konstaton se në të gjithë bazën rregullatore të paraqitur në DVV, Kandidatët për studentë dhe studentët që ndjekin jo vetëm këtë program studimi por edhe programet e tjera që ofrohen në UPT, kanë të drejta të barabarta në ndjekjen dhe frekuentimin e programeve të studimit që ofrohen në këtë institucion. Sipas RVB, kriteret e pranimi janë të përgjithshme dhe të zbatueshme për çdo kandidat që aplikon për programin e studimit BSc në ‘Inxhinieri e Burimeve Minerare’. Kriteret vendosen mbështetur në një analizë të kushteve konkrete në të cilat veprohet, duke synuar të tërhiqen kandidatët me rezultate më të larta. Kriteret propozohen nga Departamenti i Inxhinierisë së Burimeve Minerare dhe pasi shqyrtohen, miratohen në Dekanatin e Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave dhe në Senatin akademik të UPT. <i>Referenca</i> <i>Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i> <i>Ref 026 Praktika e miratimit të kuotave të pranimi në FGJM</i> <i>Ref 027 Praktika e miratimit të kriterëve të pranimi në FGJM</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Referuar Rregullores së programit të studimit BSc në “Inxhinieri e Burimeve Minerare”, neni 9, ky program studimi ka si kriter kryesor pranimi Maturën Shtetërore, si dhe të gjitha përcaktimet në Ligjin e Arsimit të Lartë dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Sipas nenit 13 të kësaj Rregulloreje, në këtë program studimi kanë të drejtë të regjistrohen shtetas shqiptarë dhe të huaj. Shtetasit e huaj duhet të përmbushin të gjitha detyrimet/kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni përkatës i Republikës së Shqipërisë si dhe detyrimet që janë të përcaktuara në Rregulloren e Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave dhe Rregulloren e UPT. <i>Referenca:</i> <i>Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i>

	<i>Ref 010 Rregullore e PS BSc në Inxhinieri e Burimeve Minerare</i> <i>Ref 027 Praktika e miratimit të kriterëve të pranimit në FGJM</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	GVJ konstaton se njësia kryesore dhe njësia bazë në të cilën ofrohet programi i studimit, ka një bazë rregullatore në të cilën janë të përcaktuara qartë, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve (III. Pranimi i kandidatëve; neni 9 i Rregullores së PS); vlerësim i dijeve dhe masa e frekuentimit të programit (IV. Zhvillimi i aktiviteteve, neni 16,17,18 i Rregullores së PS); kushtet e mbrojtjes diplomës dhe provimit të formimit (V. Mbrojta e diplomës/provimi i formimit, neni 19). Për sa i përket transferimit të studimeve apo njohjes së studimeve të mëparshme, referuar Rregullores së Zhvillimit Kurrikular dhe mësimdhënies në UPT, kuotat për transferimin e studentëve dhe programe të dyta studimi nga brenda UPT apo edhe nga Institucione të tjera të arsimit të lartë në vend, përbëhen nga kuotat e paplotësuara nga regjistrimet e vitit të mëparshëm dhe kapacitetet që mund të krijohen, si rezultat i çregjistrimit të studentëve gjatë vitit akademik. Transferimet dhe programet e dyta të studimeve pranohen në fillim të çdo viti akademik, jo më vonë se fundi i javës së dytë të semestrit të parë. Transferimet nga cikli i parë pranohen në përputhje me Udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Të gjitha kriteret dhe procedura janë transparente dhe të aksesueshme nga studentët në faqet web të UPT dhe FGJM. <i>Referenca:</i> <i>Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i> <i>Ref 025 Guida Studentore</i> <i>Ref 041 Procedura për vlerësimin e dijeve në FGJM</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	GVJ, gjatë vizitës në Institucion, ju bë me dije se Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave, përpara fillimit të çdo viti akademik, nëpërmjet Zyrës së këshillimit të karrierës organizon takime informuese me maturantët, duke ju komunikuar atyre kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për çdo program studimi që ofron, me qëllimin e mirë informimit të çdo maturanti i cili dëshiron të jetë kandidat për student në një program të caktuar studimi. Në DVV, GVB ka paraqitur dokumentacion mbi aktivitetet informuese të zhvilluara nga Institucioni për të interesuarit që duan të ndjekin program studimi që ofrohet në UPT.

	Duke shfletuar këto materiale, konstatohet se synimi i institucionit është që nëpërmjet këtyre aktiviteteve të bëjë të ditur - Programet e studimit që ofron - Kriteret e pranimit - Mundësitë për marrje burse - Mundësitë për mobilitet në kuadër të projekteve të ndryshme <i>Referenca:</i> Ref 033 Aktivitete informuese mbi programet e studimit Ref 034 Aktivitete të organizuara nga Zyra e Karrierës Ref 037 Flete palosje informuese FGJM
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Sipas evidencave (Ref. 026 - <i>Praktika e miratimit të kuotave të pranimit</i>) konstatohet se Fakulteti i Gjeologji Minerave për vitin akademik 2024-2025, ka parashikuar kuota për kandidatët për student me statusin jetim dhe për studentët e pakicave dhe shtresave të marginalizuara (rome dhe ballkano egjiptianë). Nuk ka parashikuar kuota për personat me aftësi të kufizuar.
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Referuar DVV dhe dokumentacionit të paraqitur nga Institucioni në kuadër të plotësimit të këtij kriteri, vërehet se nuk ka ndonjë politikë apo ndonjë kriter të veçantë për pranimin e kandidatëve me aftësi të veçantë, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. Propozimi për kuotat e pranimit për ciklin e parë dhe të dytë të studimit, vjen në mënyrë shkresore nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Pas njohjes me këtë shkresë, Rektori i UPT i kërkon Njësitë kryesore propozimet për kuotat për çdo vit akademik. Pasi merren nga çdo njësi propozimet e kuotave, bëhet miratimi i tyre në Senatin akademik të UPT dhe në Bordin e Administrimit të UPT dhe këto vendime përcillen në MAS. Sipas evidencave (Ref. 026) konstatohet se Fakulteti i Gjeologji Minerave për vitin akademik 2024-2025, ka parashikuar kuota edhe për studentët nga trojet shqiptare (Kosovë; RMV; Mali i Zi; Preshevë, Bujanovc, Medvegjë). <i>Referenca:</i> Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT Ref 026 <i>Praktika e miratimit të kuotave të pranimit në FGJM</i>
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për	Në Raportin e Vlerësimit të brendshëm, deklarohet se UPT ka një politikë për dhënie bursave, gjysmë-bursave dhe tarifave të reduktuara, për studentët në nevojë dhe studentët ekselentë.

shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimi në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	GVJ nuk gjeti në dosjen e vetëvlerësimit ndonjë dokument që të faktohet kjo politikë e këtij Institucioni apo ajo çka vetë Grupi i vlerësimit të brendshëm është shprehur duke i dhënë përgjigje këtij kriteri.			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se UPT zbaton politika dhe procedura, të cilat garantojnë të drejta të barabarta për të gjithë kandidatët për studentë, vendas dhe të huaj, duke mundësuar ndjekjen korrekte të kandidatit, që nga momenti i aplikimit, më pas regjistrimit dhe deri në përmbylljen e detyrimeve akademike dhe diplomimin e tij. Kriteret, procedurat e pranimi dhe përzgjedhjes së studentëve, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, janë të shprehura qartë në aktet rregullatore të Institucionit, sikurse edhe në Rregulloren e programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri e Burimeve Minerare".</i> <i>GVJ beson se UPT ka politika edhe për studentët në nevojë dhe për studentët me familje me probleme sociale, por në DVV mungon një dokument i tillë ku të vërtetohet kjo politikë. Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri e Burimeve Minerare" është fushë prioritare dhe studentët e përfshirë në të përfitojnë mbështetje financiare.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
				X

Standardi V.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Referuar RVB si dhe dosjes së Vetëvlerësimit, mbështetur edhe në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe të mësimdhënies në UPT, GVJ konstaton se Institucioni ka informacion të plotë dhe të qartë, informacion i cili është vendosur në dispozicion të studentëve duke ju bërë me dije kushtet e kalimit në vitin pasardhës. Sipas nenit 37 të kësaj Rregulloreje, për programin Bachelor, studenti i vitit të parë kalon në vitin e dytë nëse ai ka marrë jo më pak se 50% të krediteve (30 kredite) të vitit të parë. Për programet e studimit të ciklit të parë, studenti i vitit të dytë kalon në vitin e tretë, nëse ai ka marrë jo më pak se 80 kredite. Këto kushte janë

	publike dhe në faqen zyrtare të UPT (http://upt.al/kushtet-e-kalimit-në-vitin-pasardhës). Studenti që nuk plotëson kriteret për të kaluar në vitin pasardhës ka këto të drejta dhe detyrime për lëndët jo kaluese: - I njihen të gjitha detyrimet e shlyera kur programet e lëndëve përkatëse janë të pranueshme për vitin në vazhdim; - Mund të frekuentojë lëndët për të cilat është vlerësuar mbetës dhe është i detyruar të frekuentojë lëndët për të cilat ka detyrim frekuentimin; - Duhet të shlyejë detyrimet e reja që lindin për shkak të ndryshimit të planit e programeve mësimore, nëse ka detyrim frekuentimin për lëndë që janë zëvendësuar në këtë plan me lëndë të reja; - Duhet të paguajë tarifën e shkollimit. <i>Referenca:</i> <i>Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i> <i>Ref 006 Rregullore e Brendshme e FGJM</i> <i>Ref 025 Guida Studentore</i> <i>Ref 036 Informacion specialisti karrierrës</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	GVJ shprehet se sipas Rregullores së Zhvillimit kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, neni 39, Universiteti Politeknik i Tiranës i ofron mundësinë të interesuarve për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, në fusha studimi të njëjta ose të përafërta, në fillim të vitit akademik, brenda UPT-së apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë, publike ose private, vendase ose të huaja. GVJ konstaton se UPT, ka politikë të qartë dhe të mirë menduar për studentët të cilët duan të studiojnë në programet që ofron ky Institucion duke kërkuar transferimin e studimeve nga një institucion tjetër i arsimit të lartë në vend. Kjo gjë iu pohua GVJ edhe gjatë takimeve të realizuara në vizitën në institucion. Programet e studimit dhe detyrimet e shlyera në institucione të tjera njihen dhe ekuivalentohen nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin, në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm. Për njohjen dhe ekuivalentimin e krediteve angazhohet drejtpërdrejtë njësia bazë ose njësia kryesore, ajo njësi në të cilën është paraqitur kërkesa për transferimin e studimeve. Kjo Rregullore shprehet se Njësia kryesore ose njësia bazë parashikon në rregulloren e programit fushat e përafërta të studimit që lejohen për transferimin e studimeve.

	Në Rregulloren e programit nuk janë parashikuar fushat e përafërta të studimit që lejojnë studentët të transferojnë studimet e tyre. <i>Referenca:</i> <i>Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i> <i>Ref 010 Rregullore e PS BSc në Inxhinieri e Burimeve Minerare</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT përcaktohen kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e të aftësive të studentëve. GVJ konstaton se sipas kësaj Rregulloreje, neni 30, për të vlerësuar studentët, përdoret sistemi i vlerësimit me 10- nota. Nota 10 është vlerësimi maksimal dhe nota minimale kaluese është nota 5. Me këto kriteret dhe procedura studentët mund të njihen lehtësisht dhe në faqen e internetit të UPT (http://upt.al/sesionet-e-provimeve). FGJM ka miratuar një procedurë të veçantë për vlerësimin e dijeve me të cilën studentët njihen lehtësisht në faqen e internetit të FGJM (https://FGJM.edu.al/info/rregullore-dhe-procedura). Përveç informacionit që mund të marrin në Sekretarinë Mësimore studentët informohen në fillim të çdo semestri nga vetë stafi akademik, që me prezantimin e syllabusit. <i>Referenca:</i> <i>Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i> <i>Ref 006 Rregullore e Brendshme e FGJM</i> <i>Ref 041 Procedura për vlerësimin e dijeve në FGJM</i> <i>Ref 089 Rregullore Sekretarise Mësimore FGJM</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	GVJ konstaton se Institucioni ka parashikuar dhe zbaton kriteret dhe procedurë të qartë për studentët në lidhje me punimin e diplomës dhe procesin e diplomimit të tyre. Punimi i diplomës është përcaktuar si në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe të mësimdhënies në UPT dhe më i detajuar në Rregulloren e programit. Referuar Rregullores së programit të studimit BSc në “Inxhinieri e Burimeve Minerare”, në kreun V të saj, neni 19, është mirë përcaktuar Mbrojtja e diplomës /Provimi i formimit. Në këtë nen flitet për mënyrën e përgatitjes së punimit të diplomës; përcaktimin e temës së diplomës në Bachelor; Udhëheqjen e diplomës; përmbajtjen e kontrolleve, ku në total parashikohen 2 kontrolle; mbrojtjen dhe vlerësimin e

	diplomës; kriteret e diplomimit, ku është përcaktuar që studenti nuk mund të mbrojë temën e diplomës pa shlyer më parë të gjitha detyrimet dhe pa fituar 175 kredite të parashikuara në planin mësimor të programit të studimit. Komisioni i provimit përbëhet nga së paku pesë anëtarë, përfaqësues të stafit akademik efektiv të Departamentit të Inxhinierisë së Burimeve Minerare, anëtarë të cilët propozohen nga Departamenti dhe miratohen nga Dekani i Fakultetit. Provimi zhvillohet me shkrim dhe korrigjohet nga komisioni i provimit. Provimi vlerësohet me 5 kredite dhe vlerësimi i studentëve bëhet me notë. <i>Referenca:</i> <i>Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i> <i>Ref 060 Procedura konceptimi e Provimit Përfundimtar</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ iu komunikua që UPT në përgjithësi dhe Fakulteti i Gjeologji Minerave në veçanti, marrin pjesë në të gjitha panairët e organizuara nga Ministria e Arsimit, (Work & Study, Open day, Ditët e Maturantëve) por jo vetëm, për të promovuar programet që ofrohen në rang Universitetit dhe në rang Fakulteti. Sipas përfaqësuesve të zyrës së sigurimit të cilësisë, në këto takime shpërndahen broshura informuese për të gjithë të interesuarit që duan të ndjekin një program studimi në UPT. GVJ iu komunikua gjithashtu se i gjithë Institucioni është i përfshirë në promovimin e programeve që ofron por duhet pranuar që interesi për të ndjekur një program studimi në UPT ka rënë, ashtu si edhe në pothuajse të gjitha institucionet e arsimit të lartë në vend. Kjo rënie shikohet qartë edhe në numrin e studentëve që ndjekin këtë program studimi që në vitin akademik 2023-2024 kishte vetëm 5 studentë të regjistruar. <i>Referenca:</i> <i>Ref 025 Guida Studentore</i> <i>Ref 028 Njoftim për ceremoninë e vitit të ri akademik</i> <i>Ref 033 Aktivitete informuese mbi programet e studimit.</i>
Konkluzione	GVJ gjykon se institucioni në funksion të efektivitetit të mësimdhënies vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	GVJ vlerëson se për informimin e studentëve në lidhje me strukturën e organizimit të programit, pjesë e të cilës është edhe kohëzgjatja e tij, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave dhe Departamenti i Inxhinierise së Burimeve Minerare, përdorin disa kanale dhe mënyra komunikimi. Konstatohet se ka një bazë rregullatore si të programit të studimit BSc në Inxhinieri e Burimeve Minerare, ashtu edhe të rregullores se zhvillimit kurikular dhe të mësimdhënies, rregullore e cila është për të gjithë programet që ofrohen në UPT. GVJ gjatë vizitës në institucion, u informua se çdo fillim viti akademik FGJM organizon takim me studentët e rinj nëpërmjet të cilit ato informohen që në momentin që regjistrohen në këtë program studimi në sekretarinë mësimore se si është i organizuar programi i studimit. Informacion më të hollësishëm, studentët e marrin gjatë kontakteve me pedagogët dhe mentorët e tyre. <i>Referenca:</i> Ref 006 Rregullore e Brendshme e FGJM Ref 010 Rregullore e PS BSc në DIBM Ref 025 Guida Studentore Ref 036 Informacion specialisti karrierrës Ref 039 Uebfaqe FGJM në Facebook Ref 040 Uebfaqe FGJM në Instagram
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Nga shqyrtimi i DVV, GVJ vlerëson se studentët kanë disa mundësi për të marrë informacion në lidhje me mësimin dhe aktivitetet akademike: 1. Informimi mbi modulet dhe lëndët: Me fillimin e semestrit, pedagogët informojnë studentët për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe aktivitetet formuese që do të zhvillohen gjatë semestrit. Ky informacion pasqyrohet gjithashtu në syllabusin e lëndës. 2. Hapësira për studentët në faqen e internetit: Në faqet e internetit të UPT dhe të FGJM studentët mund të gjejnë

	informacion të rëndësishëm për oraret e provimeve, kalendari akademik, bibliotekën, dhe më shumë. 3. Mundësitë për kontaktim: Për çdo informacion të nevojshëm, studentët mund të kontaktojnë direkt ose përmes e-mail-eve: pedagogët kujdestarë, sekretarinë mësimore, drejtuesit e departamenteve, zv. dekanin, etj. Ky sistem komunikimi ka si qëllim të ofrojë një rrugë të qartë dhe të lehtë për studentët që të jenë të informuar dhe të lidhen me personat përgjegjës për çështjet akademike. <i>Referenca:</i> <i>Ref 006 Rregullore e Brendshme e FGJM</i> <i>Ref 010 Rregullore e PS BSc në DIBM</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Gjatë praktikave mësimore të studentëve ato, përveç se me njohjen e terrenit fizik dhe të pritshmërive të ushtrimit të profesionit, informohen dhe vendosin kontaktet edhe për punësimin e mundshëm mbas diplomimit. Informacion mbi punësimin e mundshëm gjendet edhe në Suplementin e Diplomës që lëshohet së bashku me diplomën në përfundim të studimeve. Në raportin e GVB dhe në materialet e DVV, shikohet në rang Universiteti, UPT ka një sërë marrëveshjesh institucionale që janë në funksion të studentëve edhe për punësimin e tyre. UPT, nga viti 2016 e në vazhdim, ka nënshkruar 13 marrëveshje me universitete vendase; 57 marrëveshje me universitete të huaja; 55 marrëveshje me kompani që operojnë në vendin tonë; 15 marrëveshje me institucione shtetërore. Konstatohet se disa prej këtyre marrëveshjeve nuk janë më funksionale dhe do sugjerohet që institucioni të gjente format dhe mënyrat për të shtuar listën e marrëveshjeve në funksion të këtij programi studimi. Në evidencat e ofruara (Ref. 049) janë përfshirë institucionet e bashkëpunimit me të cilat UPT realizon praktikën e studentëve dhe ka mundësi punësimi. Në dokumentin e fundit të kësaj liste, paraqitet tabela me institucionet me të cilat janë lidhur marrëveshje në kuadër të Erasmus +. Në këtë tabelë janë përfshirë 34 Universitete të huaja, nga të cilat vetëm për dy institucione/Universitete janë në fuqi marrëveshjet për vitet që vijnë, konkretisht: - Universiteti of West Attica (UNIWA) i përfundon marrëveshja më 2027; - Politecnico i Torinos, i përfundon marrëveshja më 2024. <i>Referenca:</i>

	<i>Ref 034 Aktivitete të organizuara nga Zyra e Karrierës</i> <i>Ref 049 Marrëveshjet Institucionale UPT</i> <i>Ref 051 Marrëveshjet me industrinë dhe institucione</i> <i>Ref 055 Modeli Suplementit Diplomës BSc Inxhinieri e Burimeve Minerare</i>			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Nga këqyrja e DVV shikohet që UPT ka disa mekanizma të cilat funksionojnë duke informuar studentët me gjithçka që lidhet me procesin mësimor dhe me programin e studimit. Një informacion të hollësishëm studentët kanë edhe për infrastrukturën në funksion të programit dhe bazën laboratorike në funksion të realizimit të programit. Gjatë vizitës në vend, për shkak të punimeve/rikonstruksionit që kishin filluar prej disa kohësh në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave, GVJ nuk pati mundësi të shikonte bazën laboratorike në funksion të programit BSc Inxhinieri e Burimeve Minerare. Gjatë vizitës GVJ shikoi vetëm disa laboratorë që ishin përshtatur për këtë program studimi deri në përfundimin e ristrukturimit të godinës ku do të jenë laboratorët në funksion të programit. <i>Referenca:</i> <i>Vizita ne Institucion</i>			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Për programin e studimit BSc në “Inxhinieri e Burimeve Minerare”, studentët e këtij programi kanë mundësi të përdorimit edhe të platformës së Sekretarisë Mësimore Bit Albania (https://bit-albania.com/upt6.php). GVJ iu tha gjatë vizitës në institucion që akses i çdo studenti në këtë platformë është i lehtë dhe realizohet duke përdorur emër përdoruesi (<i>user name</i>) dhe fjalëkalim (<i>password</i>) personal. Me përdorimin e kësaj platforme studentët njihen që në momentin që regjistrohen në programin e studimit. <i>Referenca:</i> <i>Ref 043 Manual përdorimi platforma Sekretarisë Mësimore BIT-ALBANIA</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se informacioni që u jepet studentëve mbi objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit, është i aksesueshëm, i plotë dhe i hollësishëm. Për bazën laboratorike dhe infrastrukturën në funksion të këtij programi nuk shprehem dot plotësisht pasi gjatë vizitës në vend nuk u njohëm me këtë infrastrukturë laboratorike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

GE

AF

			X	
--	--	--	---	--

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	GVJ shprehet se Informacioni lidhur me statistikat vjetore për numrin e studentëve dhe të diplomuarve për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në "Inxhinieri e Burimeve Minerare" është marrë nga Sekretaria Mësimore e FGJM dhe nga DVV. Referuar tabelës Nr. 23 (aneks tabelat), ku paraqiten të dhënat për studentët e diplomuar, rezulton se për periudhën 2021-2024 numri total i të diplomuarve është 28 studentë. Sipas të dhënave në Sekretarinë mësimore, pohohet po numri 28 i studentëve të diplomuar, prej të cilëve 9 janë punësuar në përputhje me programin që kanë mbaruar dhe 2 janë të punësuar, por jo në përputhje me diplomën. Ndërsa sipas viteve akademike, numri i studentëve të regjistruar i paraqitur në Tabelën 21 të aneks tabelat pëmbledhëse, por e konfirmuar edhe në Sekretarinë mësimore, si më poshtë: Viti akademik 2021-2022 12 studentë Viti akademik 2022-2023 13 studentë Viti akademik 2023-2024 5 studentë Referuar materialit të paraqitur në DVV, në kreun III, pika g, Gjurmimi i studentëve që kanë përfunduar studimet për çdo program studimi (viti akademik 2022-2023) për programin BSc në Inxhinieri e Burimeve Minerare, numri i hyrjeve /numri total i të regjistruarve është 30 studentë. Statistikat vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve për këtë program studimi tregohen edhe në raportin vjetor të analizës së Departamentit dhe FGJM-së. <i>Referenca:</i> Ref 030 - Modeli i Regjistrave Ref 048 Raporti Analizës Mësimore DIBM Ref 082 Raport i aktivitetit mësimor në nivel njësisht dhe universiteti
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e	GVJ shprehet se informacioni për këtë pikë në DVV është i cunguar. Po ti referohesh përgjigjes që ka dhënë Grupi i vlerësimit të brendshëm për këtë program, përgjigja për këtë kriter është marrë edhe duke pasur si referencë materialin Ref

studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	082 (<i>Raporti i aktivitetit mësimor në nivel njësisht dhe universiteti</i>). Referuar këtij materiali, GVJ konstaton se, në këtë material është paraqitur raportim i pedagogut për aktivitetin mësimor, viti akademik 2022-2023. Ky material nuk ka lidhje me të dhënat që kërkon plotësimi i kriterit. Sipas të dhënave të paraqitura në materialin 048, për vitin akademik 2022-2023, vit në të cilën është përqendruar institucioni kur ka përgatitur këtë raport/analizë, mungojnë të dhënat për: - Numrin e të diplomuarve në Bsc Inxhinieri e Burimeve Minerare (III, pika G) - Numrin e të diplomuarve të regjistruar në ciklin pasardhës - Numrin e studentëve të çregjistruar - Numrin e studentëve të transferuar - Numri i studentëve të ardhur më transferim <i>Referenca:</i> <i>Ref 048 Raporti i analizës mësimore Staf Departament FGJM</i> <i>Ref 082 Raport i aktivitetit mësimor në nivel njësisht dhe universiteti</i> <i>Minutat e vizitës në institucion</i>
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	GVJ konstaton që Sekretaria Mësimore e FGJM-së ruan dhe menaxhon të dhënat statistikore të studentëve përgjatë gjithë ciklit të studimeve për programin e studimit “Bachelor” në “Inxhinieri e Burimeve Minerare”. Bazuar në udhëzimet e MAS, këto të dhëna ruhen në formë të shkruar dhe në formë elektronike dhe në regjistrat përkatës. Në këtë fakultet funksiononte sistemi i brendshëm i informacionit në formë elektronike BIT Albania. GVJ iu komunikua se këto të dhëna janë të sigurta dhe të verifikueshme për personat e autorizuar, duke pasur parasysh mos kallëzimin e të dhënave sensitive, të cilat mund të keq menaxhohen. <i>Referenca:</i> <i>Ref 030 - Modeli i Regjistrave</i> <i>Ref 043 Manual përdorimi platforma Sekretarisë Mësimore BIT-ALBANIA</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njërive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e	Në DVV deklарohet se të dhënat për studentët dhe statistikën për to, janë objekt kontrolli i përvitshëm nga strukturat përgjegjëse të UPT, nga kontrolli i të cilave realizohen raportimet përkatëse në strukturat drejtuese. <i>Referenca:</i>

menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	<i>Raporti i vlerësimit të brendshëm të programit, Aneks Tabelat përmbledhëse</i> <i>Ref 048 - Raporti i analizës mësimore Staf Departament FGJM</i>
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Në DVV por edhe gjatë vizitës në institucion, GVJ iu komunikua se ka Raporte analitike, mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, shkallën e punësimit të tyre, etj. Në materialin tip të paraqitur në DVV, (048) të dhënat nuk janë të plota dhe janë paraqitur edhe tabela të cilat nuk kanë asnjë të dhënë për këtë fakt. Referuar Raportit të vlerësimit të brendshëm të programit të studimit BSc në Inxhinieri e Burimeve Minerare, Tabelave në fund të këtij raporti, shpreheni për këtë pikë sa më poshtë: Sipas tabelës Nr. 21 (te aneks tabelat përmbledhëse), cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve paraqitet - Viti akademik 2021-2022 – të regjistruar për herë të parë në vitin e parë, 12 studentë; nota mesatare ne hyrje- 7.54 - Viti akademik 2022-2023 – të regjistruar për herë të parë në vitin e parë, 13 studentë; nota mesatare ne hyrje- 7.99 - Viti akademik 2023-2024 – të regjistruar për herë të parë në vitin e parë, 5 studentë; nota mesatare ne hyrje- 7.36 Në këtë tabelë mungojnë të dhënat për studentët e transferuar sipas viteve si edhe cilësia e studentëve në dalje. Sipas tabelës 23 në programin e studimit BSc në “Inxhinieri e Burimeve Minerare”, për periudhën 2021-2024, numri total i të diplomuarve është 28; numri i të punësuarve (në përputhje me diplomën) është 9 dhe numri total i të punësuarave (jo në përputhje me diplomën) është 2. <i>Referenca:</i> <i>Raporti i vlerësimit të brendshëm të programit, Aneks Tabelat përmbledhëse</i> <i>Ref 048 - Raporti i analizës mësimore Staf Departament FGJM</i> <i>Ref 108 Rregjistri Alumnas FGJM</i>
Konkluzione	GVJ konstaton se FGJM përgjithësisht plotëson kërkesat e standardet për mbledhjen, administrimin, përditësimin dhe ruajtjen e të dhënave për studentët që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre. Institucioni ruan të dhëna bazike në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e

	studimit BSc në Inxhinieri e Burimeve Minerare, si dhe të dhëna të punësimit të tyre. Duhet të tregohet më kujdes në të dhënat që paraqiten në raportimet e Departamentit të Inxhinierisë së Burimeve Minerare, pasi të dhënat janë të paplota			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Në raportin e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm, hartuesit e tij shprehen se studentët në UPT janë të përfshirë në organet vendimmarrëse dhe këshilluese. Ky fakt na u pohua edhe gjatë vizitës në institucion. Referuar dokumentacionit 083 (<i>Rezultatet e zgjedhjeve për Senatin akademik</i>), vërejmë se në Senatin Akademik të UPT-së përfaqësohen nga 4 studentë. GVJ pohon se studentët janë pjesë edhe e këshillave të programeve të studimit në Departamentin e Inxhinierisë së Burimeve Minerare. Referuar dokumentit – <i>Vendimi i DIBM për ngritjen e KPS</i>, vërehet se në miratimin e Këshillave të Programeve të Studimit, sipas shkresës të Përgjegjës të Departamentit në përbërje të këtyre këshillave për programet e studimit që ofrohen në Departamentin e Inxhinierisë së Burimeve Minerare, pjesë e të cilit është edhe programi i studimit që po akreditohet, janë edhe studentët e programit përkatës. Gjithashtu GVJ pohon se pjesë e Grupit të vlerësimit të brendshëm të programit është dhe një student, i cili ishte pjesëmarrës edhe në takimin që realizoi GVJ në Institucion me GVB-në. <i>Referenca:</i> <i>Ref 001 Statuti i UPT.</i> <i>Ref 003 Kodi i Etikës UPT</i> <i>Ref 019 Urdhëri i Dekanit FGJM për ngritjen GVB</i> <i>Ref 020 Vendimi i DIBM për ngritjen KPS</i> <i>Ref 083 Rezultatet e zgjedhjeve për Senatin Akademik</i> <i>Ref 084 Komisionet e Senatit Akademik të UPT</i>

Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Gjatë vizitës në Institucion, GVJ zhvilloi takime me studentët, sikurse edhe me studentin që ishte pjesë e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm. Në raportin e vlerësimit flitet për funksionimin e këshillave studentorë në nivel fakulteti. GVJ shprehet se nuk paragjykon funksionimin e këtyre këshillave, por shprehet me bindje se gjatë takimit që pati me studentët e këtij programi studimi, pyetjes për funksionim e këshillit studentor, studentët u përgjigjën se këshilli studentor nuk bën aktivitete. <i>GVJ vlerëson që Institucioni duhet të punojë më shumë për të nxitur studentët që të japim mendime dhe propozime konkrete për atë çka duhet të rregullohet si në funksionimin si duhet të programit të studimit ashtu edhe në veprimtaritë kërkimore.</i> <i>Referenca:</i> <i>Raporti i vlerësimit të brendshëm të programit</i> <i>Minutat e vizitës se GVJ në UPT</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Nga Njësia e Sigurimit të Cilësisë, GVJ-së, gjatë vizitës në Institucion, iu pohua se kjo Njësi shpërndan pyetësor për studentët duke synuar të marri prej tyre opinione në lidhje me programin e studimit BSc në Inxhinieri e Burimeve Minerare. Qëllimi i pyetësorit është tu japë mundësi studentëve të shprehin mendimin e tyre mbi procesin mësimor dhe personelin akademik të programit si dhe të përcjellin pranë autoriteteve të UPT shqetësime specifike. GVJ gjykon se Institucioni përdor mekanizma për të thithur mendimin e studentëve në lidhje me programin e studimit BSc në Inxhinieri e Burimeve Minerare. Pyetësori në vetvete ndihmon autoritetet drejtuese për të krijuar një panoramë të çështjeve apo problematikave që kërkojnë zgjidhje. Gjithashtu GVJ ju komunikua se Njësia, në praktikën e saj të punës ka edhe raportin në lidhje me pyetësorët e studentëve. Në DVV është paraqitur raporti, (Ref 065 - <i>Anketimi studentor - Pyetësori dhe raporti</i>). Ky raport është përgatitur nga Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UPT, për vitin akademik 2021-2022 (semestri I). <i>Referenca:</i> <i>Raporti i vlerësimit të brendshëm të programit</i> <i>Ref 065 Anketimi Studentor-Pyetësori dhe Raporti</i> <i>Ref 107 Informacion për studentët për plotësimin e pyetësorit të lëndëve</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë	Nga vlerësimi i DVV, GVJ shprehet që studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve,




dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë apo pedagogut përgjegjës. E drejta e ankimimit dhe procedurat përkatëse janë përshkruar në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies. Drejtoria e Sigurimit të Cilësisë mund të marrë një informacion të plotë dhe të qartë nga procesi i anketimit, për të përcjellë në Rektorat shqetësimet apo kërkesat që kanë studentët që ndjekin programet në UPT. GVJ vëren se raporti i përgatitur nga Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UPT, për vitin akademik 2021-2022 (semestri I) ka rubrika të ndërtuara mirë, të detajuara, në mënyrë të atillë për të përcjellë në Rektorat shqetësimet apo kërkesat që kanë studentët që ndjekin programet në UPT. Raporti përfshin në rubrikat e tij: - Bazën ligjore (Ligjin e Arsimit të Lartë; Kodin e cilësisë së Arsimit të Lartë) - Organizimin e pyetësorit (Qëllimi i tij; Hartimi i pyetjeve dhe kriteret e vlerësimit) - Sistemi elektronik i pyetësorit (Gjenerimi i të dhënave; anonimati i studentit) - Rezultatet e anketimit (Metodologjia e përdorur për analizimin e të dhënave; Pjesëmarrja në anketim) - Evidentimi i problematikave në rang institucioni - Vlerësimet sipas fakulteteve dhe programeve të studimit (Fakultetet pjesë e anketimit; përcaktimi i anketimeve të pavlefshme; kriteret e vlerësimit sipas Fakulteteve/ programeve të studimit; rezultate për çdo fakultet/program studimi; problematikat dhe rekomandimet për përmirësimin e treguesve të ulët për çdo fakultet/program studimi) - Vlerësimet e pedagogëve (të dhëna të përgjithshme; rankimi i pedagogëve; rekomandimet dhe propozimet për përmirësimin e treguesve të ulët) - Vlerësimet e pedagogëve - Anekset për pyetësorin e 6 fakulteteve <i>Referenca:</i> <i>Raporti i vlerësimit të brendshëm të programit</i> <i>Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i> <i>Ref 065 Anketimi studentor - Pyetësori dhe raporti</i>
Konkluzione	GVJ shprehet se UPT ka përfshirë dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese. Studentët janë pjesë e Senatit akademik, janë pjesë e Grupeve të vlerësimit të brendshëm duke sjellë frymën dhe mendimet e tyre në

	<i>institucionet drejtuese. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit. E drejta e ankimimit dhe procedurat përkatëse janë përshkruar në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	GVJ gjatë vizitës në institucion vërejt se i gjithë Fakulteti i Gjeologji Minerave, së bashku me Departamentin e Inxhinierisë së Burimeve Minerare, departamenti përgjegjës për këtë program studimi, janë në shërbim dhe në funksion të studentëve. Referuar DVV dhe Raportit të vlerësimit të brendshëm, në shërbim të studentëve janë Drejtoria e Kurikulave me 2 sektorët e saj (Sektori i Kurikulave; Sektori i procesit mësimor) dhe Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit që ofron shërbimin e karrierës dhe Alumni. Në DVV paraqitet dokumenti 032 – <i>Aktivitete të organizuara nga Zyra e Karrierës</i>, në të cilën është paraqitur një raport përmbledhës i aktiviteteve të Zyrës së karrierës për periudhën 2022-2023-2024. Më poshtë, GVJ paraqet disa nga aktivitetet e bëra nga kjo Zyrë, ku janë përfshirë studentët e UPT-së, si: - Plani kalendarik i aktiviteteve për vitin akademik si dhe Guida studentore 2022-2023-2024; - Prezantimi për fillimin e vitit akademik me studentët e vitit të parë “Bachelor” 22-23; - Zhvillohet takimi për “Internship programme of German Business” për vendet e Ballkanit perëndimor, data 28.10.2022; - Publikim në Web-in e Fakultetit nga Shoqata Sportive UPT, datë 27.10.2022; - Workshop në Zyrën e Karrierës së bashkisë Tiranë, më datë 13.01.2022;

	- Përgatitje për ditën e informimit të maturantëve (2023-2024), realizuar më datë 10.01.2023; - Për publikim në faqen e Fakultetit Platforma praktika.al 10.02.2023; - Datamine-FGJM organizon takim promovues mbi programin 'DATAMINE', datë 18.04.2023, etj. <i>Referenca:</i> <i>Raporti i vlerësimit të brendshëm të programit</i> <i>Ref 005 Organigrama e UPT</i> <i>Ref 015 Organigrama e FGJM</i> <i>Ref 032 – Aktivitete të organizuara nga Zyra e Karrierës</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	GVJ pohon që në funksion të studentëve të programit BSc në Inxhinieri e Burimeve Minerare janë të gjitha strukturat e Departamentit përkatës, të Fakultetit të Gjeologji Minierave dhe të krejt Universitetit Politeknik të Tiranës. Strukturat në funksion të studentëve kanë edhe bazën rregullatore të tyre. Sipas Rregullores së Zhvillimit Kurrikular dhe mësimdhënies në UPT, organizimi dhe menaxhimi i çdo programi studimi në UPT, në nivel njësie bazë/Departamenti, bëhet nga Këshilli i Programit të Studimit. Në përbërje të këtij këshilli është edhe një student i cili përzgjidhet nga Departamenti i Inxhinierisë të Burimeve Minerare, si Departamenti përgjegjës për ofrimin e programit të studimit. Po sipas kësaj Rregulloreje, me propozim të Drejtuesit të departamentit caktohet koordinatori i programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe zhvillimin e praktikave profesionale në përputhej me rezultatet e të nxënit. GVJ shprehet se UPT si një institucion me përvojë të gjatë në fushën e ofrimit të programeve të studimit të të tre cikleve, ka një sistem të mirë organizuar në funksion të procesit mësimor. Rol të veçantë këtu luan edhe Sekretaria mësimore e cila me shërbimet që ofron, është në funksion të studentëve. <i>Referenca:</i> <i>Raporti i vlerësimit të brendshëm të programit</i> <i>Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i> <i>Ref 005 Organigrama e UPT</i> <i>Ref 015 Organigrama e FGJM</i> <i>Ref 020 Vendimi i DIBM për ngritjen KPS</i> <i>Ref 035 Lista e pedagogëve kujdestarë</i>

6

Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Gjatë takimit që GJV realizoi me përfaqësuesit e zyrës së Karrierës, u prezantua puna e kësaj zyre. Siç jemi shprehur edhe më lart, pjesë e Dosjes së Vetëvlerësimit është edhe aktiviteti i Zyrës së karrierës për periudhën 2022-2023-2024. Në Raportin e vlerësimit të brendshëm, GVB shprehet se kjo zyrë shërben si urë lidhëse e Institucionit dhe shërbimeve që ofron me studentët. Referuar Rregullores kjo zyrë vepron në funksion të këshillimit akademik të studentit, në kuadër të politikave për zgjerimin e hapësirave dhe mundësive ndërvepruese të studentëve. GJV konstaton se ky objektivi primar është një orientim për studentin në lidhje me procesin mësimor që do të ndjekë gjatë shkollimit të tij në këtë program studimi. Duke shfrytëzuar kontaktet e saj, që kanë ardhur duke u pasuruar, zyra shërben edhe si urë lidhëse midis studentëve dhe tregut të punës duke promovuar studentët tek bizneset në kërkimin e mundësive të reja të punësimit <i>Referenca:</i> <i>Raporti i vlerësimit të brendshëm të programit</i> <i>Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies</i> <i>Ref 010 Rregullore e PS BSc në Inxhinieri e Burimeve Minerare, neni 2</i> <i>Ref 034 Aktivitete të organizuara nga Zyra e Karrierës</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Bazuar në DVV dhe në vizitën në Institucion, GJV vëren që po punohet për funksionimin dhe sistemin e ndjekjes së studentëve pas diplomimit të tyre në këtë program studimi. Ky fakt është deklaruar edhe në raportin e Vetëvlerësimit, ku GVB shprehet se: <i>...për ngritjen e rrjetit Alumni ka filluar puna përmes një pyetësi për të identifikuar studentët e diplomuar në UPT dhe për të ndjekur zhvillimin e karrierës së tyre.</i> Sipas përfaqësuesve të Zyrës së karrierës dhe Alumni në takimin që realizuan me GJV gjatë vizitës në vend, u deklarua se kjo Zyrë ka kontaktuar me një numër të konsiderueshëm studentësh të diplomuar, të cilët janë treguar të gatshëm për të qenë pjesë e këtij rrjeti <i>Referenca:</i> <i>Ref 034 Aktivitete të organizuara nga Zyra e Karrierës</i> <i>Ref 039 Uebfaqe FGJM në Facebook</i> <i>Ref 040 Uebfaqe FGJM në Instagram</i>
Konkluzione	<i>GJV shprehet se UPT si Institucion qendror ka procedura e njësi të posaçme si Zyra e Këshillimit të Karrierës, Sekretaritet Mësimor të fakulteteve, të cilat angazhohen për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e</i>




	ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme dhe janë lehtësisht të arritshme nga studentët. Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave ka filluar punën për gjurmimin e studentëve të tij të diplomuar dhe ka në proces hartimin e një baze të dhënash me të diplomuarit në programet e studimit që ofron FGJM			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Bazuar në dokumentacionin e Dosjes së Vetëvlerësimit dhe Raportin e Vlerësimit të Brendshëm, GVJ shprehet se për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme në funksion të mësimdhënies, UPT ka hartuar politika dhe ka ngritur struktura për të ofruar standarde evropiane në programet e studimit që ofron. Në planin strategjik të UPT për vitin 2019-2024, synohet që nëpërmjet informimit, këshillimit, mbështetjes si dhe orientimit të studentëve, si dhe përmirësimit dhe krijimit të një infrastrukture të përshtatshme dhe funksionale në shërbim të tyre, të përmirësohet cilësia e shërbimeve ndaj studentëve duke krijuar një kulturë shërbimi cilësor dhe bashkëkohor. Po sipas këtij plani strategjik, për vitet 2019-2024, UPT angazhohet për përmirësimin e cilësisë së sistemit të menaxhimit të informacionit në nivel institucional, duke synuar paraqitje të plotë, të saktë dhe të përditësuar të informacionit për studentët që lidhet me veprimtarinë e përgjithshme të UPT-së, veçanërisht me procesin mësimor. Në FGJM ka filluar edhe aplikimi i shërbimit online të sekretarisë dhe kurrikulës nëpërmjet përmes platformës BitAlbania.

	<i>Referenca:</i> <i>Ref 002 Plani Strategjik i UPT 2019-2024</i> <i>Ref 038 Informimi i studentëve nëpërmjet platformave online</i> <i>Ref 043 Manual përdorimi platforma Sekretarisë Mësimore BIT-ALBANIA</i> <i>Ref 062 Model faqe website pedagogu</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	GVJ shprehet se Universiteti Politeknik i Tiranës është një nga Institucionet më të hershme dhe me të vlerësuara të arsimit të lartë në vend dhe si i tillë, ndër vite, ka kontribuar duke përgatitur inxhinierë në degët më të rëndësishme të industrisë. Stafi akademik i UPT në përgjithësi por edhe i Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave si njësi kryesore e programit të studimit, BSc në Inxhinieri e Burimeve Minerare, është i kualifikuar, me tituj dhe me grada dhe me përvojë në mësimdhënie. Programi është fryt i bashkëpunimit dhe menaxhimit midis të katër njësive bazë të FGJM dhe në të japin kontributin e tyre mësimdhënëse dhe shumë njësi të tjera bazë të UPT. Pra, programi ofrohet nga një staf i kualifikuar në këtë fushë dhe është një tregues pozitiv për mësimdhënien dhe studentët. Sigurimi i Brendshëm i cilësisë drejtohet nga Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e cila ka ngritur mekanizmat e saj të monitorimit për të vlerësuar në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. Një ndër këto mekanizma është edhe anketimi (pyetësi) studentor mbi cilësinë në mësimdhënie i cili plotësohet nga studentët për çdo pedagog në bazë të indikatorëve të perceptimit të performancës sipas studentit. GVJ gjithashtu pohon se gjatë vizitës në Institucion, këtij Grupi iu tha se analiza e kapaciteteve infrastrukturore dhe akademike për realizimin e këtij programi, ishte një analizë që bëhej në Departamentin e Inxhinierisë së Burimeve Minerare <i>Referenca</i> <i>Ref 047 Praktika e parashikimit të ngarkesës mësimore FGJM-DIBM</i> <i>Ref 057 Procedura e punësimit të personelit PAK në UPT</i> <i>Ref 063 Raportimi i realizimit të ngarkesës vjetore Pedagog Departament</i> <i>Ref 065 Anketimi Studentor-Pyetësi dhe Raporti_OK</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të	Për të garantuar përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve, NJSBC përdor instrumenta të ndryshëm.




mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Gjatë vizitës në Institucion u realizua një takim me NJSBC dhe gjatë këtij takimi ndër të tjera u pohua që kjo Njësi realizon pyetësorë me studentët për të thithur prej tyre mendimin kritik për përmirësim të procesit të mësimdhënies por edhe shërbimeve që ju ofrohen studentëve. Kjo njësi realizon edhe një raport me të dhënat nga përpunimi i pyetësorëve të studentëve dhe këtë raport e paraqet në Dekanat duke nxjerrë pikat e forta dhe pikat e dobëta të anketimit të studentëve. Anketimi realizohej online, ku çdo student kishte mundësi plotësimi nëpërmjet adresës së tij të email-it. Ashtu siç është shprehur edhe në dokumentin e paraqitur në DVV, qëllimi i këtij pyetësori është krijimi i një panorame të problematikave në UPT, duke u fokusuar tek perceptimi i studentëve në lidhje me Universitetin, Fakultetin, programin e studimit ku ata studiojnë dhe pedagogët e tyre, për të mundësuar përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë akademike duke vazhduar traditën e ekselencës e duke konsoliduar reputacionin kombëtar e rajonal. <i>Referenca:</i> <i>Raporti i vlerësimit të brendshëm</i> <i>Minutat gjatë vizitës në IAL</i> <i>Ref 065 Anketimi Studentor-Pyetësori dhe Raporti OK</i> <i>Ref 107 Informacion për studentët për plotësimin e pyetësorit të lëndëve</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Në UPT, struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie është DSBC e cila organizon edhe anketime të studentëve, ku çdo student mund të shprehë perceptimin e tij mbi procesin mësimor dhe personelin akademik. GVJ ju pohua se Drejtoria e Kurikulave në nivel Institucioni, ka si bazë të punës së saj edhe përputhshmërinë e programit të studimit me standardet e cilësisë. Ka një Rregullore të zhvillimit kurikular dhe mësimdhënies në UPT, e cila i ka të përcaktuara të gjithë praktikën që ndiqet për zhvillimin dhe menaxhimin e programeve të studimit dhe të procesit mësimor në tërësi. Siç jemi shprehur edhe më sipër, Njësia e Sigurimit të Cilësisë monitoron sigurimin e cilësisë në mësimdhënie edhe nëpërmjet pyetësorit të studentëve. Monitorimi i procesit të mësimdhënies, realizohet edhe nëpërmjet kontrolleve që bën Zyra e NJSBC për organizimin e mësimi, sidomos në pedagogët e rinj.




	Të gjitha format bëhen publike dhe me rezultatet e monitorimit njoftohet Departamenti si njësi bazë dhe Fakulteti si njësi kryesore. Këto vlerësime janë transparente dhe publikohen në faqen web të UPT: [http://upt.al/cilesia-ne-upt] <i>Referenca</i> <i>Raporti i vlerësimit të brendshëm</i> <i>Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i> <i>Ref 038 Informimi i studentëve nëpërmjet platformave online</i>
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Pas takimeve me GVB por edhe me stafin akademik të departamentit dhe atë të përfshirë në program, GVJ verën se institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Shembull i tillë është mobiliteti i stafit të këtij programi nëpërmjet programeve të ndryshme ndërkombëtare. Duke patur parasysh që cilësia e mësimdhënies lidhet ngushtë me cilësinë e stafit akademik, institucioni ndjek politika mbështetëse për kualifikimin e personelit akademik për të kontribuar në përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. GVJ, pas leximit me kujdes të planit strategjik të UPT të paraqitur në DVV, shprehet se ky plan është tepër ambicioz dhe shpreson në arritjen e objektivave të tij. Në planin strategjik 2019-2024, objektivat e Institucionit për zhvillimin e vazhdueshëm të kapaciteteve njerëzore janë: - Krijimi i mundësive për kualifikimin dhe specializimin e mëtejshëm, me qëllim rritjen dhe zhvillimin profesional të personelit akademik dhe administrativ; - Intensifikimin e marrëdhënieve të shkëmbimit të personelit të UPT me universitetet perëndimore; - Rishikimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të procedurave të rekrutimit dhe seleksionimit të personelit akademik dhe administrativ; - Përmirësimin e sistemit të menaxhimit të performancës dhe motivimit të personelit të UPT. <i>Referenca</i> <i>Ref 002 Plani Strategjik i UPT 2019-2024</i> <i>Ref 066 Mobilitetet e realizuara 2021-2024</i>
Konkluzione	GVJ gjykon se, Universiteti ka hartuar dhe ndjek politika për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies. Këto politika konsistojnë në monitorimin e procesit mësimor

	<i>kryesisht në këqyrjen konkrete të një ore mësimi sidomos tek pedagogët e rinj, pyetësorit të drejtuar studentëve lidhur me cilësinë e mësimdhënies dhe mobilitetin e stafit të programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	GVJ vëren se në UPT ka një strukturë të posaçme për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Në UPT funksionon Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Drejtoria e Kurikulave, struktura që bashkëveprojnë me njëra tjetrën për sigurimin e cilësisë në programet e studimit që ofrohen. Referuar Organigramës së UPT, shikohet qartësisht se Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila varet nga Zv Rektori i UPT, ka në përbërje të saj Sektorin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (me dy specialistë) dhe Sektorin e Statistikës dhe Informacionit. Veprimtarinë e saj NJSBC-ja e mbështet në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë [https://www.Arsimi.gov.al]. Referuar RVB, Grupi i vlerësimit të brendshëm shprehet se pranë Departamenteve funksionojnë këshillat e programeve të studimit, Këshill që funksionon për çdo program studimit si dhe koordinatorët e programit. Në rregulloren e Fakultetit të Gjeologji Minierave (FGJM), në Kreun X të saj, flitet për vlerësimin e cilësisë në rang Fakulteti. Fakulteti është përgjegjës për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Fakultet koordinon veprimtarinë e sigurimit të cilësisë në departamente; planifikon organizimin periodik të vlerësimit të brendshëm të cilësisë së programeve të studimit në koordinim me Drejtorinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UPT; harton në bashkëpunim me Dekanatin, planin vjetor të veprimit për përmirësimin e cilësisë dhe harton raportin vjetor të cilësisë. Gjithçka më sipër ju pohua GVJ gjatë takimit në Institucion. <i>Referenca:</i> <i>Ref 005 Organigrama e UPT</i>

	<i>Ref 006 Rregullore e brendshme e FGJM</i> <i>Ref 007 Plani Strategjik FGJM 2020-2024</i> <i>Ref 091 Raport mbi anketimin studentor cilësia e mësimdhënies 2021-2022</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë UPT ka ngritur Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë i cili është funksional në UPT. Gjatë vizitës në Institucion që grupi i GVJ realizoi, ky fakt u konfirmua si nga përfaqësuesit e Zyrës së NJSBC, ashtu edhe nga anëtarët e GVB dhe drejtuesi i Departamentit. GVJ nisur nga DVV dhe rregullorja e programit, konstaton se: Përmirësimi i mësimdhënies; implementimi i metodave të reja në përputhje me natyrën dhe specifikën e programit të studimit; rritja e vetëdijes së personelit akademik dhe e studentëve për cilësinë në programet e studimit që ofrohen; mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit në mënyrë periodike të aftësive të mësimdhënies, janë përgjegjësi e drejtpërdrejtë e fakultetit dhe e Dekanatit të këtij fakulteti. Në Rregulloren e FGJM, në nenin 39 të saj shkruhet: <i>Organizimi dhe menaxhimi i çdo programi studimit në FGJM, në nivel departamenti, bëhet nga Këshilli i Programit të Studimit (KPS). Ky Këshill analizon çdo propozim për ndryshim ose përmirësim të programit të studimit dhe pasi e vlerëson atë konform me objektivat formuese të programit të studimit, me kodin e Cilësisë, me Statutin e UPT-së, rregulloren e Zhvillimit Kurikular dhe Mësimdhënies në UPT si dhe me të gjithë kornizën ligjore aktuale, referuar programeve të studimit, ia përcjell për miratim dhe procedim të mëtejshëm departamentit përkatës ose fakultetit për programet ndërdisiplinore. Kjo analizë shoqërohet me një raport teknik, në të cilën jepet mendimi i KPS-së për ndryshimet e propozuara.</i> Në përbërje të KPS është edhe një student. Për sa më sipër, GVJ shprehet se në FGJM janë të ngritura strukturat për përmirësimin e cilësisë, ku përfshihen studentët si pjesë e KPS. <i>Referenca:</i> <i>Raporti i vlerësimit të brendshëm</i> <i>Ref 002 Plani Strategjik i UPT 2019-2024</i> <i>Ref 005 Organigrama e UPT</i> <i>Ref 006 Rregullore Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave, neni 38, 39.</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë.	Universiteti Politeknik i Tiranës, me programet që ofron i është nënshtruar disa herë procesit të vlerësimit në kuadër të akreditimit si atij Institucional, ashtu edhe të programeve të studimit të të dy cikleve. Procese të tilla janë të shëndetshme

Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	për Institucionin pasi vënë në punë mekanizmat për mirëfunksionimin e tij dhe jo vetëm. Ri-akreditimi institucional me vlerësimin maksimal, sipas vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 01, datë 07.01.2022 ‘Për akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti Politeknik i Tiranës’, është një tregues i përputhshmërisë së shkallës së plotësisë të Standardeve Shtetërore të Cilësisë me vlerësimin në kuadër të akreditimit të këtij institucioni. Programi i studimit objekt vlerësimi BSc në “Inxhinieri e Burimeve Minerare” i nënshtrohet për herë të parë akreditimit të tij të vlerësimit të cilësisë. <i>Referenca</i> <i>Raporti i vlerësimit të brendshëm</i> <i>Ref 018 Vendimi i Bordit të ASCAL për akreditimin e UPT.</i>			
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Në Kreun X të Rregullores së Fakultetit të Gjeologji Minierave, janë parashikuar disa nene në funksion të vlerësimit të cilësisë. Sipas kësaj rregulloreje, fakulteti është përgjegjës për procesin e mësimdhënies. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit që ofrohen në këtë Fakultet. Studenti informohet në fillim të vitit akademik, me përmbajtjen, detyrimet, metodologjinë e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe kompetencave të cilat janë të parashikuara në syllabusin e lëndës. Departamenti zhvillon kontrolle në auditor për procesin e mësimdhënies. Kontrollë realizohen edhe nga titullari i lëndës tek personeli akademik, i cili përfshihet në mësimdhënie. Të gjitha sa më sipër janë tregues të qartë për të nxitur arritje sa më të mira në programin e studimit. <i>Referenca:</i> <i>Raporti i vlerësimit të brendshëm</i> <i>Ref_006 - Rregullore Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave</i> <i>Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlereson se Insitucioni ka miratuar akte rregullatore e procedura transparente për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. Megjithëse ka përpjekje pozitive, transparenca dhe gjithëpërfshirja kërkojnë një angazhim të drejtëpërdrejtë në informimin e studentëve dhe pedagogëve, debat të hapur dhe diskutim me ata.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur në dosjen e vetëvlerësimit, si edhe mbështetur në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm dhe vizitën dy ditore në Institucion, GVJ verën se programi i studimit BSc në Inxhinieri e Burimeve Minerare është në mbikëqyrje dhe nën kujdesin e Departamentit të Inxhinierise të Burimeve Minerare, si njësi bazë përgjegjëse për mbarëvajtjen e tij. Këtë pohim e mbështesim edhe në Rregulloren e Departamentit, e cila ka të përcaktuar strukturën, mënyrën e funksionimit të tij si dhe kriteret dhe procedurat për zhvillimin dhe menaxhimin e procesit mësimor. Ky Departament është i organizuar dhe i strukturuar mbi bazë të grupeve mësimore-kërkimore-shkencore, të cilat janë: - Grupi Mësimor – Kërkimor (GMK) i Gjeomatikës. - Grupi Mësimor – Kërkimor (GMK) i Inxhinierisë Minerare dhe Përpunimit të Mineraleve. Grupi mësimor-kërkimor organizon punën për hartimin e planit mësimor dhe të programeve të lëndëve, mbikëqyr respektimin e planeve dhe programeve mësimore; ndjek ecurinë e procesit mësimor për lëndët e mbuluara nga pedagogët e grupit mësimor- kërkimor dhe në përfundim të çdo semestri raporton tek Përgjegjësi i Departamentit për realizimin e programit mësimor. Programi i studimit BSc në Inxhinieri e Burimeve Minerare ka një koordinator programi, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat formuese të tij. Një nga strukturat që shërben për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit është Këshilli i Programit të Studimit (KPS) që ngrihen pranë departamenteve. Anëtarët e KPS propozohen nga departamentet që bashkëpunojnë për një program studimi të caktuar dhe miratohen në Dekanatin e FGJM. Drejtuesi i KPS është koordinatori i programit të studimit. Koordinatori i programit (neni 21 në Rregulloren e DIBM) në detyrat e tij ka të përcaktuar sa më poshtë:

	- Bashkëpunon dhe koordinon aktivitete me strukturat përgjegjëse për zhvillimin e programit të studimit në përputhje me rregulloret e DBE dhe Fakultetit; - Siguron që dokumentacioni bazë i programit të studimit: plani mësimor dhe syllabuset të jenë të përditësuar në fillim të çdo viti akademik; - Siguron që materialet didaktike të jenë të disponueshme dhe të aksesueshme për studentët. Për gjithçka sa më sipër por edhe për detyra të tjera të cilat janë të përcaktuara në bazën rregullatore të fakultetit por edhe të Departamentit, raportohet tek Përgjegjësi i Departamentit, i cili rast pas rasti merr masat konkrete sipas problematikave të raportuara. <i>Referenca</i> <i>Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i> <i>Ref 010 Rregullore e PS BSc në DIBM</i> <i>Ref 020 Vendimi i DIBM për ngritjen KPS</i> <i>Komisionet e Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë në njësitë bazë/departamentet (KSCBF) janë ende struktura jo të plota dhe të konsoliduara në praktika. Në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave (FGJM), i cili ofron programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri e Burimeve Minerare" ka në strukturën e vetë një specialist për sigurimin e cilësisë në FGJM [https://fgjm.edu.al].</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Në përfundim të vitit akademik zhvillohet edhe analiza e procesit mësimor. Analiza e procesit të mësimdhënies zhvillohet në nivel Departamenti, Fakulteti dhe në Senatin Akademik. Stafi akademik vihet në dijeni individualisht për rezultatin e anketimeve, i cili lidhet drejtëpërdrejtë me performancën e tij. Departamenti informohet për rezultatet e të gjithë stafit të angazhuar pranë tij. Pas analizës së pyetësorëve në nivelet përkatëse dhe diskutimeve me personat e interesuar, Institucioni merr masa për zgjidhjen e problematikave. Institucioni organizon gjithashtu, mbledhje në të cilat marrin pjesë studentë, staf akademik dhe përfaqësues të tregut të punës, duke nxitur tek ata ndërgjegjësimin dhe rëndësinë e ruajtjes së cilësisë dhe nevojën e përmirësimit të vazhdueshëm në përputhje me standardet e cilësisë. <i>Referenca:</i> <i>Raporti i vlerësimit të brendshëm</i>

	<i>Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	FGJM dhe DIBM përdorin metoda të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes dhe cilësisë së programit të studimit: - të drejtpërdrejta, përmes kontakteve të koordinatorit dhe mentorëve të programit të studimit me studentët; - të tërthorta, përmes pyetësorëve drejtuar studentëve për vlerësimin e programit të studimit. Informacionet e mbledhura nga këto instrumenta bëhen pjesë e diskutimeve në mbledhjet e Departamentit, asamblesë së Fakultetit dhe në Senat, me praninë e përfaqësuesve të studentëve, duke promovuar praktikën e mira dhe duke propozuar një plan masash për problematikat e evidentuara, duke synuar përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, kurrikulave të programeve të studimit të ofruara, përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies, përmirësimin e formave të vlerësimit të studentëve, etj. Po ashtu, përgjegjësit e Departamenteve realizojnë vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së leksioneve/seminareve etj, praktikë që verifikon kryerjen e procesit të mësimdhënies nga pikëpamja sasiore (Orët, leksion, seminare, laboratorë). Për sa i përket vlerësimit nga pikëpamja cilësore, respektohet liria akademike e stafit akademik dhe nuk ka asnjë praktikë ligjore të miratuar nga Senati Akademik për marrjen e të dhënave cilësore (duke përjashtuar kontrollin dhe vlerësimin e syllabuseve, programeve mësimore, etj). Referuar Dosjes së vetëvlerësimit të paraqitur nga GVB, në Rregulloren e Departamentit të Inxhinierisë të Burimeve Minerare, në nenin 76 të saj, flitet për Cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit. Personeli akademik dhe ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja, në përputhje me natyrën dhe specifikën e programeve të studimit <i>Referenca:</i> <i>Ref 006 Rregullore e Brendshme e FGJM</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit	Në takimin që GVJ zhvilloi me përfaqësues të NjSBC, grupit ju komunikua se kjo Njësi organizon dy herë në vit sondazhe me studentët për të marrë prej tyre opinione për mbarëvajtjen e procesit mësimor, marrëdhëniet me pedagogët e lëndëve, zhvillimin e praktikave mësimore, zhvillimi i orëve laboratorike, etj. Përpunimi i pyetësorëve të studentëve bëhet nga kjo Njësi dhe me rezultatet e saj njihen Dekanati i Fakultetit të Gjeologji Minerare, pjesë e të cilit është edhe Përgjegjësi i Departamentit të Inxhinierisë të Burimeve Minerare.

akademik, ndihmës-akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	Referenca: <i>Raporti i vlerësimit të brendshëm</i> <i>Ref 082 Raport i aktivitetit mësimor në nivel njësisht dhe universiteti</i>			
Konkluzione	GVJ gjykon se Drejtoria e Sigurimit të Cilësisë, e cila është e organizuar dhe funksionon në rang Institucional, monitoron dhe vlerëson në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultate të mira të të nxënit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Për vlerësimin e shkallës së plotësimi të këtij kriteri, GVJ shqyrtoi një sërë dokumentesh të cilat janë në Dosjen e Vetëvlerësimit, dokumente të cilat janë cituar edhe në raportin e vlerësimit të brendshëm të këtij programi si dhe dokumentin "Plani strategjik i UPT 2019-2024". Në këtë plan strategjik janë të përcaktuara, përpos të tjerave, edhe menaxhimi i procesit të mësimdhënies duke synuar përmirësimin e kulturës së cilësisë në procesin e edukimit nëpërmjet zbatimit të standardeve më të përparuara dhe reformimi në bazë të rezultateve të të mësuarit dhe me qendër studentin, vlerësimi periodik i programeve të studimit dhe akreditimi i tyre; rritja e cilësisë në praktikat profesionale dhe diversifikimi i tyre; zhvillimi i infrastrukturës dixhitale për përmirësimin e edukimit dhe krijimin e oportuniteteve për personelin akademik, etj Po sipas planit strategjik, UPT synon përmirësimin e kulturës së cilësisë në procesin e edukimit nëpërmjet zbatimit të

	standardeve më të përparuara. Plani i veprimit për arritjen e këtij synimi konsiston në: Plotësimin dhe modernizimin e strukturës dhe sistemit të sigurimit të cilësisë në UPT nëpërmjet ristrukturimit të qendrës së cilësisë dhe organizimit të rrjetit të cilësisë deri në nivel programi studimi; zhvillimin e kapaciteteve për monitorimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë në procesin e edukimit; përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të sigurimit të cilësisë me synim rritjen e efektivitetit dhe efijencës së programeve të studimit; rritjen e transparencës dhe futjen e metodës së vetëvlerësimit periodik të punës së personelit akademik si pjesë e rritjes së kulturës së cilësisë. <i>Referenca:</i> <i>Ref 001 Statuti i UPT.</i> <i>Ref 002 Plani Strategjik i UPT 2019-2024, kreu IV, IV.1</i> <i>Ref 006 Rregullore e Brendshme e FGJM</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Një ndër takimet që GVJ zhvilloi gjatë vizitës në Institucion ishte ai me anetarët e GVB. Gjatë takimit, GVJ iu bë e ditur mënyra se si ishte ngritur Grupi i vlerësimit të brendshëm dhe si ishte bërë ndarja e detyrave në anëtarët e këtij grupi. Për pyetjet e ndryshme të adresuara në anëtarët e këtij grupi, GVJ mori përgjigje të qarta dhe koncize. Pasqyrimi ishte i saktë dhe vlen të theksohet që gjatë procesit të vlerësimit të brendshëm në kuadër të akreditimit të këtij programi studimi, si pikë e fortë u theksua mbështetja e personelit akademik të këtij programi për një proces sa më konkret dhe gjithëpërfshirës. <i>Referenca:</i> <i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i> <i>Ref 006 Rregullore e Brendshme e FGJM</i> <i>Ref 020 Vendimi i DIBM për ngritjen KPS</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të GVJ, përfshirë edhe raportin e vetëvlerësimit, vërehet që në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit është garantuar përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit. Kështu, vërehet se përbërja e grupit të vlerësimit të brendshëm të programit BSc në Inxhinieri Burimeve Minerare, është përcaktuar nga Përgjegjësi i Departamentit të Inxhinierisë së Burimeve Minerare.

studentëve e programit të studimit.	Në urdhrin e Dekanit të FGJM Nr. 2/2024 urdhërohet ngritja e grupeve të vlerësimit të brendshëm për programet e studimit të ciklit të parë (bachelor) që ofron FGJM. Në përbërje të këtij grupi është edhe një student i programit të studimit. <i>Referenca:</i> Ref 019 Urdhëri i Dekanit FGJM për ngritjen GVB Ref 020 Vendimi i DIBM për ngritjen KPS Ref 065 Anketimi Studentor-Pyetësori dhe Raporti OK
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Pranë FGJM është ngritur NJBSC në nivel fakulteti, e cila nxit dhe mbështet punën në kuadër të sigurimit të cilësisë të stafit drejtues, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, studentëve të programit të studimit, si dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm, duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt tyre. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë janë edhe bashkëpunëtorët e jashtëm me të cilët UPT/ FGJM ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi dhe zhvillojnë aktivitetin e tyre në fushën e Inxhinierisë së Burimeve Minerare. Institucioni është në kontakt të vazhdueshëm me ta për studimin e tregut të punës, për përmirësimin e kurrikulave, për shkëmbimin e stafit, zhvillimin e praktikave mësimore, etj. Në FGJM nuk konstatohet asnjë praktikë ankimi nga ana e studentëve apo stafit akademik dhe administrativ për diskriminim dhe pabarazi. <i>Referenca</i> Raporti i Vlerësimit të Brendshëm
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vëra në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Mendimi i ekspertëve tërhiqet jo vetëm nëpërmjet angazhimit të tyre në mësimdhënie si staff me kohë të pjesshme, por edhe në takime të ndryshme, në leksione të hapura, workshope, etj. Ekspertiza e tyre ka qenë e vlefshme sidomos në aspektet e lidhjes së teorisë me praktikën. <i>Nuk ekziston një praktikë periodike vjetore e marrjes së Feedback-ut nga ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit, duke përfshirë biznesmenë, institucione publike dhe private ku të diplomuarit e një programi studimi janë punësuar.</i>
Konkluzione	GVJ vlerëson se përgjithësisht në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë përfshihen anëtarë të personelit

	akademik të Departamentit, njëkohësisht edhe pedagogë të lëndëve të programit BSc në Inxhinieri e Burimeve Minerare. Bëhen përpjekje për të përfshirë edhe studentët, një ndër të cilët ishte edhe anëtar i GVB. Sugjerojmë që studentët të përfshihen më aktivisht në procesin e sigurimit të cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Institucioni (UPT) ka hartuar politika të qarta për publikimin e veprimtarive në kuadër të sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë duke u treguar transparent me studentët dhe të gjithë të interesuarit lidhur me veprimtaritë në kuadër të SBC. GVJ shprehet se nga këqyrja e faqes web të UPT, shikohet se ka një informacion të plotë për të gjithë strukturat, drejtimin akademik dhe administrativ, programet e studimit, kërkimin shkencor, bashkëpunimet ndërinstitucionale; projekte në UPT, etj. GVJ gjatë vizitës, konkludoi se studentët dhe stafi kishin informacion të konsiderueshëm lidhur me veprimtaritë e Institucionit në funksion të SBC <i>Referenca:</i> Faqja web e UPT: https://upt.edu.al/
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Në dosjen e vetëvlerësimit Institucioni ka paraqitur raportin e Anketimit studentor të cilin e ka të publikuar dhe në faqen web të UPT (http://upt.edu.al/cilesia-ne-UPT). Raporti për anketimin studentor është bërë për semestrin e parë, viti akademik 2021-2022. Sipas këtij materiali, me organizimin e tij, studentët janë informuar përmes email-it, ku ju është bërë e ditur koha e kryerjes së anketimit, mënyra e plotësimit dhe rëndësia e procesit. Qëllimi i këtij pyetësori është të ndihmojë në krijimin e një panorame të problematikave në UPT, duke u fokusuar tek perceptimi i studentëve në lidhje me universitetin, fakultetin, programin e studimit ku ato studiojnë dhe pedagogët e tyre, për të mundësuar përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë akademike duke vazhduar traditën e ekselencës e duke konsoliduar reputacionin kombëtar e rajonal.

	Po sipas këtij materiali, kanë marrë pjesë në anketim 109 studentë nga Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave ose 4.6% e tyre. Drejtorja e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në bazë të problematikave të nxjerra nga ky pyetësor, ka evidentuar për Fakultetin e Gjeologji Minierave dhe për programin e studimit BSc në Inxhinieri e Burimeve Minerare disa problematika të përgjithshme, duke bërë rekomandimet përkatëse. <i>Referenca:</i> <i>Ref 065 Anketimi studentor – Pyetësi dhe Raporti</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Bazuar në materialet që gjenden në DVV, kryesisht mbështetur në informacionin e dhënë në raportin e Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (DSBC) për anketimin studentor për Semestrin e parë, viti akademik 2021–2022, GVJ verën se për çdo Fakultet janë nxjerrë problematikat e shprehura në anketimin e studentëve. Për Fakultetin e Gjeologji Minierave është konstatuar se pjesëmarrja e studentëve në anketim është nën 5 %, konkretisht kanë marrë pjesë 4.6 % e totalit të studentëve në këtë fakultet. Gjithashtu, në raport me anketimin e mëparshëm: - është ulur vlerësimi për rekomandimin e literaturës ndihmëse në lidhje me procesin mësimor; - është ulur gatishmëria për të ndihmuar studentët edhe përtej orës së mësimi; Gjithashtu në këtë raport, DSBC shprehet se nuk janë përfshirë 23 programe studimit (8 prej të cilave janë të Fakultetit të Gjeologji Minierave), pasi numri i studentëve të anketuar është më i vogël se 60. <i>Referenca:</i> <i>Ref_060 - Anketimi studentor – Pyetësi dhe Raporti, Pika 6.2.1; 6.5</i> <i>Faqja web e UPT (http://upt.edu.al/cilesia-ne-UPT).</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Për ofrimin e programeve të studimit, efektiviteti i tyre, mundësia e përmirësimit dhe impakti që ka programi tek studentët, GVJ shprehet se UPT ka një bazë rregullatore të konsoliduar, në të cilën janë të përcaktuara qartë mënyrat, ofrimi dhe veprimtaria e programit të studimit. Ashtu siç është paraqitur edhe në raportin e vlerësimit të brendshëm, Drejtorja e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është përgjegjëse për respektimin e standardeve të përgatitjes së të gjithë dokumentacionit që përmban programi i studimit (plani mësimor, syllabuset, ngarkesa e pedagogëve,



	përputhshmëria e formimit të tyre akademik me lëndën që japin mësim). Në rregulloren e Fakultetit të Gjeologji Minerave, neni 38, flitet për Këshillin e Programit të Studimit (KPS). Ky këshill ngrihet në nivel departamenti dhe është përgjegjës për organizimin dhe menaxhimin e çdo programi studimi. Këshilli analizon çdo propozim ose përmirësim të programit të studimit; harton draft propozimin për programet e reja të studimit që synohen të hapen; përgatit raportin e analizës vjetore të programit të studimit dhe ja përcjell për diskutim dhe miratim departamentit përgjegjës; analizon format e vlerësimit të studentit; etj. <i>Referenca</i> <i>Raporti i vlerësimit të brendshëm</i> <i>Ref_006 Rregullore Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minerave</i>
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	GVJ vëren se UPT, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minerave dhe Departamentin i Inxhinierisë së Burimeve Minerare, bëjnë përpjekje me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e studentëve mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në procesin e përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit dhe shërbimeve administrative që ata marrin në institucion. Një rol të rëndësishëm luan Zyra e Karrierës, e cila, është një nga strukturat që ka marrëdhënie të drejtpërdrejta me studentët dhe problematikat e sfidat që ata hasin në përditshmërinë e tyre studentore. Zyra e karrierës ka për detyrë që t’iu ofrojë studentëve mbështetje për mënyrën e marrjes së informacionit lidhur me çdo event që fakulteti zhvillon, adresimin e kërkesave dhe ankesave që studentët mund të kenë si dhe për përmbushjen e të drejtave dhe detyrimeve që kanë. Realizimi i aktiviteteve të bërë nga kjo zyrë është paraqitur e hollësishme në materialin e cituar, nga periudha 17.10.2022 deri në 04.04.2024/ <i>Referenca</i> <i>Ref 096 Informacion për studentët për plotësimin e pyetësorit të lëndëve</i> <i>Ref 036 Informacion specialisti i karrierës</i>
Konkluzione	GVJ gjykon se, UPT ka politika dhe qasje të mira dhe ka strukturat e ngritura me qëllim mundësimin e sigurimit të Cilësisë në programet e studimit që ofrohen në UPT dhe konkretisht në programin e studimit BSc në Inxhinieri e Burimeve Minerare. UPT bën përpjekje që proceset dhe veprimtaritë lidhur me Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë të jenë publike, transparente dhe efektive.

Q

A

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Inxhinieri e Burimeve Minerare" ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë: "Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave.

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave, dhe Departamenti i Inxhinierisë së Burimeve Minerare ndërmarrin masa dhe krijojnë kushte për sigurimin e cilësisë dhe për përditësimin e vazhdueshëm të programit të studimit. Ky përditësim realizohet në përputhje me nevojat e tregut të punës, kurrikulat analoge të vendeve anëtare të BE-së dhe zhvillimet më të fundit në fushën e nxjerrjes dhe përpunimit të burimeve minerare. Oferta akademike e këtij programi është unike në tregun e arsimit të lartë dhe thekson dimensionin ndërkombëtar si një element kyç.
2. Institucioni angazhon staf akademik të kualifikuar me përvojë të gjatë akademike dhe profesionale. Një pjesë e tyre kanë kryer kualifikime në universitete të njohura të vendeve të BE-së, duke përfutur nga projektet e përbashkëta kërkimore dhe programet e mobilitetit. Këto iniciativa me institucione homologe kontribuojnë ndjeshëm në rritjen e nivelit profesional të stafit.
3. UPT dhe FGJM, duke u mbështetur në traditën dhe përpjekjet e vazhdueshme, ofrojnë një infrastrukturë mësimore të konsoliduar dhe një rrjet laboratorësh të pajisur me teknologji bashkëkohore, kryesisht me karakter didaktik. Gjithashtu, po bëhen përpjekje për modernizimin e mëtejshëm të kësaj infrastrukture. Këto resurse sigurojnë një bazë të qëndrueshme për cilësi të lartë në lëndët praktike dhe zhvillimin e aftësive të studentëve në përputhje me kërkesat konkrete të tregut të punës.
4. Bashkëpunimi i ngushtë me sektorin e biznesit dhe veçanërisht me prodhuesit dhe aktorët e tregut të punës mundëson harmonizimin e njohurive teorike me aftësitë praktike. Ky bashkëpunim motivon përmirësimin e programit akademik, duke e përshtatur atë më mirë me kërkesat e tregut.
5. Universiteti ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione vendase dhe ndërkombëtare, të cilat mundësojnë shkëmbimin e stafit dhe të studentëve, ndarjen e eksperiencave dhe zhvillimin e praktikave profesionale për studentët. Këto aktivitete realizohen në përputhje me nevojat dhe objektivat e programit të studimit

Pika të dobëta:

1. Programi i studimit përballlet me sfidën e numrit të vogël të studentëve të regjistruar, çka ndikon negativisht në vazhdimësinë dhe zhvillimin e tij.
2. Buxheti i pamjaftueshëm pengon realizimin e praktikave eksperimentale dhe krijimin e bashkëpunimeve të qëndrueshme me aktorë të tjerë për zhvillimin e kërkimeve të aplikuara në fushën e burimeve minerare (Standarti II.1, Kriteri 4).
3. Literatura e përdorur në disa module është e vjetëruar dhe nuk reflekton zhvillimet bashkëkohore në këtë fushë. Në disa lëndë, materialet mësimore kufizohen vetëm në



leksione të hartuara nga lektorët, pa përfshirë referenca të reja dhe të standardizuara (Standarti II.4, Kriteri 5).

4. Institucioni nuk disponon një format të standardizuar për përmbushjen e kriterëve të rekrutimit të stafit akademik, duke shkaktuar mungesë konsistence në procesin e përzgjedhjes (Standarti III.1, Kriteri 4).
5. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) konstaton se Drejtoria e Kurrikulave nuk ka realizuar dhe as ka marrë pjesë në trajnime për zhvillimin dhe përmirësimin e kurrikulave (Standarti III.1, Kriteri 6).
6. Anketimi i studentëve nuk realizohet me korrektësi dhe sipas programit të përcaktuar (Standarti III.2, Kriteri 4).
7. Leksionet e hapura dhe seminarët janë shumë të rralla dhe nuk zhvillohen sipas një programi të strukturuar (Standarti III.4, Kriteri 5).
8. Stafi akademik i Departamentit të Inxhinierisë së Burimeve Minerare, që është njësi bazë për ofrimin e këtij programi studimi, është i mbingarkuar, me pedagogë që mbulojnë deri në 8 module gjatë një viti akademik (Standarti IV.1, Kriteri 2).
9. GVJ konstaton se lidhja e departamentit me studentët është e dobët. Mendimet dhe sugjerimet e studentëve nuk pasqyrohen në përmirësimin e programit të studimit. Këshilli Studentor është pothuajse inaktiv, dhe njësitë përgjegjëse nuk kanë kontakte me studentët Alumni (Standarti II.5, Kriteri 2 dhe Standarti V.5, Kriteri 2).

Rekomandime:

1. GVJ sugjeron që institucioni të intensifikojë përpjekjet për të tërhequr më shumë studentë në programin Bachelor në Inxhinieri të Burimeve Minerare, duke promovuar vlerat dhe perspektivat e tij.
2. GVJ rekomandon përmirësimin dhe standardizimin e syllabuseve të programit Bachelor në Inxhinieri të Burimeve Minerare, duke siguruar përdorimin e literaturës bashkëkohore dhe të detyrueshme që reflekton zhvillimet më të fundit në fushë.
3. GVJ thekson rëndësinë e forcimit të rolit të Zyrës së Karrierës dhe Alumnit në mbajtjen e kontakteve të vazhdueshme me studentët e diplomuar. Zyra përkatëse duhet të realizojë anketime të strukturuar për të matur kënaqësinë e studentëve gjatë punësimit dhe për të mbledhur sugjerime mbi përmirësimin e aftësive të diplomuarve. Ky proces synon rritjen e cilësisë së programit të studimit dhe përafrimin e tij më të madh me kërkesat e tregut të punës.
4. Studentët duhet të jenë më të përfshirë në proceset e sigurimit të cilësisë, duke kontribuar me opinionet dhe eksperiencat e tyre për përmirësimin e mëtejshëm të programit të studimit.
5. Anketimi i studentëve duhet të bëhet rregullisht në bazë të një pyetësores të standartizuar dhe të aprovuar.

6. Rekomandohet që Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, të jetë me aktiv në realizimin e orëve dhe leksioneve të hapura si dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.
7. GVJ rekomandon që për përballimin e ngarkesës mësimore të programit të studimit, Departamenti të rekrutojë staf akademik PAK, por gjithmonë në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.
8. Institucioni duhet të punojë më shumë për të nxitur studentët që të japim mendime dhe propozime konkrete për atë çka duhet të rregullohet si në funksionimin si duhet të programit të studimit ashtu edhe në veprimtaritë kërkimore
9. Departamenti të pergatise nje formular me kriteret per pranimin e stafit akademik me kontrate i cili duhet te plotesohet nga juria qe vlereson kandidatin.

Evaluation Conclusions for the First-Cycle Study Program Bachelor in “Mineral Resources Engineering” provided by the Higher Education Institution: The Polytechnic University of Tirana, Faculty of Geology and Mining

Strengths and affirmations

1. The Polytechnic University of Tirana, through the Faculty of Geology and Mining and the Department of Mineral Resources Engineering, actively takes measures to ensure the quality and continuous modernization of its study programs. These efforts align with labor market needs, curricula from EU member states, and the latest advancements in mining and mineral processing. This academic program stands uniquely in the higher education market, emphasizing an international dimension as a key component.
2. The academic staff involved in the teaching process are highly qualified, with extensive academic and professional experience. Many faculty members have been trained at prestigious EU universities and actively participate in joint research projects and mobility programs with partner institutions. These collaborations contribute significantly to their professional development and enhance the program's overall quality.
3. UPT and the Faculty of Geology and Mining benefit from a longstanding tradition and ongoing efforts to maintain and upgrade their infrastructure and laboratories, which feature modern, primarily didactic equipment. Continuous modernization initiatives ensure a solid foundation for delivering applied subjects and developing students' practical skills to meet labor market requirements.
4. Collaboration with business entities and labor market stakeholders fosters a strong alignment between theoretical knowledge and practical skills. This synergy motivates the program to respond effectively to industry demands, enhancing the employability and competence of its graduates.
5. The Polytechnic University has established cooperation agreements with local and international institutions, facilitating the exchange of staff and students, sharing of

expertise, and the development of professional internships. These partnerships are tailored to meet the specific needs of the study program and contribute to the professional growth of students and staff alike.

Weaknesses

1. The study program faces the challenge of a low number of enrolled students, which negatively affects its sustainability and development
2. The insufficient budget hinders the implementation of experimental practices and the establishment of sustainable collaborations with other stakeholders for the development of applied research in the field of mineral resources (Standard II.1, Criterion 4).
3. The literature used in some modules is outdated and does not reflect contemporary developments in the field. In certain courses, teaching materials are limited to lecture notes prepared by the lecturers, without including updated and standardized references (Standard II.4, Criterion 5).
4. The Department does not have a standardized format for meeting the criteria for academic staff recruitment, resulting in a lack of consistency in the selection process (Standard III.1, Criterion 4).
5. The External Evaluation Group (EEG) observes that the Curriculum Directorate has neither conducted nor participated in training sessions related to curriculum development and improvement (Standard III.1, Criterion 6).
6. Student surveys are not conducted accurately or in accordance with the established program (Standard III.2, Criterion 4).
7. Open lectures and seminars are very rare and are not conducted according to a structured program (Standard III.4, Criterion 5).
8. The academic staff of the Department of Mineral Resources Engineering, which is the core unit responsible for offering this study program, is overburdened, with lecturers covering up to 8 modules within an academic year (Standard IV.1, Criterion 2).
9. EEG observes that the department's connection with students is weak. Students' opinions and suggestions are not reflected in the improvement of the study program. The Student Council is almost inactive, and the responsible units lack contact with Alumni students (Standard II.5, Criterion 2, and Standard V.5, Criterion 2).

Recommendations:

1. The Institution should intensify its efforts to increase student enrollment in the Bachelor's program in Mineral Resources Engineering, by promoting its values and prospects and addressing factors that may contribute to the low number of applicants.
2. The External Evaluation Group (EEG) recommends enhancing the syllabi of the Bachelor's program in Mineral Resources Engineering by incorporating



- comprehensive, contemporary, and binding literature to ensure a higher standard of academic quality.
3. The EEG suggests that the Career and Alumni Office strengthen its engagement with alumni by maintaining regular contact. This should include conducting surveys to assess alumni satisfaction during their employment and gathering feedback on ways to enhance the skills of graduates. Such efforts will help improve the quality of the study program and better align it with labor market demands
4. Students should be more involved in quality assurance processes, contributing their opinions and experiences to further improve the study program.
5. Student surveys should be conducted regularly based on a standardized and approved questionnaire.
6. It is recommended that academic staff, both full-time and part-time, actively engage in delivering lectures and open seminars on recent developments in science and technology, both within and outside the study program's framework.
7. EEG recommends that, to manage the teaching workload of the study program, the department recruit additional academic staff. However, this should always be in compliance with the applicable legal framework.
8. The institution should work harder to encourage students to provide specific feedback and proposals for improving both the proper functioning of the study program and research activities.
9. The department should prepare a form with criteria for the recruitment of contract academic staff, which must be completed by the jury evaluating the candidate.



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

Enxhela 2025

As